

Përkthyesja e njohur dhe kryeredaktorja e botimeve "Pegi", Aida Baro, flet për përvojën e saj përkthimore dhe si redaktore, për problemet që kanë sot botimet nga letërsia e huaj dhe vështirësitë e librit në tregun shqiptar të librit.

## BISEDË ME AIDA BARON PËR PRIMO LEVIN E JO VETËM

Bisedoi Andreas Dushi



### A DO TA FITOJË PËRSËDYTI KADAREJA ÇMIMIN BOOKER INTERNATIONAL?

Nëse do të fitonte, Ismail Kadare do të bëhej autori i parë fitues dy herë i Çmimit Ndërkombëtar Booker. Ai ishte laureati i çmimit inaugurues (i njohur në atë kohë si Çmimi Ndërkombëtar Man Booker) në 2005. Në atë kohë, çmimi jepej për të gjithë veprën dhe jo për një libër të vetëm. Kadare ishte në listën e gjatë për versionin aktual të çmimit në 2017, për romanin *Kamarja e Turpit*.

### SHËNIME MBI LIBRAT

#### ROMANTIKU ATIPIK ZEF SEREMBE DHE ENIGMAT E POEZISË SË TIJ

nga prof. dr. Klara Kodra (fq. 5)

#### NAUM PRIFTI NJË SHKRIMTAR I EPËRM I TREGIMIT SHQIPTAR

Prof. dr. Bardhosh Gaçe (fq. 7)


Mbi romanin "Nessun Dorma" të Roland Gjozës

#### VERBËRIA E NJË SHOQËRIE NË SYTË E NJË GRUAJE

nga Ballsor Hoxha (fq. 14)

#### E JASHTËZAKONSHMJA E "PERSONAZHEVE TË ZAKONSHËM", TË AUTORIT YLLJET ALIÇKA

Nga Arben Çejku (fq. 15)



## MARSI I PËRHERSHËM I BURRIT ME MBIEMËR KRUJËN...

Nga Visar Zhiti

Mustafa Merlika - Kruja tashmë është një institucion. Nëse Shqipëria nuk do të dijë që përvojën dhe arritjet e tij ashtu si dhe humbjet t'i bëjë pjesë të përvojës, arritjeve dhe humbjeve të saj, do të dëmtojë kështu historinë dhe kujtesën e popullit, por dhe kritikën e ardhmërisë. (fq. 6)

### Arthur Koestler MAKTHI QË ËSHTË REALITET

Përktheu nga origjinali: Atena Bishka (fq. 20)

### ARTI NUK KËRKON MËSHIRË, POR VETËM E JEP: PËR "KUR SUNDUESIT GRINDEN" TË ISMAIL KADARESË

Cory Oldweiler, Los Angeles Review

Përktheu Granit Zela (fq. 22)


KADARE

KUR SUNDUESIT  
GRINDEN

RRETH MISTERIT TË TELEFONIMIT  
STALIN-PASTERNAK



Onufri



### BIBLIOTEKË

- Xhevair Lleshi (fq. 16)  
*Vajza e valëve*
- Enver Kushi (fq. 17)  
*Aromë vjeneze*
- Anton Pappleka (fq. 18)  
*Dashakeqësia e parkave*
- Mentor Kikia (fq. 19)  
*Funerali*
- Uran Butka (fq. 21)  
*Shqipëruesi*

### GRUAJA: QIELLI I KANUNIT DHE QIEJ TË TJERË

nga Mehmet Elezi (fq. 12)

### MBI ROMANTIZMIN E ERRËT KUTELIAN; A ËSHTË MITRUSH KUTELI GOTIK?

Nga Jola Tasellari (fq. 9)

### POETI VËSHTIRË LASGUSH PORADECI

nga Luan Topçiu (fq. 10)

**A.D.:** Për herë të parë ju kam njohur nëpërmjet përkthimit të “Përçmimit” nga Moravia. Rrjedhshmëria e shqipes në atë roman më ka mahnitur dhe në të njëjtën kohë, më ka bindur se emri juaj duhet shtuar te lista e ngushtë me emra përkthyesish që po t’i lexosh në kopertinë apo frontespice, s’ke pse të dyshosh për nivelin e përkthimit. Cila është historia juaj me përkthimin letrar? Tregimi ose poezia e parë që keni përkthyer, mandej libri e kështu i gjithë udhëtimi deri kur u shndërrua nga një pasion, në një profesion?

**A.B.:** Përshëndetje Andreas dhe të falënderoj për vlerësimin dhe intervistën! Besoj se e ke perceptuar shumë bukur rrugëtimin tim qysh kur thua që përkthimi nga pasion u shndërrua në profesion, që ende vijon të bëhet me pasion. Në fakt, drejt përkthimit më ka shtyrë vetëm letërsia. E kam dashur shumë që e vogël, mbyllesha në bibliotekën e tim gjyshi me orë të tëra dhe kridhësia në lexime që tejkalonin aftësitë mendore të moshës sime. Ndërsa shoqet e mia luanin jashtë, unë “arratisesha” nëpër ishujt e vetmuar të Robinson Kruzosë, nëpër vendet imagjinare të liliputëve të Guliverit apo nëpër sallonet aristokrate të të mjerave kurtizane të shkëlqyera. Kur fillova studimet për gjuhë e letërsi italiane, ende nuk e dija se çfarë do të bëja me jetën time, por një natë, ndërsa lexoja “Kolombrenë” e Dino Buzzati-t, përkthyer nga Gjergj Vlasi, kisha nëpër duar edhe një vëllim tjetër me tregime të këtij autori në italishte dhe kaq më përfshiu krahasimi që i bëja përkthimit të atyre tregimeve, sa që mendova se mund ta provoja edhe unë njëherë. Kështu, tregim pas tregimi, jo vetëm nga Buzzati, por edhe nga Pirandello, fillova të ushtrohesha me përkthimin letrar. Për vite me radhë, nuk ia tregova askujt, sepse më vinte zor, nuk ndihesha në lartësinë e duhur, derisa qëlloi që, përmes miqsh të përbashkët, i pari i lexoi prof. Shaban Sinani. Kisha talent dhe leksik shumë të pasur, mbaj mend që më pat thënë. Por isha ende shumë e pasigurt, deri kur pata fatin e mirë që një prej atyre përkthimeve të ma lexonte Robert Shvarc. I ruaj edhe sot e kësaj dite ato tri faqe me shënime të tij në anë të fletës, me sugjerimet e mbi të gjitha me zemërdhënien e krahët që më dha, sepse në njëfarë mënyre, aty u vulos përfundimisht fati im si përkthyes. As disa muaj më vonë, do të më vinte një propozim për të përkthyer “Baronin rebel” të Italo Calvino-s nga shtëpia botuese “Elite” dhe duhet të falënderoj z. Apostol Nasi, që më besoi një vepër aq madhore në një moshë fare të re. Më pas, ndërsa punoja në një kompani telekomunikacioni, që në të vërtetë s’kishte asnjë lidhje me profesionin tim, nuk iu ndava kurrë përkthimit, të cilin e zgjerova dhe me përkthimin audio-vizual, me përkthimin e filmave dhe dokumentarëve për televizione nga më të ndryshmet. Gjë që më



ndihmoi të kultivoja dhe të rafinoja më tepër shijen për kinemanë. Për disa vite pata bashkëpunim shumë të mirë me shtëpinë botuese “Dudaj”, periudhë gjatë së cilës u rrita më shumë profesionalisht, për të arritur, në këtë dekadë të fundit, në përkthime autorësh vërtet të mëdhenj dhe sfidues, si Ungaretti, Moravia, Pasolini apo Primo Levi. Është një rritje graduale, mendoj, që vjen pas një përkushtimi të madh, pas një mosdorëzimi në asnjë rrethanë, pas një sakrifice dhe heqjeje dorë nga shumë gjëra të tjera të jetës, pikërisht sepse bëhet me dëshirë dhe pasion.

**A.D.:** Shpeshherë, përkthyesi nuk mund të konceptohet pa redaktorin. Të dyja këto janë fusha ku ju jeni e angazhuar. Si e shihni raportin mes përkthyesit dhe redaktorit?

**A.B.:** Është një pyetje që më vë gjithnjë në dilemë. Ku përfundon përkthyesi dhe ku fillon redaktori brenda meje? Mendoj se është një ekuilibër shumë i brishtë, që duhet ruajtur patjetër. Kur je në rolin e përkthyesit, je vetëm ti dhe teksti, autori, dhe nuk mendon për çfarë do të vijë më pas. Sfidë është vetëm në kuptimin e autorit, në studimin e tij, në gjetjen e ekuivalentit të saktë të fjalës e të mendimit të tij për ta sjellë sa më besnikërisht në shqipe, por gjithnjë duke respektuar strukturën e gjuhës sonë.

Nga ana tjetër, si redaktor të duhet të mendosh për tri veta, për autorin, për përkthyesin dhe me kokën tënde

si redaktore, si njëfarë mbrojtjeje për gjuhën, për sintaksën e shqipes, sidomos në këto kohë kur anglishtja kryesisht ka fituar shumë terren dhe pjesa më e madhe e përkthyesve të rinj nuk kanë më afrimet me shqipen, por me anglishten. Edhe redaktori letrar duhet të ketë ndjeshmëri shumë të madhe ndaj tekstit, sepse një ndërhyrje e gabuar mund të shpjerë në tjetërsim të frazës dhe kuptimit. Shumë herë, më duket më i vështirë redaktimi sesa përkthimi, sepse përballesh me përkthyes që nuk pranojnë ndërhyrjet e bëra, ka të tjerë me të cilët diskuton shumë qetësisht, “grindesh” bukur, sepse vihen përballë dy zgjidhje subjektive, por gjithnjë duke menduar qëllimin final: përmirësimin e tekstit.

Si përkthyesi, si redaktori duhet të kenë një kulturë sa më të madhe jo vetëm gjuhësore, por të përgjithshme dhe e vetmja mënyrë, mendoj, për të qenë gjithnjë i aftë në këtë punë është leximi dhe përditësimi i vazhdueshëm.

**A.D.:** Po raportet mes përkthyeses dhe shkrimtarit si dhe redaktore e shkrimtarit, si do t’i përshkruanit?


**A.B.:** Në pamje të parë duket sikur janë të ngjashme këto dy pika, mirëpo ka një dallim thelbësor: përkthyesi nuk mund dhe nuk duhet ta tjetërsojë shkrimtarin, është hija e tij që duhet ta ndjekë autorin këmbë mbas këmbë, pa hequr apo pa shtuar “miell nga thesi i vet”. Dhe në këtë pikë, përkthyesi nuk ka dilema. Edhe sikur autori t’i ketë dhënë ngjarjes një zhvillim të gabuar,



një përfundim me të cilin s’bie dakord, nuk ke nga ia mban, duhet respektuar vendimi i tij. Mua nuk më ka qëlluar të përkthej autorë të gjallë, por kam bërë një punë kërkimore të thellë gjatë përkthimit të Alberto Moravia-s, Goliarda Sapienza-s, Pasolini-t, dhe sidomos me Primo Levi-n dhe Ungaretti-n, që janë dy prej autorëve më të vështirë që kam përkthyer. Kam lexuar intervista të tyre, faqe të tëra kritikësh që kanë zbrëthyer veprat me të cilat jam marrë, pikërisht për t’iu futur sa më thellë nën lëkurë, për t’i njohur nga afër, për të zvogëluar mundësinë e gabimit, për të pakësuar humbjen, sepse është e sigurt që humbje do të ketë, por të jetë sa më e vogël.

Tani, me projektin e ri që kam në dorë, kam fatin të provoj një faqe tjetër të marrëdhënies përkthyes-autor. Elvira Dones, shkrimtarja e njohur shqiptare, më ka besuar përkthimin e romanit të saj më të fundit, shkruar në italishte, *La breve vita di Lukas Santana*. Besoj se ka për të qenë një përvojë tejet interesante, sepse për herë të parë vihem jo vetëm përballë autorit, por një autori që e njuh gjuhën shqipe. Edhe vetë jam shumë kureshtarë dhe entuziaste për këtë sfidë të re, sa do të jem e zonja të futem nën lëkurën e Donesit dhe ta sjell në shqipe me stilin e saj që tashmë njihet gjerësisht nga publiku; sa do të ndryshojë teksti nga Elvira tek Elvira përmes Aidës. Do t’ju them kur të mbaroj librin.

Te redaktori ndoshta duhet bërë dhe një tjetër dallim. Redaktori letrar, ai që merret me ristrukturimin e fjalive, ndryshon nga editori, që në fakt, e ndihmon autorin gjatë shkrimit të librit për ta sjellë veprën në variantin më të mirë të lexueshëm. Editori, që është më i ftohtë ndaj tekstit, e ndihmon autorin si nga ana formale e tekstit, ashtu dhe në atë përmbajtjesore. E ndihmon të krijojë panoramën e madhe, strukturën e tekstit, pasurimin apo përsosjen e personazheve, të heqë jo vetëm paragrafë, por edhe faqe të tëra, të cilat autori i ka shkruar me një frymë, sepse ndoshta e ka marrë rrjedha e frymëzimit; herë të tjera, i sugjeron autorit të shtojë edhe kapituj, apo ndonjë personazh, ku e ndien se teksti çalon. Kjo është një punë që kërkon shumë njohuri, nuhatje të madhe letrare, aftësi komunikimi për të mos



e lënduar autorin, respekt ndaj punës së tij, sepse dihet që autori është tejet i ndjeshëm ndaj “ferishtes” së vet.

Në fund të fundit, mbeten po punë krijuese, që ta mbajnë trurin ndezur dhe të përfshijnë, por duhet të gjesh masën e duhur për çdo gjë.

**A.D.:** Kujtoj një takim me shkrimtarë e përkthyes ku moderatorja tha: “Mjafton të lexoj pak faqe dhe e kuptoj se përkthyes është Filani”. Kjo mu duk e pakuptimtë dhe njëlloj vijon të më duket edhe sot. Ju si e shihni? A duhet të ketë stil përkthyesi?

**A.B.:** Është një pyetje shumë e bukur, sepse më ka rastisur dhe mua të gjendem përballë përkthyesish që pretendojnë se “ky është stili im”. Nëse pranon të bëhesh përkthyes letrar, duhet të pranosh që ti je shërbëtor i autorit, ti je uji që merr formën në çdo enë që hidhet, sepse përndryshe ke dështuar në këtë punë. Është e paimagjinueshme që unë si përkthyes të përdor të njëjtin stil edhe për Levi-n, edhe për Goliarda Sapienza-n, edhe për Moravia-n, që janë krejt të ndryshëm nga njëri-tjetri, qoftë nga stili, qoftë nga tematikat. Sapienza ka një gjuhë tërë kolorit, të harlisur, që fillon qysh me përdorimin e dialektit sicilian e roman e deri në gjuhën e lartë intelektuale. Moravia është intelektual i kulluar, frojdist, psikolog i natyrës së errët njerëzore, me një gjuhë të lartë intelektuale, që nuk pranon kursesi harlisjen në leksik babaxhan e popullor. Levi nga ana tjetër është stilist i mendimit të dhënë përmes një gjuhe klasike dhe danteske. Por a është subjektiv përkthyesi? Patjetër, sepse ka formimin e tij, ka bagazhin e tij leksikor. Nga ana tjetër, kjo është e bukura, sa i aftë je të “asgjësosh” veten tënde, ta heshtësh zërin tënd, në shërbim të shkrimtarit, njësoj si ai “mediumi” që e lë trupin e vet t’ia pushtojë shpirti i dikujt tjetër për të komunikuar mandej me botën.

**A.D.:** Tradita jonë në përkthimin e poezisë italiane është shenjuar nga dy personalitete, Koliqi me *Poetët e Mëdhej t’Italisë* dhe Zorba me *Perfectum Trinum*, pa përmendur përkthyesit e *Komedisë Hyjnore*, nga Pashko Gjeçi te Mark Ndoja e tani së voni Meritan Spahija. Ndoshta prej tyre, ndoshta për arsye të strukturës gjuhësore, zakonisht është parë gegnishtja si bregu ku zbarkon në shqip poezia italiane. Me Ungaretti-n e sjellë prej jush, kjo ndryshon. Ky perceptim që solla unë të jetë fryt i arsyeve jashtëletrare dhe jashtëgjuhësore, apo edhe mund të ketë ndonjë gjë të vërtetë në të?

**A.B.:** *Perfectum Trinum* të Zorbës e kam shijuar pafundësisht, siç kam shijuar po aq dhe poezitë hermetike të vetë Zorbës në “Buzë të ngrime n’gaz”. Po ashtu edhe “Komedisë Hyjnore” të Gjeçit i referohem për çdo referencë nga Dantja. Unë mendoj se është një përzgjedhje që ka ardhur



për shkaqe gjeografiko-kulturore: kultura italiane ka qenë shumë më e pranishme në rrethet kulturore të Shkodrës e zonave përfaqëses në pjesën tjetër të Shqipërisë. Në njëfarë mënyre, të gjithë këta përkthyes të mrekullueshëm janë mëkuar qysh herët me kulturën dhe letërsinë italiane edhe përmes arsimimit që kanë ndjekur, të mos harrojmë që një pjesë e mirë e tyre janë formuar në shkollën katolike. Gjuha e tyre, ajo shkodranishtja e ëmbël e Koliqit apo e Zorbës, për mua, nuk është fort larg gjuhës letrare. (Them “letrare” dhe jo “standard”, sepse për mua, standardi i përket gjuhës zyrtare e administrative, ndërsa ajo letrare përfshin të gjitha dialektet e të folmet që i falin kolorit të jashtëzakonshëm gjuhës). Në këtë kuptim, përkthimi i Ungaretti-t është

fryt i rritjes dhe formimit tim letrar ndër vite. Kisha përkthyer poezi të veçuara të Ungaretti-t, sepse e kam dashur shumë poezinë e tij, por marrja përsipër e një vëllimi të tërë, sidomos një vëllimi si “Ndjenja e kohës”, është një punë e stërmundimshme dhe një sfidë e madhe. Në fakt, Ungaretti këtu është krejt ndryshe nga vëllimet e mëparshme që njohim ne, me atë poezinë e shkurtër, lakonike, simboliste, shkruar në transhetë e luftës. Këtu, ai vjen shumë më lirik, poezia ka varg më të gjatë, duke iu kthyer traditës italiane të canto-s, metrikës tradicionale, vargut njëmbëdhjetërokësh, nëntërokësh dhe shtatërokësh. Ungaretti është një stilist i italishtes së lartë në poezi, i simbolikës dhe hermetizmit. Ndonëse nuk ka rimë të dukshme, poezia e tij


ka një ritëm të brendshëm, aliteracion dhe muzikalitet të magjishëm.

Hera-herës, tek lexoja, studioja dhe përktheja ndieja sikur ndeshja në tematika dhe atmosfera të ngjashme me Poradecin, “liqeri pa kufi”, çështje të metafizikës, kapërcimit në kohë dhe në vend, përtej universit, përjetësia e bërë njësh me natyrën, dashuria, që ndonëse te Ungaretti na vjen më e fshehtë, janë çështje të përbashkëta që i lidh një fill i padukshëm filozofik. Në këtë kuptim, unë kam shfrytëzuar të gjitha mjetet shprehëse të gjuhës shqipe, qofshin ato të gegnishtes apo të toskërishtes, sepse për mua, shqipja është një dhe për fat kemi mundësi të shfrytëzojmë burime të kulluara nga të gjitha dialektet apo të folmet.

Në një libër tjetër, “Muza e haresë”, më është dashur të përdor sërish dialektet, duke qenë se autorja, Goliarda Sapienza, përdor herë pas here dialektin sicilian dhe atë roman për t’u dhënë jetë personazheve të saj. Kuptohet që kjo është një zgjedhje, të themi, arbitrare, por duke bërë një paralelizëm gjeografik, zgjedhja dialektin tosk për atë sicilian dhe gegnishten e Shqipërisë së Mesme, të folmen e Tiranës për atë roman. Por kjo gjithnjë, si nevojë e sjelljes sa më besnikërisht të atmosferës së romanit, i cili do të humbiste shumë po të përkthehej në standard. Po ashtu edhe si editore, sidomos me romanet e Tom Kukës, e kam mbështetur fuqimisht përdorimin e dialekteve për ta dhënë atmosferën dhe gjendjen e personazheve. Madje, për romanin i tij të fundit “Rrethimi”, u konsultuam me një shkodrane të mirë si Rozafa Shpuza për përdorimin e gegnishtes. Në këtë kuptim, unë e dua dhe e mbroj me fanatizëm çdo dialekt të shqipes, ajo që më frikëson është abuzimi me to nga njerëz të pazotë për t’ia njohur të gjitha faqet këtij diamanti.

**A.D.:** A ka ndonjë mënyrë tjetër për t’i dhënë në gjuhën pritëse, shqipen në këtë rast, referencat e *pop-kulturës* së gjuhës burimore, përveçse me *fusnote* që sikur e ndërpresin leximin?

**A.B.:** Përdorimi ose jo i fusnotës është një diskutim që endet shpesh nëpër mjediset tona. Ca mendojnë se nuk ka nevojë për to, se lexuesi, po të dojë, le t’i drejtohet internetit për informacione më të thella, ca mendojnë se janë të nevojshme. Personalisht, si përkthyes, në libra të rëndësishëm, sidomos tek “Armëpushimi” dhe “Të mbyturit dhe të shpëtuarit” të Primo Levi-t i kam vendosur atje ku dhe vetë kam ndier se kishte vështirësi kuptimi. Mendoj se e qartëson lexuesin për atë çka po lexon. Ka raste kur nocione të caktuara të një kulture, që nuk mund të perifrazohen në shqipë, duhen sqaruar me fusnote. Unë mendoj që një sqarim fillestar i dhënë përmes fusnotës nuk e dëmton leximin, përkundrazi. Pastaj, në qoftë se lexuesi ka interes për më tepër, mund të shfrytëzojë internetin.



**A.D.:** Keni provuar ndonjëherë të krijoni? Nëse po, çfarë ju ka penguar ta botoni?

**A.B.:** Oh, vjershat e adoleshencës, si të gjithë. Por ishin tepër mediokre për ta vazhduar më tej. Vjen një pikë që njeriu duhet ta kuptojë se ku e ka talentin. Ndoshta, elementin tim kreativ e kam shprehur përmes përkthimit dhe nuk ndiej nevojën të shkatërroj pemë më kot me shkrime. Por, kushedi, *mai dire mai*, themi ne italo-filët, po arrita të plakem, mbase dhe do të shkruaj gjepura të miat.

**A.D.:** Ju jeni kryeredaktorja e një prej shtëpive botuese më të rëndësishme në botën shqiptare, "Pegi". Po t'ju kërkoj një analizë të përgjithshme por të përmbledhur, si e shihni, në kontekstin shqiptar, botën e librit? Cilat janë problematikat kryesore dhe, nëse kemi edhe ndonjë përparësi, cila është ajo/ cilat janë ato?

**A.B.:** Bota e librit nuk është e shkëputur nga kultura në përgjithësi, nga teatri, nga kinemaja, nga muzika, nga muzetë apo galeritë e arteve. Gjithçka ka të bëjë me kultivimin e mirë të shijeve letrare dhe artistike dhe rritjen e një brezi më të kulturuar. Në fillim të viteve '90-të, pas rënies së diktaturës, u shkatërrua çdo gjë, sidomos kulturore. Një brez i tërë u rrit pa teatro kukullash, pa biblioteka, pa një mundësi për të zhvilluar talentet e tyre dhe pasojat e kësaj ndihen sot, në shoqërinë tonë që ende nuk ka ndërgjegje sociale për të mbrojtur ato të drejta që e bëjnë njeri të qytetëruar.

Për fatin tonë të keq, çdo gjë varet nga përpjekjet individuale qoftë të entiteteve botuese, qoftë të personave që merren me librin në sektorë të ndryshëm. Çdo gjë po bjerret ditë pas dite, libraritë në Tiranë po mbyllen, kur do të duhej të organizonin aktivitete pa fund; nëpër rrethe, libraritë janë shumë të pakta; bibliotekat e Tiranës, ndonëse të rikonstruara, nuk bëjnë aktivitete për të tërhequr të rinjtë, madje edhe fondin e librave kushedi kur e kanë pasuruar, të mos flasim për bibliotekat e rretheve pastaj. Të rinjtë po lexojnë kryesisht në anglisht, madje edhe libra që tashmë janë të përkthyer; një pjesë e shtëpive botuese e kanë humbur rolin e tyre edukues dhe kanë thjesht funksion tregtar, nuk kanë filtër për botimet që nxjerrin, sidomos me autorët shqiptarë, ku çdokush mund të gdhiet një ditë shkrimtar. Kultura po shkon drejt rrënimit përditë e më tepër dhe në nivel institucional askush nuk po e ngre zërin, për fat të keq. Njerëzit argëtohen me programe pa përmbajtje, për të cilat s'janë të detyruar të mendojnë. Nga ana tjetër, mendoj se ka vend për shkrimtarët që ta vëzhgojnë këtë kohë, këtë degradim të njeriut dhe ta tregojnë të keqen që po ndodh këtu. Nuk po shpresoj për një "Pasolini" shqiptar, por kushedi...



**A.D.:** Sipas jush, i përmbush editoria shqiptare kriteret e pashkruara deri dje (sot shpesh kushte të padiskutueshme) të të qenit politikisht korrekte në termat e gjithëpërfshirjes, mbarëprezantimit, diversitetit etj.?

**A.B.:** Me botime të huaja, të përkthyer në shqip, besoj se po bëhet një punë e rëndësishme në këtë drejtim. Ne si shtëpi botuese kemi dy koleksione të rëndësishme që i pasurojmë vazhdimisht me titujt dhe shkrimtarët të ndryshëm: koleksionin "Lotus" dhe atë "Mozaik". Lotusi i kushtohet letërsisë femine, libra që trajtojnë temën e gruas, të rolit të saj në shoqëri, porë nga këndvështrime shkrimtarësh shumë të mira dhe

me zë në letërsinë botërore. Ndërsa "Mozaiku" i kushtohet pikërisht diversitetit, që nga ai racor deri te shqetësimet e viteve të fundit që përfshijnë bullizmin dhe diversitetin gjinor. Janë libra tepër aktualë, i flasin shumë gjendjes sonë të tanishme, nxjerrin në pah prapambetjen tonë kulturore, sidomos për sa i përket dhunës mbi gruan. Janë mbi të gjitha çështje sociale për të cilat do të duhej të flitej gjerësisht nëpër shkollë, në takime të ndryshme me të rinj e në çdo qytet të Shqipërisë, sepse vetëm kështu do të përpiqeshim për të ngritur vetëdijen qytetare.

**A.D.:** Duke përgatitur pyetjet e kësaj bisede, u njoha edhe me ekzistencën e një agjencie letrare me emrin tuaj.


Për këdo ka interes, si funksionon? Nuk e di, ka agjentë dhe agjenci të tjera përveç jush? Sa ndihet mungesa e këtij personi kyç në gjithë procesin e botimit të një libri?

**A.B.:** Kjo është një tjetër ëndërr imja, në fakt. Më ka lindur si ide që pas mbarimit të masterit për Redaktori në universitetin e Urbinos, por është e vështirë të vihet në jetë në Shqipëri. Ideja ime përfshin punën e editorit, pra autorin e ndihmon në shkrimin e librit dhe më pas bëhesh agjent i tij për t'ia shitur veprën në botues vendas që mund të kenë interes për të. E më pas, shitjen e së drejtës së autorit edhe në botues jashtë vendit. Mirëpo, në Shqipëri, ku ndodh shpesh që autori paguan për botimin e veprës është e vështirë të realizohet. Për momentin, po përpiqem të ngre strukturën bazë. Shërbimet që do të ofrohen janë: vlerësim paraprak i tekstit, editing, redaktim, korrektim. Pra, si të thuash gjithë punën redaktoriale që një libër të vijë sa më i përkryer si nga ana formale, edhe nga brendia. Është një punë që e kam bërë me disa autorë shqiptarë dhe mendoj se kam krijuar përvojën e duhur në këtë drejtim. Shpresoj që shpejt të arrij të krijoj një bazë me autorë shqiptarë për t'ua prezantuar edhe shtëpive botuese të huaja.

Në botë, agjenti letrar është një pikë kyçe për t'i siguruar autorit mbrojtjen e interesave të tij, si intelektuale, edhe financiare, por Shqipëria është ende larg kësaj pike.

**A.D.:** I druheni Inteligjencës Artificiale? Jo vetëm si mjet që mund të zëvendësojë punën tuaj, por në të njëjtën kohë, si procesues informacioni dhe realizues detyrash që mund të sjellin një rënie të ndjeshme në nivelin e përkthimeve dhe redaktimeve?

**A.B.:** Nuk i druhen IA-së, i druhen jashtëzakonisht shumë papërgjegjshmërisë së njeriut për ta përdorur në mënyrën më të gabuar të mundshme. Puna është që sot gjithçka po ecën me një shpejtësi frenetike, afatet që vendosen për të kryer këto punë janë të shkurtra, nevoja për të nxjerrë ndonjë parë është gjithnjë e më e madhe dhe njerëzit joprofesionistë po shtohen shumë, duke përdorur këto rrugë të shkurtra. Përkthimi, redaktimi, por në fund të fundit çdo punë krijuese, kërkon kohë e durim, që askush nuk e ka më. Dhe kjo rendje (për ku?) më tremb. Njerëzit nuk po shijojnë më mundimin e krijimit, ankthin dhe bluarjen e mendimit, që sjell më pas dhe kënaqësinë e shijimit të frytit të punës. Gjithçka kapërdihet pa e përtypur dhe të bie si grusht në stomak e në kokë. Më tremb humbja e trajtave njerëzore, e ndjeshmërisë së njeriut, e dhembshurisë, e dashurisë, apo qoftë dhe e urrejtjes, dhembjes, vuajtjes, sepse një makinë, sado e përsosur të jetë, mbetet pa ndjenja e s'mund të arrijë kurrë përsosmërinë e papërkryer ndjesore të njeriut.



Para 180 vjetëve, në fshatin arbëresh Strigari (San Kozmo Albanese), me një natyrë pitoreske, plot kontraste ngjyrash, që të sjell ndërmend Shqipërinë, më 6 mars 1844, nga Mikelanxhelo Serembe dhe Maria Tereza Toçi, do të lindte një fëmijë që u pagëzua me emrin Zef. Më vonë bashkëvendësit do t'i ngjisin llogarin Ruvec.

Ky fëmijë do të bëhej poet dhe madje një poet i shquar. Ky poet do t'i përkiste drejtimit letrar të romantizmit, në formën që drejtimi në fjalë mori tek arbëreshët, drejtim që do të ishte një degë e romantizmit shqiptar të Rilindjes.

Zef Serembe do të thellonte atë frymë moderne që kishte sjellë për herë të parë Jeronim de Rada në letërsinë arbëreshe. Ai do të shprehte prirjen lirike të kësaj letërsie. Ai do të ndizte në poezinë e vet dy vatra qendrore tematike, temën e *lirisë* (të atdheut të stërgjyshërve, Shqipërisë, të vendlindjes, Italisë, të popujve të tjerë si Greqia, të individit dhe temën e *dashurisë* (erotike, po edhe gjithënjëzore).

Me kultin e Atdheut dhe të lirisë ishte i afërt me poetët e tjerë arbëreshë dhe shqiptarë të Shqipërisë të letërsisë së Rilindjes dhe gjithashtu me heroin lirik tribun dhe flamurtar, zëdhënës i bashkësisë. Po pranë atij kulti do të pohonte kultin e gruas dhe të ndjenjës, i spostuar në plan të dytë në letërsinë shqiptare të Rilindjes, ashtu si problemet ekzistenciale të jetës dhe të vdekjes, të së mirës dhe së keqes, të domosdoshmërisë dhe lirisë, të së drejtës për lumturi, të marrëdhënieve midis Perëndisë dhe njeriut.

Pranë heroit tribun, luftëtar, afirmohej individi me botë ideomocionale më të gjerë se mjedisi, që hynte në luftë me atë mjedis, një konflikt ky tipik për romantizma të tjerë më të zhvilluar evropianë si romantizmi francez, anglez, gjerman, romantizma që ndryshonin thellë nga romantizmi arbëresh dhe shqiptar, madje edhe nga romantizmi italian me elemente klasicizmi.

Për herë të parë Serembeja sillte në romantizmin arbëresh (dhe shqiptar) "bregën e shekullit", "etjen për pafundësi", madje edhe *titanizmin*, të gjitha këto karakteristike për romantizmin e Evropës Qendrore.

Zef Serembeja, pra, ishte një poet *atipik* për romantizmin arbëresh dhe shqiptar, po *tipik* i romantizmit evropian.

Në të vërtetë, poezia e tij, në thelb *lirike*, e ndryshme nga lirizmi i ndërthurur me epizëm dhe dramatikë në bashkëkohësve të tij De Rada, Dara, Santori e arriti nivelin estetik të letërsisë evropiane bashkëkohëse, siç e pranuan autorë të ndryshëm të kohës arbëreshë, shqiptarë, italianë dhe bashkatdhetarja e shquar e poetit, e lindur në Rumani, Dora d'Istria, siç do ta pranoin shumë më vonë (në shekullin e njëzetë dhe të njëzetënjëtë) poetë dhe kritikë të atdheut të origjinës dhe studiuesja ruse, Serkova.

Pra, origjinaliteti dhe niveli i lartë estetik i krijimtarisë së Serembes u pranuan që në gjallje të tij, përmes velit të përkthimit italisht të botuar më 1883 dhe përmes ndonjë vjershe të rrallë të botuar arbërisht.

Megjithatë, forma e lartë e poezisë së tij fshihet ende thesare të panjohura. Këtu del edhe një problem nevralgjik. Deri në ç'pikë botuesi i vjershave të tij në arbërisht, nipi Kozmo Serembe i qëndroi besnik origjinalitetit të ungjit?

Ndonëse vetë botuesi pretendon se nuk e preku materialin poetik të mbledhur (përveç heqjes aty-këtu të ndonjë barbarizmi) gjuha e botimit të vjershave më 1926 është tepër e afërt me gjuhën e Shqipërisë, duke përfshirë fjalë që poeti zor që t'i dinte. Prandaj hipoteza për një manipulim dhe deformim të vjershave origjinale, e hedhur për herë të parë nga studiuesi Dhimitër Shuteriqi më 1961 dhe e mbështetur më vonë nga studiuesi arbëresh Belmonte, sipas të

## ROMANTIKU ATIPIK ZEF SEREMBE DHE ENIGMAT E POEZISË SË TIJ

nga prof. dr. Klara Kodra

gjitha gjasave, qëndron, ndonëse më vonë atë do përpiqet ta hedhë poshtë studiuesi Domenico Kasiano (po i vetmi argument i tij është shumëllojshmëria e burimeve ku u mbështet botuesi, gjë që do ta vështirësonte mjaft manipulimin, po s'do ta bënte të pamundur).

Zbulimi i mjaft dorëshkrimeve autentike të Poetit (gjithsej nëntë) do t'i ndihmonte mjaft studiuesit në këtë pikë.

Gjithashtu, niveli i lartë i mjaft vjershave, si dy elegji të (të quajtura kryevepra të tij nga studiuesit) dhe sonetet do të dëshmonte në favor të një prekjeje të sipërfaqëshme, meqenëse një poet minor, siç ishte botuesi Kozmo, domosdoshmërisht do t'i dëmtonte këto vjersha duke i ndryshuar.

Rreth Poetit dhe krijimtarisë së tij janë krijuar gjithashtu legjenda, si legjenda e poetit improvizues, indiferent ndaj fatit të krijimtarisë së tij, legjendë që u pranua edhe nga studiuesi Eqrem Çabej në studimin e tij për romantizmin shqiptar. Po fakte të mëvonshme kanë dëshmuar se Poeti, ndonëse ishte vërtet edhe improvizues që edhe artist i limës që punonte me fjalën, duke krijuar variante të ndryshme të poezive të tij dhe gjithashtu kujdesej që vepra e tij poetike t'i shkonte publikut, jo vetëm të bashkëvendësve, po edhe të përtej kufijve, siç dëshmojnë botimet e tij në Amerikë ("Sonete të shumëllojshme", "Ushitari shqiptar", "Zotit").

Ushitari shqiptar, "Zotit". Në legjendë tjetër që ajo e poetit indiferent ndaj problemeve sociale të kohës, legjendë e pasaktë, siç dëshmojnë vjershat e tij italisht me problematikë sociale, të përfshira te "Sonete të shumëllojshme". Po problematika sociale, duke mos iu

përgjigjur vokacionit të thellë të Poetit, u ka dhënë jetë artistike vetëm disa vargjeve të shpërndara të krijimeve italisht të Serembes, si vargjet rrënoqthëse që mbyllën poezinë "Një taksidari".

"Po Italia do të bëhet shtet i madh/  
Ç'e ha meraku atë për kë ka uri?",  
vargje vërtet të forta, po që stonojnë me retorikën e pjesës tjetër të poezisë, ideja e së cilës ishte e fuqishme, po nuk arriti realizimin estetik.

Mbi krijimtarinë e Serembes, vizionin e tij të jetës, pati edhe gjykime kontradiktore: disa studiues si Zef Skiroi i Ri e quajten poetin si të nënshtruar, ndonjë tjetër që i përkiste atdheut të origjinës shkon deri aty sa i atribuon "aspirata revolucionare", ndonjë studiues si Ali Xhiku e ekzagjeron ndjenjën fetare të Poetit, duke e quajtur mistik dhe fatalist, ndonjë tjetër si Razi Brahimi mendon se ai arriti në ateizëm.

Mendojmë se këto janë gjykime të skajshme, poeti që *rebel* edhe në plan social, po nuk arriti, madje as te socializmi utopik i bashkëkohësit Vinçenc Stratigo; arrin të rebelohet kundër klerit, Vatikanit, madje edhe vetë Zotit, po nuk e vë asnjëherë në dyshim ekzistencën e këtij të fundit dhe për këtë dëshmon edhe vjersha e tij më kryengritëse "Zotit", ku ai i drejtohet në mënyrë protestuese, Perëndisë si një Job i ri, po e pranon si një fuqi të *njëmendte* dhe *personale* dhe nuk e sheh si *forcë të verbër*, siç do të bënte përkundraz me "natyrën njerëke" ateisti Leopardi, të cilin Serembeja e njihte dhe e nderonte, siç dëshmon vjersha kushtuar atij.

Edhe pesimizmi i Serembes s'do ta arrinte kurrë thellësinë e pesimizmit të



Leopardit. Zefi s'e humbet kurrë besimin në vlerat etike njerëzore dhe dashurinë për jetën: ai beson në progresin njerëzor dhe në solidaritetin midis njerëzve, gjithashtu besimi në çlirim e atdheut të të parëve që për të, gjatë gjithë jetës, një yll ndriçues edhe në vitet e fundit, kur mendjen e tij e pushton gjithnjë e më tepër terri i marrëzisë.

S'duhet lënë pa përmendur si një dukuri e skajshme në studimet serembiane, mendimi i shfaqur nga studiuesi Anton Berisha që çuditërisht vë në dyshim *literalitetin* e poezisë së Serembes dhe e quan atë një poet më të ulët nga niveli ndaj bashkëkohësve të shquar De Rada, Dara, Santori dhe madje edhe ndaj folklorit arbëresh.

Me gjithë respektin që ushqejmë për këtë studiues, s'mund ta pranojmë kurrësi këtë tezë të tij që në fakt nuk mbështetet në argumenta bindëse. Studiuesi nuk merret, për ta provuar atë, në analizën estetike të vjershave që janë quajtur si të mirat e Poetit (dy elegji të dhe disa sonetet), po përmend disa vjersha të rinisë së parë të tij. Madje, ai lë mënjanë disa vjersha mjaft të bukura patriotike si "Rrutullupë", "Për vdekjen e Pjetër Irianit".

Sikur kjo tezë, që e përmbys krejt gjykimin për Poetin, t'i përgjigjej realitetit, do të mbetej një enigmë entuziazmi i mjaft autorëve (kritikë dhe poetë) italianë bashkëkohës. Në qoftë se entuziazmi i studiuesve arbëreshë dhe shqiptarë për Seremben do të mund të shpjegohej disi me ndjenjën e ekzaltuar nacionaliste, si do të shpjegohej entuziazmi i italianëve dhe, shumë më vonë, vlerësimi i lartë i ruses Serkova?

Mendoj se kjo tezë mund të ketë lindur nga prirja për origjinalitet *me çdo kusht*.

Poezia e Serembes fshihet edhe enigma të tjera. Për mendimin tonë, është e çuditshme ndërthurja e elitarizmit me ndikimin nga folklori në këtë poezi. Një ndërthurje të tillë e paraqiste edhe poezia e De Radës, po këngët epiko-legjendare që e frymëzuan atë kishin një nivel estetik më të lartë se këngët popullore lirike të lindura në mjedisin arbëresh që frymëzuan Seremben dhe që ishin më të thjeshta e të qarta.

Mandej De Rada e kishte huazuar metrikën popullore arbëreshe, ndërsa Serembeja lëvroi forma të rafinuara si sonetin, oden, elegjinë.

I çuditshëm ka qenë edhe anashkalimi i ndikimit të Serembes prej folklorit nga studiuesit të cilët ose e mohuan krejt si Çabej ose s'e përfillën si Shuteriqi apo Gradilone.

Për t'u vënë re është edhe naiviteti i poezisë së Serembes që shfaqet në një çiltërsi gati fëmijërore në kundërshtim me letrarizmin e romantizmave kryesore evropiane. Serembeja i paraprin asaj "poetike të fëmijës" që do të zhvillonte më vonë poeti dekadent italian Paskoli.

Kjo poetikë bie në kundërshtim me ato hove dhe vrulle që e çojnë poetin te *titanizmi* i poezisë "Zotit".

Po e tillë është poezia e Serembes, tepër tërheqëse dhe e pasur me kontradikta, si një shpellë e mbushur me enigma ende, pas aq vitesh studimi nga autorë nga më të ndryshmit.



POETI ZEF SEREMBE (Pikturë nga P. CENO, 1995)

# MARSI I PËRHERSHËM I BURRIT ME MBIEMËR KRUJËN...

Nga Visar Zhiti

## SHQIPTARËT JANË MË SHUMË SE SHQIPËRIA

Shqiptarët e fortë, ata të mirët, bujarët, me një madhësi të brendshme, por që u shfaqet, mjafton një dramë, një pabesi e tjetrit, një mort, një dasmë, sidomos një valëvitje flamuri mbi një përgjigje a llogore, janë më të fortë se Shqipëria vetë dhe atë mirësi prej tyre e ka vendi, bujarinë proverbiale dhe atë madhësi tradicionale, e adhuroar nga të huajt, udhëtarë, pelegrinë, pushtues, poetë... Bajroni tha se shqiptarët kanë virtyte, por ah, t'i kishin më të arrira.

Shqiptarët janë më shumë se Shqipëria dhe duket se u ka munguar vetëm arritja... - kam menduar shpesh, natyrisht që kemi Shqipëri, aq sa është, gjushtë, kemi dhe Republikë të pavarur të Kosovës, por më trishton pa masë bjerrja, ajo shprishje që i erdhi racës shqiptare nga vetvetja ose pothuajse...

Dekadat e diktaturës komuniste dhe për pasojë dhe postdiktatura sollën më dëm në prishjen e racës se shekujt e pushtimit, e kam fjalën për virtytet njerëzore, aq sa më duket se pushtet ka patur më shumë e keqja.

## QË MENDOVA ASHTU?

...shkak ishte dhe Mustafa Merlika - Kruja, ka datëndjen sot, në mes të marsit të trimërisë siç e quan kënga e popullit, teksa prilli i dashurisë duket se veç vonon. Ai është personalitet me rëndësi i librit shqip, është historian, kur s'kishte dhe aq të tillë, gjuhëtar në nivel shkencëtar, kur s'kishte dhe aq të tillë, përkthyes, të mbijetesës, mjeshtër në të shkruar, pra dhe stilist, zgjodhi emrin letrar *Shpend Bardhi*, i qartë në mendime, i guximshëm, di të shquajë vlerat e kundërshtarit dhe meritat e armikut.

Po ai dinte historinë e kombit të tij ashtu si të familjes së tij, bëri Shqipëri bashkë me ata që e bënë, është një nga burrat e Pavarësisë së nëntorit 1912, ndërsa kur bëhej "Pavarësia e Dytë, Kongresi i Lushnjës në janar të 1920, nuk ishte në sallën historike, por maleve, organizonte qendresën antiserbe në Dibër dhe Lumë, do të ishte për një "Shqipëri romane" - nëse mund ta themi kështu gjatë Luftës II Botërore dhe në vitin 1941, nën pushtimin fashist, në sopatat e Liktorit, ai do të ishte kryeministër - kolaboracionist si arritje e nacionalizmit, sa ç'mund të arrihej në pushtim.

Dhe pikërisht për këtë fitimtarët e mbas Luftë II Botërore, adhuroes më shumë te prangave se të librit, do ta përndiqnin, duke dashur vrasjen e tij, duke e mbuluar me harrim emrin dhe veprën madhore.

Po ai tashmë është vetë pjesë e historisë.



ishin dhe mbrojtës të pasqor të hebrenjve, që përndiqeshin kudo. Jo vetëm që nuk do t'i dorëzonin te pushtuesi nazi-fashist, por do të vinin të tjerë nga të mundnin dhe Shqipëria do të ishte vendi që do të kishte hebrenj më shumë pasi mbaroi lufta, sesa kur nisi.

Dhe pikërisht do të iknin si çifuti në shkretëtirë, personalitete të tjera të vendit, intelektualë...

VAZHDIM I DËNIMIT,  
KARTELË TJETËR  
Eugjen Merlika

...që ka gjysh Mustafa Merlika - Krujën, e rëndë kjo për në burg, kryeministrin e dënuar, kaq duhej, se nuk i kujtonin më që ai ishte patrioti, albanologu dhe gjuhëtar i shkëlqyer, i ikur nga regjimi, patjetër që familja e mbetur "në mëshirë të të pamëshirshmeve", do të përfundonte internimeve e do të kërcënoheshin me burg.

Eugjenin e kisha parë kur vinte me biçikletë nga balta e internimeve në Lushnjë, isha gjimnazist, por do të na bashkonte burgu i Spaçi. Pastaj dhe Italia, ku ai mërgoi dhe unë punoja në ambasadë në Romë. Në burg i kërkoja fjalë italisht, tani shkëmbenim nga librat tanë,

Pasi botoi përmbledhjen me poezi "Muzg", Eugjeni do të botonte memuaristikë dhe artikuj të shumtë në gazeta, vëzhgime politike, kritika letrare, ese, që do t'i përmbledhte në libra të ndryshëm, ndër më të fundit "Elegji për brezin tim" dhe pastaj do t'i hynte një pune të madhe, akademike, që duhej ta bënin akademitë, përgatiti gjithë Veprën e Mustafa Krujës, studime, histori, gjuhësi, polemika, letërkëmbim, etj, e cila, duke dalë në këto vite, plotësoi një vend bosh në studimet shqiptare, me një vlerë të rëndësishme kombëtare.

[...]

Kur i bënë atentat Luigj Gurakuqit në Bari në rrugën që mban emrin e tij, bashkë me të ra dhe një kukull, e kishte marrë t'ia çonte një vogëlusheje... që do të bëhej nëna e Eugjenit.



E lindur në Romë, Elena Gjika kreu studimet për letërsi me rezultate të shkëlqyera në Universitetin e Napolit dhe mes zgjedhjes për të mbetur pedagoge në Itali apo të shkonte në Shqipëri, parapëlqeu këtë të dytën, shkoi pas të shoqit, inxhinier Petritit, diplomuar në Francë, i biri i Mustafa Krujës.

Elena, e talentuar në gjuhësi, do të bashkëpunonte me vjehrrin për Fjalorin e madh të Shqipes. i shoqi merrej me ndërtimet në Shqipëri, por atë e arrestojnë dy vjet pas mbarimit të Luftës, se bënte pjesë në ata që donin të krijonin një parti liberale opozitare. E dënojnë me 15 vjet burg.

Eugjenin 6 vjeçar me nënën dhe gjyshen i dërgojnë në kampin-aushvic të Tepelenës Që fëmijë provoi qelitë. Pasi mbyllet, i çojnë në internim në Lushnjë, fshatrave. Po prisnin që Eugjenin të mbushte moshën për burg. Dhe e arrestojnë në vitin 1980, e dënojnë pa bërë gjë fare me 8 vjet burg...

Kështu deri sa bie Muri...

Nga Zonja Elena kanë mbetur dy sprova, një e shkruar për studentët në Itali, për



\* \* \*

Dua ta kujtoj sërish. Në librin tim, "Kartela të Realizmit të dënuar" është dhe KARTELA Mustafa Merlika-Kruja, (1887 - 1958)

...Do të ikte.

Kryeministër i Shqipërisë, i diplomuar për shkencat politike jashtë vendit, bashkëpunëtor i Ismail Qemalit dhe Luigj Gurakuqit në Shpalljen e Pavarësisë, që pëveç punëve si patriot dhe historian, shquhet dhe si gjuhëtar i klasit të parë dhe la në dorëshkrim një Fjalor prej 2.400 faqesh, me 30.000 fjalë shqip.

Kjo lëndë madhore mbeti në kthetrat e fitimtarëve dhe ata e dinë ç'bënë me të, si e

shqyen, e përvetësuan, e dogjën.

Libra të tjerë të Mustafa Merlika-Krujës janë: "Anthologji Historike", "Letërkëmbim 1947-1958", "Kujtime vogjlire e rinije", "Aleksandr' i Madh" dhe "Vëzhgime lliroshqiptare", punime shkencore origjinale, si dhe përkthime prej tij të veprave themelore që lidhen me ilirët dhe pasardhësit e tyre, shqiptarët, një ndihmesë e vyer dhe me rëndësi.

PO Ç'KA THËNË BABAI I GAZETARISË MODERNE ITALIANE, IDRO MONTANELI.

Gazetari i famshëm italian Indro Montaneli, autori i një libri trallisës për Shqipërinë, ja çdo të shkruante për qeverinë e Mustafa Krujës në "Corriere della sera": "Ministrat shqiptarë... të gjithë vishen

thjesht, janë pak të ashpër, por të përgatitur mirë teorikisht. E kaluara e tyre është njëlloj: kanë vuajtur për vendin e tyre. Idetë e tyre janë të lidhura me disa dogma themelore: njësisia territoriale e Shqipërisë, autonomia e brendshme, mbrojtja e racës dhe e pasurisë kulturore, bashkëpunimi me Italinë mbi bazën e të drejtave dhe të detyrimeve të përbashkëta. Janë të ndershëm e të varfër. Janë njerëz të veprimit e jo të burokracisë".

Dhe për vetë kryeministrin: "Suksesi e nderimet nuk kanë mundur ta shndërrojnë natyrën dhe sjelljen e jashtme të këtij burri... (që) nuk i jep rëndësi vetes me poza e me fjalë të mëdha. Vazhdon të flasë me maturi e... thotë të vërtetën... Jeta e tij ngjan me atë të Mazzini-t e programi i tij është ky: dua një Shqipëri të bashkuar në kufijtë e saj natyrorë."

Kryeministri Kruja dhe qeveria e tij do të

personalitetin e të riut, dhe tjetra për dhunën në internim në Tepelenë, ku nëpërkëmbej edhe jetesa si qenie, por ja, që çuditërisht, një herë u arrit të krenotohej një Krishtlindje, megjithëse të ndaluara, me një prift të internuar dhe korin ilegal të të internuarave. Ishte liturgjia e ëndrrës.

Vuajtjet dhe dënimet bënë që të humbte vepra e saj, të mos shkruhej dot. U rikthye atje ku kishte lindur, në Itali, ku dhe mbylli sytë afër Romës në vitin e dytë të mijëvjeçarit të ri, por kërkoi të prehej në vendin, ku u lodh aq shumë, në Shqipëri. Emri i saj ndrit përzishëm në varrezën familjare në Krujë, ku ka dhe një shesh tani me emrin: Mustafa Kruja.

Vepra "Merlika-Kruja" përmbledh kohë të tre brezave, kohë të përjetësisë së Shqipërisë.

DY LIBRAT E DIJETARIT:

I kam ndër duar dy librat më të fundit të tij si festë e datëlindjes. Vepra të kujtesës kolektive dhe të mbijetesës, "Lashtësi shqiptar" – 2021 dhe "Historij' e vonë" – 2023, botimet "Berk", emërtimi i së cilës më emocionon: "një formë gjuhësore arkaike e shqipes, që shenjon **librin**, gjurmët tashmë të humbura..." në mesjetën shqiptare dhe të rishfaqura po në atë mesjetë, më saktë me rilindjen e vonuar. I shkon shumë dhe misionit të Mustafa Merlika – Krujës.

"Lashtësi shqiptar" përmbledh shkrime historike dhe përkthime të tij, të përgatitura nga nipi, Eugjeni, me një parathënie nga arkivisti Sokol Çunga, studiues dhe kritik letrar, përkthyes dhe ai, ku thotë se "ky është një tekst i historisë së Shqipërisë... por në të njëjtën kohë është dhe histori e vetë autorit të tij."

Tematikë enciklopedike, që nga parahistoria, legjendat, pellazgët, epoka ilirjane, helenët, thrakët, maqedonët, Aleksandri i Madh, Pirro, Roma, kryqtarët, Bullgaria e Dytë, Beteja e Fushë Kosovës, Arbëreshët, Histori e Skënderbeut, etj...

Libri tjetër, "Historij' e vonë", me "Kapituj të randsishëm të historisë së shtetit shqiptar", ka po atë enciklopedizëm, por kombëtar, nis me Gjomarkajt, Ali Tepelena, Lidhja e Prizrenit, revolucioni Xhon-Turk, kryengritjet, 1912, Kosova dhe Vlora, Toptani, Bajram Curri, Kongresi i Durrësit, Konferenca e Parisit, Fan S. Noli, Luigj Gurakuqi, etj, Balli Kombëtar, Konferenca e Mukjes... Konferenca e Parisit... çfarë i duhet shkollës shqipe dhe deri "Pse Enver Hoxha asht në krye"... "në skenën tragjike të revolucionit komunist shqiptar".

Botimi është përgatitur nga Anna Shkreli, me parathënie nga Eugjen Merlika, të cilën e titullon "Rilindasi i brezit të fundit".

Barra i ka rënë atij, prurësit dhe përkujdesësit të gjithë Veprës së Mustafa Merlika – Krujës, një ish i burgosur politik, ai i bën të gjitha, madje me paratë e tij nga dëmspërblimi i mangët i burgut. Si bashkëvuajtës me mua, më dërgoi dhe dy botimet e fundit këtu, jo shumë larg nga vendi, ku gjyshi i tij si i mërguar politik mbylli sytë përgjithmonë, në Niagara Falls, në një dimër në SHBA.

Bashkohemi me atë që shkruan shkrimtari themeltar Ernest Koliqi: "Veprat e Mustafa Krujës mbesin dëshmimi i shkëlqyeshëm i kontributit që ai i solli naltësimi moral e kulturor të botës shqiptare."

Botimi i tyre duhej të ishte detyre dhe punë e akademive dhe katedrave të historisë, gjuhësisë dhe albanologjisë, e Lidhjes së Shkrimtarëve si për një akademik dhe historian të shquar, gjuhëtar, albanolog dhe stilist të shqipes, e Ministrive të Kulturës për një autoritet të kulturës, e Kryeministrisë për një kryeministër.

Mustafa Merlika – Kruja tashmë është një institucion. Nëse Shqipëria nuk do të dijë që përvojën dhe arritjet e tij ashtu si dhe humbjet t'i bëjë pjesë të përvojës, arritjeve dhe humbjeve të saj, do të dëmtojë kështu historinë dhe kujtesën e popullit, por dhe kritikën e ardhmërisë.

# NAUM PRIFTI NJË SHKRIMTAR I EPËRM I TREGIMIT SHQIPTAR

Prof. dr. Bardhosh Gaçe



cilët përthyejnë në një farë kuptimi kohët e tij, për shkakun se Naum Prifti si tregimtar ishte mjaft i lidhur me faktet e tija jetësore. Lidhur me një perceptim dhe një të vërtetë të tillë, kur është pyetur se ç'mendonte për muzën, d.m.th. atë gjendjen që krijuesit i vjen papritur dhe nga lart, ai shprehet se nuk ka muzë, asgjë nuk vjen nga jashtë nëse letërsia, personazhi, ngjarja nuk është brenda shkrimtarit, brenda gjendjes së tij emocionale dhe përjetimeve të tij. Puna e shkrimtarit është se talenti do vetëm punë, se ai është gjëja më e pakët në zejen e letërsisë.

Duke u larguar nga jeta në moshën mbi 90-vjeçare, e cila është një humbje e madhe për letërsinë shqiptare, Naum Prifti na ka lënë një pasuri të rrallë të mendimit për letërsinë në përgjithësi, por veçmas mbi tregimin, mjeshtrinë e të shkruarit, çështjet e personazheve, subjektet, rrugëtimin e tij, dhe si mund të shkruhet një tregim. Natyrisht vetë përvoja e tij shkrimore është një lloj shkolle për tregimin dhe krijimtarinë tjetër, pasi ai shkroi tregime, drama, komedi, novela, skenarë filmash, pjesë për teatrin e kukullave, skenarë për filma vizatimorë, biografi, artikuj kritikë, publicistikë, etj., në korpusin e të cilit janë afro 100 vepra letrare, studime të shkruara gjatë viteve që përbëjnë qindra analiza, diskutime, letërkëmbime, biseda, ku shpaloset një botë e madhe e një shkrimtari me përvojë të çmuar.

Naum Prifti ndër shumë libra që shkroi i dha lexuesit tituj të rëndësishëm të tregimit shqiptar, si: "Tregime të fshatit", Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1956; "Lëkura e Ujkut", Tiranë 1958, "Çezma e Floririt", Tiranë 1960, "Një pushkë më shumë" (Ribotuar më 1965) Tiranë 1962; "Tregime" Tiranë, 1962; "Çezma e floririt", (greqisht), Tiranë 1962; "Lëkura e Ujkut" (Anglisht), përkthyer nga Peter Prifti, Tiranë, 1962; "The betrothed" ("E fejuara"), (anglisht). Botuar në Kinë 1965; "Litar i zjarrtë", Tiranë 1969; "Tregime të zgjedhura", Tiranë 1972, "Njerëz të kësaj toke", Tiranë 1979, "Njëqind vjet", Tiranë 1982, "Tre vetë kapërcejnë malin", Rilindja, Prishtinë, 1983; "The Golden Fountain" ("Çezma e Floririt", - Anglisht), përkthyer nga Peter Prifti, Shkodër, 1998; "Nëna e diellit" (Mite-legjenda-përralla), Tiranë, 2000; "Yjet ndritin lart" (Novela), Pejë, 2002; "As Miço, As Muço", "Tregime dhe skica humoristike", Tiranë 2003 etj., ku një pjesë e tyre u bënë skenarë, si 1956: "Tregimet e fshatit", 1960: "Çezma e Floririt" 1976: "Pika e ujit", 1976: "Zani partizani", 1978: "Udha e shkronjave", 1982: "Era e ngrohtë e thellësive", 1984: "Kush vdes në këmbë", 1984: "Fejesa e Blertës", 1988: "Tre vetë kapërcejnë malin", të cilët kanë krijuar një vijimësi të prezencës si tregimtarë në tregimin shqiptarë.

Tregimi i Naum Priftit reflekton në hapësirën kohore nga ai vjen dy fondamentet më të rëndësishme të tij, të cilët unë mendoj se janë: -Një tregimtar i pangjashëm me profil të identifikueshëm, dhe -Naum Prifti është një shkollë për tregimin dhe tregimtarët, qoftë kur i lexon tregimet e tij, qoftë kur ai flet për krijimtarinë e tij apo



(Vijon në faqen 8)

## (Vijon nga faqja 7)

kur jep këshilla, zakonisht përmes bisedave apo intervistave, pasi atë e përshkonte një natyrshmëri e jashtëzakonshme, siç janë zakonisht njerëzit e ditur dhe të shtruar.

Përvoja jetësore, e cila zë gati të gjithë krijimtarinë e tij në prozë, por dhe në ndonjë zhanër tjetër, ka bërë që në tregimin e tij të shfaqen dhe të jetësohen njerëz të thjeshtë, dhe kjo ka nisur që në krijim e tij të parë. Krijimi i parë i tij, siç ai kujton, ka qenë një vjershë humoristike, të cilën e ka shkruar në moshën 12-vjeçare dhe e ka burimin nga frymëzimi që i kanë sjellë motivet popullore të vendlindjes. Dëshira dhe pasioni për të shkruar vjersha të natyrës humoristike ka vijuar, ndërsa gazeta e murit në shkollë ka qenë gazeta e parë ku ai ka "botuar" dhe krijimet e para, duke qenë dhe hapat e parë të krijimtarisë së tij, për të arritur më vonë tek përmbledhja "Tregimet e fshatit" (1956).

Në emocionet e tij ai kujton jehonën që pati tregimi "Çezma e Floririt" e vitit 1960, një libër që e bëri atë të njohur jo vetëm për natyrën jetësore që i përshkonte ato, por dhe për një mënyrë të rrëfyeri, ku një sens humori i hollë i bënte kaq të afërta dhe të përjetueshme ngjarjet, mjediset dhe personazhet e tregimeve. Vitet '60 përbënin gjithashtu një kthesë në letërsinë shqiptare, për shkakun se në të u shfaqën emra të rinj dhe shumë të talentuar, të cilët iu përgjigjeshin kërkesave të letërsisë së kohës.

Naum Prifti duket se kishte lindur për të shkruar, atë e kanë frymëzuar dhe e kanë edukuar në leximin e letërsisë autorë të traditës, që siç shprehet ai, Sterio Spasse me librin e tij "Nusja pa duvak" ka mbetur në kujtesën e tij përmes personazhit të njohur të Xha Koroveshit, ndërsa për kulturën e leximit ai tregon: "Unë u rrita në fshat, një lloj si lulet e egra në mal, secila me ngjyra e aromë të veçantë. Pata fat që më ra në dorë "Shkrimtarët Shqiptarë" (pjesa I), një antologji e mrekullueshme hartuar nga Ernest Koliqi, Namik Resuli, Filip Fishta me jetëshkrimet shkrimtarësh dhe copa të zgjedhura. Më vonë u mahnita kur më ra në dorë romani I M. Zevacco-s a "Ura e Psherëtimave," e pastaj me radhë "Bija e Mallkuar," "Zonja me Kamelie," e A. Dumas, etj. Fshati im që ndryshe nga të tjerët. Nja pesë a gjashtë familje nëpunësish apo arsimtarësh blinin libra dhe kishin biblioteka modeste në shtëpitë e tyre. Ky qe favor i madh për një djalë fshati. Me shokët e mi të apasionuar pas librave, ne i huanim ato duke i kaluar dorë më dorë. Sa herë vija në Korçë pas luftime gjithmonë blija libra, kryesisht romane të përthyer..." pra, siç dhe kuptohet, ai ka qenë një djalë që ka lexuar gjithçka i ka ardhur në dorë, duke mos trashëguar asgjë nga familja, se siç thotë ai, nëse do të ishte kështu, ai duhej të ishte një gurskalitës.

Në opusin e librave me tregime të Naum Priftit shquan tregimi "Pylli i lirisë", i cili për shkakun e të vërtetave të mëdha, elegancës me të cilën është shkruar, motivet dhe emocionet që përcjell, personazhet dhe të gjithë mjedisin që shpërfaq është lexuar në shumë mënyra, dhe në të gjitha rastet ai është vlerësuar mjaft mirë. Autori tregon se sa e rëndësishme është që të kuptosh se ku gjendet vërtetë një ngjarje për ta rrëfyer në formën e tregimit, duke treguar gjithashtu se pjesa më e madhe e tregimeve të tij është një përvojë jetësore, personazhet e të cilëve ai i ka gjetur mes njerëzve dhe në mjediset ku ka punuar dhe ka jetuar.

Për tregimin "Njeriu që ndiqte kuajt", ndoshta tregimi më i bukur në letërsinë shqiptare, ai tregon për personazhin kryesor dhe ngjarjen: "Një personazh të tillë unë e gjeta në Divjakë kur njoha Vasil Shoren, protagonistin e tregimit "Njeriu që ndiqte kuajt," Vlash Zakën. U miqësova me të dhe ai më tregonte ngjarje nga jeta e tij. Qe i vetmi që i kapte kuajt e lëshuar azat në pyllin e Divjakës, në kohën e mbretërisë, duke i ndjekur nga Shkumbini në Seman, deri sa ata kapiteshin. Ai qe maratonmak i lindur dhe mund të vraponte gjithë ditën. E njoha kur qe plak dhe fatkeq, mbasi gruaja i kishte

vdekur, vajza e vetme qe martuar në një fshat tjetër dhe ai jetonte i vetmuar në kasollen e tij.

Siç dhe kuptohet, rrëfimin e tregimit të njohur e përshkon koncepti i burimit jetësor që kanë tregimet e tij, të cilët më së shumti ai i ka gjetur mes njerëzve ku ka jetuar, por që mjeshtërisht ai i ka kthyer në tregime dhe në novela të mrekullueshme, siç thotë dhe për tregimet "Gërvishtje prapa derës" dhe "I Plotfuqishmi në shkollën tonë".

Naum Prifti gjatë gjithë jetës mbeti tek zhanri i tregimit dhe në ndonjë rast dhe tek novela dhe pse disa nga novelat apo tregimet e gjata, ku ngjeshën ngjarjet dhe personazhet mbartin fuqi dhe përçojnë ide të rëndësishme, kritika i ka quajtur dhe romane. Ai nuk i kushtoi kurrë rëndësi gjinisë në të cilën shkruante. Kur ai thotë se "...te të gjitha tregimet e mia bërthama e ngjarjes është e vërtetë", çka nënkupton se ai nuk ka krijuar (shpikur) subjekte, shqisa e tij prej tregimtarit, ka arritur që të gjejë gjithmonë mes njerëzve motivet, zakonisht ato "që lidheshin me ndryshimet morale të shoqërisë sonë", siç thotë ai, tregime në të cilët karakteret shfaqeshin përmes dialogëve të zhdërvjellë dhe të kursyer, të cilët parathoshin dhe dramaturgun, e që në të vërtetë Naum Prifti shkroi dhe drama, që krahas suksesve pati dhe konsekuencat e tij për shkakun e censurës dhe vëmendjes së shtuar që ideologjia e kohës kishte veçmas ndaj artit dramatik dhe skenës ku ato luheshin.

Ndoshta një nga tregimet më të bukur, me një lloj fladi që e përcjell gjithë hapësirën kohore dhe njerëzore që ai zë është tregimi "Erë mali- Erë fushe", një tregim jetësor, me detaje të imta në mjedisë dhe në karakteret njerëzore, për të cilin autori thotë se në atë tregim, ai ka pikturuar adoleshencën e tij, dhe se të gjithë ngjarjet dhe karakteret njerëzore ishin të vërtetë, tregim për të cilin Dritëro Agolli thoshte se është më i miri i llojit të tij, të shkruar ndonjëherë në prozën shqiptare.

Duke qenë një njohës i mirë i tregimtarëve të çmuar të botës si: Mopasan, Alfons Dode, Çehovi, Tolstoi, Turgeniev, Shollohov, London, Xh. Gollsuorth dhe të tjerë, në stilin e tregimtarit të njohur Naum Prifti do të kishte gjithmonë një përvojë të tregimit më të mirë botëror, e cila kishte gjetur shprehjen e vet në një tregimtar të talentuar siç ishte Prifti.

Lidhur me tregimin, Naum Prifti tregonte se në praktikën e tij, duke mos qenë shumë ithtar i çështjeve teorike dhe artificiale mbi krijimtarinë letrare në përgjithësi, dëshmonte, se tregimi është një motiv interesant, që ngjan me vrapimin dhe që duhet të kryhet menjëherë, ndërsa nevoja për të krijuar dhe ruajtur ritmin e brendshëm, përveçse e bën atë interesant dhe tregon se ka zbuluesë, në përvojën e tij, kjo lidhje dhe me gjetjen dhe prurjen e personazheve që kishin një lloj harmonie me idetë e autorit, dhe kjo kishte shumë

rëndësi për të.

Naum Prifti u shqua për krijimin e personazheve komplekse, ku bie në sy (sipas Vath Koresit) një prirje e sinqertë e tregimtarit për njerëzit e thjeshtë dhe të mirë, prandaj njerëzit e kësaj natyre zënë vend të dukshëm në tregimet e tij. Lidhur me konceptin e të bukurës në prozë, e cila është vërtetë e vështirë t'i afrohet poezisë, mjeshtri i tregimit, Naum Prifti, tregon se proza shqiptare ka tregimtarë të tillë, si: Mitrush Kuteli, Jakov Xoxe, Petro Marko, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi, Dhimitër Xhuvani, Sotir Andoni, Vath Koreshi, Ismail Kadare, Nasi Lera, e Gazmend Kongoli, duke mos harruar atë që thoshte Çehovi lidhur me tregimet e tij, se "...ndërsa unë përpiqesha të zbuloja anët pozitive të shoqërisë sonë, përballës me anët e shëmtuara të jetës ruse". E bukura, si nocion estetik është e thjeshtë, prandaj ajo mbahet mend shumë shpejt, kështu ai kujton, se në rininë e tij e kishte mësuar përmendësh fillimin e romanit "Kasollja" të Ibanjezit, si një rrëfim i çmuar mbi pasionin dhe këmbënguljen e tij, lidhur me letërsinë dhe veçmas tregimin e prozën.

Naum Prifti ishte novelist, tregimtar, dramaturg, skenarist, kritik, fabulist, gjurmues i folklorit, mjeshtër i shqipërimin, i cili falë talentit dhe mjeshtërisë arriti t'i rezistojë ndëshkimit në ekstrem të censurës, jo se nuk u ndëshkua. Ai përveçse ishte dhe mbetet një tregimtar i talentuar, ai është një nga mjeshtrit e lëvrimin të gjuhës shqipe, e cila në veprat e emrave të mëdhenj të letërsisë shqipe merr vlera dhe forcë.

Vepra e Naum Priftit, në gati 100 tituj të njohur i ka rezistuar kohës, një vlerë për të cilën prof. dr Jorgo Bullo shkruan: "Naum Prifti, i cili ia përkushtoi jetën lëvrimin të fjalës shqipe, është protagonist i kulturës shqiptare me një vepër që i ka qëndruar kohës, e papërdhosur dhe e shëndetshme.", duke nënvizuar stilin lirik që i ngjan vendlindjes së tij, Kolonjës. Ai filloi të shkruajë në kohë të vështira, ndoshta me një entuziazëm të tejkaluar, por përvoja e gjatë, siç duket ia ndryshoi opininë. Në librin e tij jetësor, të titulluar "Midis dy kohësh" ndër të tjera shkruan: "Pohimet e kritikëve, se Gëteja, Balzaku, Tolstoi, Dikensi, Migjeni etj., i kishin ndër vite më parë ndryshimet që po sillte koha, më dukeshin spekulime sa isha letrar i ri. Mos vallë shkrimtarët kishin një shqisë të gjashtë apo antena të posaçme për të parandier shndërrimet që po ravijëzoheshin në horizontin e largët? Më vonë, nga përvoja e jetës nën diktaturë, fillova të besoj se në ato pohime s'kishte asgjë metafizike. Ata janë në gjendje të vërejnë shenjat e sigurta që paralajmërojnë ndryshimet e regjimeve dhe të sistemeve, si tatëpjeta ekonomike, paraliza e mendimit, konformizmi, dualizmi midis mendimeve dhe fjalës, bjerrja e virtyeve, arbitrariteti i shoqëruar me dogmatizëm të hekurt, egërsia e pushtetit, humbja e idealeve dhe besimit tek e ardhmja.", e cila në tregimet



e Naum Priftit është shfaqur përmes ngjarjeve dhe personazheve që ai i ka njohur vetë në mjediset jetësor. Pa dyshimin më të vogël, kjo konsideratë e imët, që lidhet me misionin që ka letërsia artistike, domosdo është dhe një lloj vetërrëfimi, i cili e ka shoqëruar tregimtarin në pjesën më të madhe të jetës, duke vërejtur realitetin në të cilin ka jetuar.

Duke qenë njëri nga mjeshtërit e tregimit, pjesa më e madhe e tregimeve të tij janë bërë skenarë filmash, me temë nga lufta dhe realiteti në të cilin ai ka jetuar. Drama e tij e parë "Rrethimi i Bardhë" (1964) u shkrua në kohën më të rëndësishme të saj, por dhe më problematike, pasi ajo ishte vënë nën vëzhgimin e hollë të kritikës, për t'i imponuar kursin ideologjik të parimeve te realizmit socialist. Pas vënies në skenë nga teatri "Skampa" në Elbasan dhe atij "Andon Zako Çajupi" në Korçë, krahas suksesit, ajo u kritikua, pasi në një sens të hollë, në të kishte një moment që autori shfaqte dyshimin, se partia ishte larg klasës punëtore, shpirtërisht dhe fizikisht, kështu që targa e ashpër "dramë e gabuar" do ta ndiqte atë për shumë kohë nga pas, jo vetëm kur u dërgua për riedukim.

Të shkruarit e dramës nga Naum Prifti buronte nga talenti prej tregimtarit, veçmas nga dialogët e tij të mrekullueshëm në tregim, kështu që mjaft nga dramet e tij, si "Mulliri i Kostë Bardhit" (1969), "Plumbat e shkronjavë" (1978), "Një verë e thatë" ("Zani-Partizani") (1981), "Luftëtari më i ri" (1981), komeditë "Dasmë pa nuse" (1969), "Talent i rrallë" (1980) dhe vepra të tjera, kanë një ind narrativë prej tregimi. Ai po ashtu shkroi dhe letërsi për fëmijë, në të cilën la shenjën e tij, duke e nxjerrë atë nga kllapia dhe skematizmi. Në kujtesën dhe shkëlqimin e filmit shqiptar, skenarët e Naum Priftit në filma të tillë, si "Pylli i Lirisë", "Ndjekësi i kalit" (tregim i Naum Priftit, i skenuar për film nga Nasi Lera), "Tokë e përgjakur" etj., plotësojnë me një lloj shkëlqimi profilin e shkrimtarit Naum Priftit, i cili i ka lënë kaq shumë vlera letrare kulturës shqiptare. Gjithsesi i nderuar me çmime dhe medalje, Naum Prifti arriti ta lërë veten në letërsinë dhe kujtesën e shkëlqyer të shqiptarëve që nga krijimi i parë deri tek ai i fundit.

Tregimi i tij do të vijojë të mbetet një shkollë e çmuar për tregimin që shkruhet sot dhe do të shkruhet më vonë, prandaj hulumtimet dhe studimet bashkëkohore duket t'i orientojnë studentët dhe doktorantët drejt vlerave të tilla, të cilat kanë ende shumë për t'i zbuluar. Askush më mirë se Naum Prifti nuk arriti të bënte bashkë në një alkimi ekzistenciale natyrën memuaristike të motiveve të tij me atë që ai jetoi vetë. Vetëm një krijimtar i mirë mund të komunikojë në mënyrë të tillë, duke u bërë një i epërm në lëvrimin e prozës shqiptare.

Tiranë-Vlorë, 11 mars 2024





Ndonëse gjerësisht mes studiuesish pranohet se është gjysma e dytë e shekullit të nëntëmbëdhjetë, me gjithë deformimet formësore dhe përmbajtësore letrare, ajo që shënoi dhe nisjen e njëpasnjëshme të lëkundjeve të normave letrare, pikasja e tipareve të një rryme brenda një tjetre është një debat që ka nisur herët, qysh me rafinimin e hershëm të teorive të letërsisë. Dhe po njëllon, duke pranuar se letërsia reflekton deri në njëfarë pike edhe faktorë ekstra letrarë, atëherë përveç raportit narrator-tekst, a na hyn në "lojë" dhe koncepti i autorit bashkë me origjinën e formimit të identitetit të tij kulturor?

Me zenitin e '20-'30-ës në arenën tonë letrare, nuk mund të lëmë pa identifikuar një faktor jashtë-letrar që ka kontribuar në të, dhe ai është vendformimi kulturor i shkrimtarëve, qofshin këta poetë apo prozatorë, duke ia atribuuar kësaj të fundit një peshë mjaftueshëm të konsiderueshme në larmishmërinë zhanërore dhe gjinore. Krijimtaria letrare e Mitrush Kutelit, ndonëse e shtrirë në gjini të ndryshme, duket sikur shkëlqimin e vet e merr me prozën e shkurtër, veçanërisht tregimet, apo siç shkrimtari vetë i quan *rrëfime/rrëfenja*, me strukturë kompozicionale narrative të tillë që shkon në një linjë moderne zhvillimi me prodhimin letrar në ambientin e formuar estetikisht të '20-'30-ës së shekullit të kaluar. Me një frymë të re, mes popullores, folkloristike si dhe modernitetit që kish' prekur letrat shqip, Mitrush Kuteli e pasuron narrativen shqip me një prodhim të ri letrar me tipare romantike, që shpesh e orientojnë atë drejt një rryme po aq ndikuese në letërsinë botërore, një degëzimi të romantizmit europian, që është pikërisht *romantizmi i errët*. Romantizmi i errët (*dark romanticism*) është një lëvizje letrare që u shfaq në fundshekullin e nëntëmbëdhjetë, fillimisht në Europë e mandej në Amerikë. Ai eksploron aspektet më të errëta të natyrës njerëzore dhe elementit të mbinatyrshëm. I ndërtuar me një sentimentalizëm që vetëm romantizmit mund t'i shkonte për shtat, romantizmi i errët poetizon vdekjen, të mbinatyrshmen, paranormalen, normalizon kontaktin e botës së të vdekurve me atë të të gjallëve, dhimbjen, frikën, mëkatit dhe kalimin nga vdekja në jetë, derisa i sheshon kufijtë drejt normalizimit. Në historinë e letërsisë botërore, kritika ka parë si përfaqësuesin më të denjë të romantizmit të errët Edgar Allan Poe-n, megjithatë, duhet theksuar këtu se në poetikën e tij shpesh hasim dhe gjurmë të gotikes. Kjo prani e elementit gotik në letërsi, thurur me sentimentalizmin, emocionin, ekstazën shpirtërore, sakralen, sublimen në një besim të thellë të unit individual, e orienton rrymën romantike drejt epitetit të *errët*. Kështu, portreti i romantizmit të errët plotësohet nga zymtësia e romantizmit tipik fillestar europian dhe pranisë së elementeve gotike, veçanërisht ato të dikotomive *jetë-vdekje* dhe *botë e të vdekurve - botë e të gjallëve*. Ndonëse romantizmi fillestar kërkon të lartësojë qëllimin e qenësisë njerëzore, romantizmi i errët karakterizohet nga pushtimi i këtij shpirti të lartësuar nga emocione, pasojë e ngjarjeve me karakter nganjëherë edhe gotik. Mungesa e qëllimësisë në lartësimin e unit individual nga një rrymë në tjetrën, dallon gjithashtu edhe në shndërrimet ndjesore. Dashuria shndërrohet në epsh; natyra, në paralelizmin e saj me gjendjen shpirtërore është gati e zymtë, e mjegullt, me vetëtima dhe e errët - dhe ambienti i të gjallëve mbizotërohet prej pranisë së të vdekurve.

Në kritikën shqipe mbi veprën e Mitrush Kutelit, të shumta kanë qenë sprovat për ta pozicionuar linjën e tij letrare në rrymën romantike, apo të tjera, duke e lënë kështu ende të dyzuar. Dekonstruktivizmi na lejon forma të reja interpretative të tekstit sipas hapësirave që formohen pas procesit të rileximit të tij. Dhe për aq kohë sa strukturalizmi na "dha leje" ta çojmë tekstin në kufijtë e interpretimit me argumentin

# MBI ROMANTIZMIN E ERRËT KUTELIAN; A ËSHTË MITRUSH KUTELI GOTIK?

Nga Jola Tasellari



se ai i takon lexuesit, na lejohet kështu të tentojmë të kërkojmë një përthyerje të tipareve të romantizmit të errët në prozën e Kutelit, përmes identifikimit të disa tipareve që kjo rrymë letrare përçon në letërsinë përfaqësuese si: vdekja, magjia, prishja e korrelacionit hapësirë-kohë, ndërthurja e jetës me vdekjen, frika (por pa kaluar në kufijtë e horrorit!). Megjithatë, kjo duke ruajtur të paprekur raportin e shenjtë të shkencës së letërsisë, atë të tekstit me kontekstin.

Ndikimi i kulturës rumune, si vendqëndrimin dhe formimin e autorit prej disa vitesh, është i ndjeshëm në letërsinë e Kutelit, veçanërisht në narrativën e shkurtër. Në kontekst krahasimor, romantizmi rumun nuk dallon aq shumë sa i yni prej romantizmit europian, dhe ndoshta ngjason me të shumë më tepër sesa romantizmi shqiptar. Një karakteristikë e zhvillimit të rrymës së romantizmit në Rumani është lëvrimi i një poetike që në qendër vendos vdekjen dhe jetën, misticitizmin dhe jetën e përtejme. Poetë si M. Eminescu, V. Alecsandri, apo dhe I. Radulescu, eksplorojnë këto tematika në nivele të transhëndencës njerëzore, duke e vendosur vdekjen në pozita të një vazhdueshmërie si të një vdekjeje *perpetual-e* vijimësie<sup>1</sup>. Poezia e Eminesc-ut, Sarmis, trajton po ashtu tematikën e mallkimit të përjetshëm dhe përtej jetës. I mallkuar me një "vdekje të gjallë", i shkëputur nga jeta e vdekja njëkohësisht, mes këtyre të dyjave, me një ekzistencë të pakuptimtë, gati si një purgator, personazhi është i dënuar: "Me sytë e hapur në përjetësi..."<sup>2</sup>

Në këtë kontekst, mund të arrijmë kështu të ngremë paralele të rrëfimit të

<sup>1</sup> Ioana Bot, Babeş Bolyai University, Cluj-Napoca, Romania.

<sup>2</sup> Eminescu, Mihai, The Twins, 1850. U7



vdekjen, paranormalen dhe horrorin, duke ngatërruar botën e të vdekurve me të gjallëve: "Po pse, o Zef, nuk rri në varr si i vdekur që je, po ngrihesh e turbullon punët e të gjallëve?... Zefi qau e gjak i rrodhi nga sytë..."<sup>3</sup>

Tregimi, i shkruar në Bukureshtin e 1938-ës, sundohet nga një frymë mistike, e errët dhe gati gotike. Megjithatë, kjo nuk është e panjohur për ambientin kulturor rumun në të cilin është shkruar tregimi. Studiuesja Maria Ionita, në analizën e saj mbi bashkëjetesën e gotikes me kulturën rumune, arsyeton se ishte pikërisht romantizmi rumun ai që u ngrit duke risjellë figurat e folklorit vendas për t'i vendosur në rrethana të zakonshme, por situata të jashtëzakonshme.<sup>4</sup>

Fundja fundit, legjenda e Drakulës, qenies së dënuar me përjetësi, që bën lidhjen e botës së të vdekurve me të gjallët e ka vendlindjen pikërisht në Rumani.

A mund të flasim për ndikim nga tradita folkloristike rumune në këtë aspekt të zhvillimit të romantizmit të errët tek Kuteli? Me gjasë të madhe, po. Përveçse ka jetuar, edukuar dhe shkruar letërsi në atë ambient kulturor, Kuteli ka sjellë në shqip dhe mjaft zëra të letërsisë rumune të kohës së vet dhe jo vetëm. Një pjesë e madhe e veprës së lirikut rumun, Mihail Eminescu, është sjellë në shqip prej, tanimë, edhe përkthyesit Kuteli. Një ndikim që ky i fundit e shpërfaq në shënimet e tij: "...As shkrimtari i këtyre radhëve nuk shpëtoi syresh gjersa mundi të krijojë personalitetin e vet. Kësaj duhet ta pohojmë se në këto rrëfenja, ndonëse subjekti është nga bota folkloristike shqiptare, frazeologjia na kujton përrallën emineskiane."<sup>5</sup>

Rrëfimet e Kutelit i ofrojnë lexuesit të tij, tanimë modern, një panoramë që shpërfaq dhe përball mendimin dhe veprimin e vjetër popullor, mendësinë kolektive, përrallën, magjinë dhe fantastikën me horrorin, vdekjen dhe tejkohësinë mes kësaj të fundit dhe jetës. Pistë studimore është edhe ajo e ndërthurjes (së pavetëdijshme?) strukturale narrative të *povestitë*<sup>6</sup>, me karakteristika të letërsisë gotike, që gati një shekull më vonë emërtohet si e tille dhe mbizotëron kryesisht romantizmin anglo-amerikan. Romani gotik u dokumentua për herë të parë në periudhën para-romantike<sup>7</sup> me "Kështjellën e Otrantos", roman që sot edhe e pagëzon nisjen e këtij zhanri letrar.

Letërsia e Mitrush Kutelit, konkretisht proza e shkurtër, shfaq tipare të romantizmit me ndikimin e thellë prej folklorit, popullores vendase dhe më gjerë, sentimentalizmit të thellë e të tjera. Për shkak të frymës së huazuar nga letërsia rumune, mbi të gjitha duke mbajtur parasys lidhjen e fortë të folklorit të kësaj të fundit me elementin gotik shumë më parë sesa gotikja të emigronte në Europë prej Amerikës së fundshekullit të XIX-të, nuk mund ta mohojmë as edhe si lexues të thjeshtë ndikimin e njëres tek tjetra.

<sup>3</sup> Kuteli, Mitrush, Vepra II, Lugetërit e fshatit tonë, S.H.B Naim Frashëri, faqe 316.

<sup>4</sup> Ioniță, Maria. "The Fantastic in Romanian Literature". *The Literary Encyclopedia*, 2013.

<sup>5</sup> Kuteli, Mitrush, Shënime Letrare, Tiranë, 1944.

<sup>6</sup> Krijime të shkurtra me strukturë kompozicionale të njëjtë me rrëfenjat kuteliane, njohur gjerësisht në Rumani me këtë emër.

<sup>7</sup> Me termin "periudhë para-romantike" do t'i referohemi dekadës së fundit të 1700-ës.

## I. POEZIA, VLERA, INTERPRETIMI

Me Lasgush Poradecin ka hyrë në letërsinë shqipe koncepti **poet i vështirë**, koncept që është përcjellë që nga lindja e veprës së këtij poeti dhe deri në ditët e sotme. Vepra poetike e Poradecit është konsideruar, para së gjithash, e vështirë për strukturën estetike të ngarkuar si dhe për ambiguitetin e saj. Por vështirësia e perceptimit të veprës ka kaluar nga rrafshi hermeneutik i tekstit poetik në faktorë jashtëletrarë dhe jashtëgjuhësorë.

Në çdo epokë letërsia zhvillon hapësirën informuese. Shfaqja e një veprë të re shihet si një përçapje aksiologjike për horizontin informues të breznive. Dhe raporti *vepër-realitet-lexues-receptor* ndryshon në kohë. Në historinë e letërsisë dhe të kritikës letrare të shekullit XX dhe XXI, shumë vepra klasike u rivlerësuan, u ripanë nga perspektiva e kohëve të sotme dhe u interpretuan nëpërmjet metodave të reja. Rivlerësimi i shkrimeve të klasikizuara mbetet një dukuri e natyrshme në çdo epokë. Në radhë të parë, procesi shënon *vitalitetin* e veprës, si dhe një angazhim të dialogut midis kritikut dhe lexuesit. Letërsia dhe metodat e studimit të saj pasurohen nga zhvillimi i lëmvive të tjera. Progresi i tyre sinkronizohet në mënyrë të natyrshme me progresin e përgjithshëm të mendimit njerëzor, në mënyrë të veçantë, të atyre disiplinave shkencore nga të cilat kritika letrare mund të ndihmohet pjellorisht. Në qoftë se në shekullin e kaluar mbi kritikën ushtronin një forcë tërheqëse shkencat e natyrës, psikologjia dhe filozofia shoqërore, në dhjetëvjeçarët e fundit kritika letrare është e lidhur me sistemet bashkëkohore të mendimit apo me disa disiplina shkencore me aktualitet si **ekzistencializmi, antropologjia kulturore, psikanaliza, gjuhësia strukturale, semiologjia, gramatika gjenerative** etj. Në qoftë se vetë letërsia do të ndihmohej nga prosede hulumtuese për zbulimin e realitetit të jashtëm dhe jetës psikike nga lëmi të tjera, është e natyrshme që dhe kritika letrare të procedojë njësoj. P.sh. psikologjizmi u ndje në kritikën letrare pas zhvillimit të psikanalizës së Freud-it. Nga kritika psikoanalitike tradicionale e Sigmund Freud-it, Carl Gustav Jung-ut, Alfred Adler-it, Karl Abraham-it, Charl Baudouin-it, Jacques Lacan-it, pasojnë studimet e tematizmit psikoanalitik me Jean Paul Weber-in, psikokritika e Charles Mauron-it, kritika tematike me Gaston Bachelard-in, Jean-Pierre Richard-in, Jean Starobinski-in, George Poulet-in etj. Të gjithë këta reformatore do të çelnin shtigje të papara dhe do të ravijëzonin orientimet e reja të kritikës në shekullin e XX dhe XXI. Me autoritetin e tyre dhe me përdorimin e mjeteve specifike, kritika letrare pati një larushmëri dhe u konfiguruan disa disiplina te reja relativisht autonome si **poetika, neokritika, semiologjia letrare, neoretorika** etj. Shndërrimi i vazhdueshëm i kritikës si dhe prirja e saj për larushmëri nuk do të thotë gjithmonë se kemi të bëjmë me një akt progresi. Në këtë proces dialektik, plot me kontradikta, shfaqen momente ngërçi, krize, kur e kur kritika ndjen të nevojshme të verifikojë instrumentet e hetimit, të sinkronizohet me progresin e përgjithshëm të shkencës, qytetërimin dhe të kulturës.

Prej të gjitha këtyre mundësive lindi ajo që quhet *shumësia e tekstit*, që lejon lexime të reja e të pafundme të një teksti. T. Eliot-i do të bënte interpretime të befta mbi veprën e Shakespeare-it, po kështu edhe interpretimet e Roland Barthes-it mbi veprën e Racin-it, apo interpretimet e Michel Foucault-së, i cili bën interpretime sensacionale mbi vepra letrare të traditës europiane, filozofike, letrare si dhe nga lëmia e pikturës etj.



## POETI I VËSHTIRË LASGUSH PORADECI nga Luan Topçiu

Vlerësimi dhe rivlerësimi i një artisti apo një shkrimtari nuk është një proces statik, i dhënë përgjithmonë, por është dinamik. Punimet e Botticelli-it (1445-1510) humbën popullaritetin që në vitet e fundit të jetës së tij, duke u konsideruar si një artist i dorës së dytë pas Leonardo da Vinci-t, Rafael Sanzio-s dhe Michelangelo-s. Krijimtaria e tij, pothuaj e harruar në fillim të shekullit të XVI, u rizbulua shumë më vonë, kur filloi të zhvillohet manierizmi, veçanërisht tek piktorët anglezë të shekullit XIX - *Prerafaelitet* - që do të entuziazmoheshin nga bukuria dhe hijeshia e figurave të tablove të Botticelli-t. Sigurisht, ekzistojnë shumë raste të rivlerësimit, siç janë rastet e Vincent Van Gogh-ut, Amedeo Modigliani-t e shumë të tjerëve, të cilët nuk gëzuan gjatë jetës as njohje, as famë, as mirëqenie. Po kështu janë rastet e mirënjohura të rivlerësimit të Franz Kafka-s, i cili u vlerësua pas vdekjes së tij në moshën 40 vjeçare nga tuberkulozi, të poetes amerikane Emily Dickinson, e cila, si dhe Kafka, dëshironte t'i digjeshin poezitë e saj, të shkrimtarit francez Marcel Proust, i vlerësuar vetëm pas vdekjes së tij në moshën 51 vjeçare apo të filozofit gjerman, Fredrich Nietzsche, vepra dhe personaliteti i të cilëve është vlerësuar post mortem.

Nevoja për vlerësime dhe rivlerësime të veprës së Lasgush Poradecit do të ndihen gjatë gjithë kohës, sepse, para së gjithash, mbetet një vepër që përfshin ende sot e gjithë ditën si lexuesin e thjeshtë, por edhe lëçitësin e specializuar. Së pari, sepse Lasgush Poradeci mbetet një shkrimtar kanonik i rëndësishëm në peizazhin e letërsisë shqipe, autor i përfshirë në tekstet shkollore dhe i dashur për lexuesin e poezisë.

Lasgush Poradeci pësoi fatin e Gjergj Fishtës, Faik Konicës, Ernest Koliqit Martin Camaj, Arshi Pipës etj. që në periudhën komuniste, ose u fol pak, ose u damkosën si tradhtarë dhe u mohuan tërësisht nga historia e letërsisë shqipe. Pas viteve 1990 kjo listë e shkrimtarëve kanonikë u rikthye, jo vetëm për t'u lexuar, por dhe për t'u studiuar, ristudiuar dhe rivlerësuar sipas kritereve estetike. Një proces i kundërt shoqëroi rikthimin e këtyre autorëve të ndaluar apo të minimizuar për arsye politike: shumë nga shkrimtarët e listës kanonike të

komunizmit, të konsideruar shkrimtarët më të rëndësishëm të epokës komuniste, gati janë harruar ose janë në proces harrimi, ndërkohë që lista kanonike është në një proces modifikimi të vazhdueshëm.

Shumë mendimtarë merren me strukturën e veprës si objekt estetik. Disa i mësojnë posaçërisht anës komunikative d.m.th. raportit *objekt-subjekt*, duke theksuar karakterin e hapur të veprës si dhe cilësinë polisemantike të saj, kapacitetin për ta interpretuar plurivok, për të dalluar domethënie të reja e të reja (Umberto Eco). Kësisoj nuk mund të pretendojmë për studime shteruese mbi një tekst letrar, sepse vetë karakteri dhe specifika e veprës, e në mënyrë të veçantë e saj liriko-poetike, e bën pothuaj të pamundur. Herder-i, duke njohur karakterin e pashprehshëm të krijimit letrar, do të shkruante në mënyrë të skajshme, duke mos pranuar asnjë lloj interpretimi, se veprat e artit nuk duhet të lëvizin "vendi i tyre është paracaktuar nga urdhri hyjnor", "ashtu siç çdo lule duhet të lihet në vendin e saj".<sup>1</sup>

Rivlerësimi i një veprë letrare, interpretimi i saj sipas disa mjeteve specifike, që t'i sugjeron vetë vepra në radhë të parë, ndriçon anë të panjohura të saj, hedh dritë mbi dykuptimësitë apo shumëkuptimësitë, deshihron mesazhet që fshihen në tekstin poetik.

Shumë nga tekstet letrare nuk gjejnë shpjegim vetëm brenda letërsive kombëtare dhe shumë studiues të letërsive kombëtare bëhen në mënyrë të pashmangshme studiues të letërsisë së krahasuar. As izolimi gjuhësor dhe as izolimi gjeografik nuk janë të mjaftueshme për të shpjeguar një autor apo një dukuri letrare. Veçanërisht kur është fjala për poetin Lasgush Poradeci, formimi i të cilit ndodhi në gjuhë dhe kultura të tjera.

### Poezia lasgushiane dhe interpretimi

Vepra poetike e Lasgush Poradecit është interpretuar më së shumti me mjete të jashtme, të huaja për letërsinë, duke shkarë shpesh dhe duke u davaritur në

zonën e mitologjisë, të cilat, në shumicën e rasteve, nuk kanë mundur të depërtojnë në strukturën poetike të veprës, duke mbërritur kështu në rezultate sipërfaqësore.

Çfarë e bën këtë vepër të vështirë? Lasgush Poradeci lindi më 1899 (10 vjet më vonë nga data në të cilin vdiq poeti i tij i zemrës, Mihai Eminescu, dhe pas një viti do të vdiste poeti ynë kombëtar, Naim Frashëri) dhe ndërroi jetë më 1987, me një krijimtari jo aq voluminoze për rreth 90-vjet jetë, por të përqendruar, ku është realizuar vetëshprehja e plotë e një poeti. Poezia e Lasgush Poradecit shënon një dukuri të ndërlikuar, në kuptimin më të thellë të kësaj fjale. Është shorti i veprave të thella të mos priten mirë nga bashkëkohësit, historia e artit dhe e kulturës është e mbushur me qindra raste të tillë. Në vitet '20-'30-të, pak njerëz ishin në gjendje të receptonin këtë lloj poezie, ajo u shfaq më tepër si një lloj provokimi, në të trajtoheshin probleme ontologjike, filozofike si koha dhe kuptimi i saj, përjetësia, vdekja, dashuria, ngadhënjimi, flijimi, natyra - të vështuara në një mënyrë të papritur, me një simbolikë dhe një sistem figurativ të pandeshur më parë nga bashkëkohësit, (shumica e shoqërisë shqiptare ishte analfabete) por poezia lasgushiane ruan dhe në ditët tona një befasi të fshehtë dhe një mesazh të pashtershëm. Por, nga ana tjetër, poezia e poetit pogradecar do të entuziazmonte elitat e vendit në periudhën midis dy Luftërave Botërore. Prania e magjisë, erotikës, universalizmit, modernitetit dhe njëherazi frymës autoktone, do të bëjnë që poezia e Lasgush Poradecit të kaplojë gjithë shekullin e XX dhe dy dekada të shekullit të XXI dhe të bëhet shumë e vështirë për t'u etiketuar. Në mënyrë të qashtë do të shprehej prof. Eqrem Çabej: "*Ç'e ndryshon nga të parët është thellësia... është vjershëtoria më e thellë që ka shkruar në shqipet, në qoftë se kjo nuk është vënë re deri tani, shkak është se më të shumtë nuk e kuptojnë poezinë e tij, e cila me fjalë dhe me mënyra fare të thjeshta, e shumë herë populllore, arrin të koncentrohet aq sa mund të nxjerrë në dritë mendimet më të thella, ndjenjat më labirintike, idetë më të larta.*"<sup>2</sup>

Vështirësitë e dekodifikimit të veprës nuk shpjegohen vetëm me karakterin e ndërlikuar të veprës poetike të Lasgush Poradecit, por dhe prej faktit se ndodhemi në një terren praktik të papërkthyeshmëri deri në fund dhe të pashpjegueshmëri deri në një ekuacion përfundimtar. Kuptimi i poezisë dhe i artit në përgjithësi është gjithmonë *virtual* dhe duhet rindërtuar. Ky proces shton ose mënjanon diçka. Ashtu siç saktëson Claude Levi-Strauss, "kuptimi i përjetuar ndryshon nga kuptimi ekzistues në objekt, sepse gjithmonë i shtohet koeficienti vetjak, subjektiv i atij që e vlerëson."<sup>3</sup>

Përpos atyre që u shtruan më lart, poezia e Lasgush Poradecit është një poezi eminentisht moderne, e cila u zhvillua mbi një traditë dhe në një terren klasik dhe folklorik, ku më së shumti sundonte poezia orale - kështu ajo tingëllon dhe më e beftë dhe më e paparashikueshme për horizontin e pritjes.

Koncepti **poet i vështirë** u krijua dhe u përforcua dhe nga rrethana jashtëletrare dhe jashtëestetike. Mendimi kritik shqiptar, veçanërisht ai zyrtar postbelik, ka mbajtur një qëndrim spekulativ ndaj veprës dhe ndaj vetë poetit, shpesh të skajshëm, agresiv, të papërgjegjshëm e tendencioz. Një nga arsytet që ka penguar gjykimin e vlerave poetike dhe që ka ndërlikuar figurën e poetit është **biografia** e tij dhe mitologjia e krijuar për të, (ende nuk ka një monografi shkencore për jetën e tij, të hartuar nga një studiues objektiv, të bazuar mbi dokumente

<sup>1</sup> Johann Gottfried von Herder, *Ideen zur Philosophie der Geschichte der Menschheit* (Opere 4, libri i IV-t, Berlin, 1964)

<sup>2</sup> Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1975, f.87.

<sup>3</sup> Claude Levi-Strauss, *Gândirea sălbatică*, Ed. Științifică, Bukuresht, 1970. Fq. 35

dhe fakte). Studimet e stërzgatura në disa gjuhë dhe në disa universitete të Europës, në disiplina të ndryshme, njohuritë e tij mbi filozofinë, fenën, pikurën, muzikën, njohja e disa gjuhëve të huaja, njohja e mitologjisë greke, induse, romake, njohja e letërsisë bashkëkohore europiane (posaçërisht kontaktet me Athinën, Bukureshtin, Grazin), të gjitha këto të dhëna biografike janë amplifikuar për të ndërtuar një mit të vërtetë. Mënjësisht e politikës zyrtare në kohën e komunizimit ndaj poetit, nuk bëri gjë tjetër veçse amplifikoi mitin për të, për jetën personale, për stilin e jetës etj. Miti rreth tij do të bënte të shkruheshin libra me ato që kishte thënë poeti në biseda me bashkëkohësit, duke prodhuar libra tejet të dobishëm, por dhe libra spekulativë, pa dëshmuar asgjë të rëndësishme për jetën apo formimin e tij, të cilat janë shndërruar në gati libra argëtues dhe anekdotikë, duke u bazuar vetëm në mitologji urbane. Autenticiteti i tyre vihen në dyshim.

Vlerësimi i veprës së Lasgushit ka prekur të dyja skajet: ka lëkundje nga panagjerizmi dhe mbivlerësimi, gati mitologjik, deri tek mohimi, mënjësimi, harrim i qëllimshëm. Të kujtojmë atë debat në faqet e revistës "Përpyekja shqiptare" midis Krist Malokit<sup>4</sup> dhe Mitrush Kutelit<sup>5</sup> në vitin 1938, në të cilën i pari vinte në dyshim të qenit poet të Lasgushit, kurse tjetri e konsideronte poetin më të madh të gjuhës shqipe. Pas viteve 1990, veçanërisht pas esesë të shkrimtarit më të madh shqiptar, Ismail Kadare<sup>6</sup> për poetin Lasgush Poradeci, u ofrua dhe mundësia, që bashkë me përkthimin në shumë gjuhë të sprovës së Kadaresë, të njihet ndërkombëtarisht dhe emri i poetit Lasgush Poradeci.

Një tjetër aspekt, që e bën të vështirë veprën e poetit apo lëçitjen e saj, është vendi që zë poeti në historinë e letërsisë shqipe. Ai zë vend bash në udhëkryqin e modernizimit dhe europianizimit të letërsisë shqipe në përgjithësi, bashkë me Asdrenin, ndaj ai nuk është vetëm një poet, por poezia e tij është një hallkë lidhëse e domosdoshme në letrat shqipe.

Poezia e Lasgush Poradecit, për nga shtresat kuptimore filozofike, për nga i mesazhit lirik, harmonia e brendshme muzikore e vargjeve, qashtërsia e tyre, aftësia për të plasticizuar vizione koherente të botës, talenti për të ndërtuar tablo jo vetëm me sintaksën gjuhësore të zhdërvjellët, por dhe me sintaksën e imazheve, mund të homologohet me bashkëkohësit europianë (ku ndeshen këto elementë) që konsiderohen si forca novatore të dorës së parë.

Interpretimet e kësaj vepre janë kufizuar në një nga tre pjesët e përkatësisë së saj: 1. *Poet europian* 2. *Poet i traditës*. 3. *Poet popullor*. Po kështu, jo rrallë herë kritikët nuk janë nisur nga kritere të brendshme të veprës, por nga kritere të jashtme, duke kërkuar prej saj në mënyrë të sforcuar një tjetër përmbajtje, një tjetër ideologji, një tjetër tematikë, duke shtrembëruar individualitetin poetik dhe duke rrëguar vlerat e poezisë, duke reduktuar karakterin universal të veprës në një poet të natyrës apo të peizazhit, duke thjeshtësuar polivalencën dhe plotësinë e veprës. Por, përveç qëndrimeve denigruese, me apo pa vetëdije, poeti ka fituar vëmendjen dhe vlerësimin e personaliteteve të rëndësishëm të letrave shqipe, që nga Eqrem Çabej, Skënder Luarasi, Mitrush Kuteli, Ismail Kadare, Rexhep Qosja, Sabri Hamiti, Rexhep Ismaili etj., dhe gjithëherë vëmendjen dhe dashurinë e lexuesit shqiptar. Leximi i veprës së Lasgushit, pavarësisht nga opinionet dhe vlerësimet e kritikës, ka qenë

<sup>4</sup> Maloki, Krist, Kritikë letrare: *A asht poet Lasgush Poradeci?*, tek: Përpyekja shqiptare. -Nr. 13-24, II/ 1938, f. 333-350. 85.

<sup>5</sup> Kuteli, Mitrush *Poetika e Lasgush Poradecit*, tek: Përpyekja shqiptare. -Nr. 17, 1938, f. 243.

<sup>6</sup> Kadare, Ismail, *Ftesë në studio*, (Portret i Lasgush Poradecit) Onufri 2005, Tiranë

gënjehkohshëm, sepse kjo poezi i referohet thelbit njerëzor, botës së fshehtë të njeriut, intimitetit, ëndrrës, dashurisë, ndërgjegjes dhe nëndërgjegjes, misterit, pranisë së Zotit, natyrës - bukurisë së përjetshme të natyrës.

Por çdo epokë e lexon letërsinë në mënyrë e vet. Me fenomenin e interpretimit të tekstit do të merret veçanërisht *hermeneutika*, posaçërisht ajo moderne, që lindi si kohë njëherazi me romantizmin gjerman, e përcaktuar qartë nga Wilhelm Dilthey. Në perspektivën hermeneutike, të lexosh është një art i cili varet nga përvoja dhe kultura individuale; formimi i metodave teorike të përgjithshme, sipas saj, është i pamundur. Në bazën e teorisë moderne të lëçitjes qëndron ideja se dukuria letrare nuk është vetëm teksti, por dhe lexuesi i tij si dhe ansambli i reagimeve të mundshme të tij ndaj tekstit. *Lexuesi*, i neglizhuar gjithë kohën, vjen kështu të ndodhet në paraskenë, pra qendra e rëndësës së dukurisë letrare zhvendoset nga hapësira midis krijuesit dhe veprës në atë midis lexuesit dhe veprës. Zgjidhjet për ta vënë në vlera të plota këtë marrëdhënie kanë qenë të shumta. Teksti bëhet ekuivalenti i një partiture e cila merr jetë vetëm nga ekzekutimi. Leximi bëhet një ndërtim, një prodhim i tekstit, një pritje aktive dhe krijuese.

Teksti poetik lasgushian mbetet i afërt dhe i pashtetur me kumte, mesazhe, nxjerrja në pah e të cilave i provokon dhe i zgjon lexuesit të të gjitha kohërave ide, bashkëshoqërime idesh dhe imazhesh, kënaqësi estetike. Leximi me interes dhe sot, prirjet në rritje për zbrëthimin e këtij kodi poetik, interesi i përgjithshëm për këto poezi, janë dëshmi të vlerës poetike,

të modernitetit të saj, të thellësisë e kompleksitetit. Vepra ka fituar si leximin që quhet "naiv" ose për zbatimje, leximin e kultivuar, atë estetik apo produktiv, që do të thotë analizë dhe interpretim, po kështu vepra mbetet e hapur për lëçitje, interpretime të tjera. Roland Barthes do të afirmojë: "Vepra është për ne pa kufij dhe mundet madje kjo gjë e përkufizon më mirë, vepra nuk është e rrethuar, e quajtur, e mbrojtur, e drejtuar nga asnjë situatë; asnjë lloj jete praktike nuk është këtu për të na thënë kuptimin që duhet t'i japim; ajo ka gjithmonë diçka që lidhet me leximin, në të ambiguiteti është i pastër."<sup>7</sup>

Poezia e Lasgush Poradecit është konsideruar e vështirë dhe jo komode për kritikët, historianët e letërsisë shqipe, për estetët dogmatikë, veçanërisht ata stalinistë në periudhën komuniste. Sipas tyre kjo poezi ishte moderniste, mistikofetare, idealiste, hermetike, formaliste, dekadente, ku mungonte elementi social-klasor etj. Për arsye politike dhe ideologjike, poezia mbeti e pastudiuar, e mënjatur dhe e keqinterpretuar, e veshur me mister dhe me rrezik, në ribotimet e kësaj poezie u hoqën një numër i madh poezish, strofash, vargjeve, redaktorët ndërhyjnë deri aty sa ta kthenin gjuhën në *normën letrare*, sipas rregullave të drejtshkrimt, duke masakruar kështu përmbajtjen, formën, muzikalitetin, magjinë, sugjestivitetin, unitetin e veprës, karakterin sistematik të saj etj. Kështu poezia iu nënshtua një procesi të gjatë dhunimi, shpërfilljeje, përçmimi. Poeti Lasgush Poradeci, në historinë e letërsisë, i takonte viteve '30, e kur studiohej në

<sup>7</sup> R. Barthes, *Critique et vérité*, Paris, Du Seuil, 1966, f.54.

programet shkollore, studiohej në grup dhe me *vlera të dyshimta*. Heshtja dhe mënjanimi dhe tëhuajzimi u zgjodhën si mjete për ta asgjësuar dhe minimizuar vlerat dhe rëndësinë e tij si poet. Hapësira shpirtërore shqiptare që do ta vlerësonte poetin do të mbetej Kosova.

Por poeti e kishte bërë veprën e tij, ajo i kishte thënë çfarë kishte për të thënë, ajo ishte kurora e jetës, ishte qetësia e brendshme e poetit-funksioni i tij ishte kryer-funksion i ngjashëm me atë të *nositit*.

Vendi që zë poeti në letërsinë shqipe është një pozicion dhe një rol, por më tepër është një mision në emancipimin dhe modernizimin e letërsisë shqipe. Poradeci është një poet dhe një dukuri letrare, një mit dhe një short. Lindi vetëm një vit para vdekjes së Naim Frashërit, në të njëjtin vit kur ndërroi jetë Eminescu, një *alter ego* i tij. Ashtu si dhe Eminescu<sup>8</sup>, Lasgushi do të botonte një vëllim të vetëm poetik dhe rreth 15-17 poezi të çmuara dhe të vlerësuara që e bëjnë poet të rëndësishëm në kuadër të letërsisë kombëtare. Është një përkim që të bën të mendosh për misterin e rastësive, migrimin e shpirtit, duke pasur parasysh marrëdhëniet e posaçme të poetit shqiptar me veprën e poetit të madh rumun, vepër e cila i shërbeu si model kulturor, estetik dhe modelues. Jetoj gjatë shekullit të XX, deri më 1987, duke mbizotëruar me artin e tij gjithë këtë shekull, duke ndarë shekullin XIX, të shënjuar nga letërsia romantike naimjane, nga shekulli XX, shekulli i letërsisë postromantike e moderne që mund ta quajmë lasgushjane.

Kjo vepër poetike ndihmoi në mënyrë absolute në rolin e rëndësishëm që luan forma në poezi, për herë të parë do të shfaqej në letrat shqipe një poet kaq kompleks dhe kaq i stërhollë dhe i përhimët në pikëpamje të formës, në përdorimin me virtuoizitet të formave të shprehjes, të përpunimit të vargjeve, të gjuhës, të përdorimit të shenjave poetike në përgjithësi. Poeti do të përdorë një larushi formash si: *romancën, këngën, baladën, rapsodinë, portretin, rondelin, trioletin, pastelin, variantën* etj.

Ai i dha një rëndësi jo të zakonshme fletës poetike, anës grafike e vizuale të saj, këto ishin gjakimet e poetit për të realizuar një vepër të epërme me cilësi të pavdekshme. Që nga lëçitja e virgjër e tekstit, deri tek ajo e përsëritura dhe deri tek ajo gjithëpërfshirëse, vepra poetike e Lasgush Poradecit mbetet kështusoj për këdo dhe kurdo një befasi e përhershme. Gjuhë dhe kuptim, informacion dhe gazmim estetik, kjo vepër poetike shfaqet si një heterogjenitet që favorizon lëçitje të shumëfishta me synime vlerësimi.

Pavarësisht nga "pista" e interpretimit të veprës lasgushiane, pavarësisht nga metoda, këndvështrimi, afiniteti apo jo ndaj poezisë së tij, koha kur ka ndodhur interpretimi, konstatohet lehtësisht fakti se poeti në gjithë krijimtarinë e tij ka qenë i prirur nga synimi i tërësisë, i lidhjes së pjesëve në një bashkësi unike. Pavarësisht nga përçapjet për ta inkuadruar në njërin ose tjetrin drejtim letrar nga historianët e letërsisë, nga studiues të ndryshëm, për ta klasifikuar sipas kriteresh të ndryshme, shkolla, rryma, drejtime letrare, poeti mundi të rezistojë si autor i përgjithësimeve të dukurive lirike.

Në këtë univers nënshtresohen dhe panteizmi dhe tokësorja, kozmogonikja dhe hedonistikja, parnasjania dhe folklorikja, romantikja dhe simbolikja, e thjeshta dhe kompleksja, formalja dhe hermetikja, efemerja dhe e përjetshme - të infiltuara në këtë botë me përkatësi autentike. Për të gjitha këto hulumtimi i kësaj vepre mbetet një ndërmarrje e vështirë.

<sup>8</sup> Mihai Eminescu botoi një vëllim të vetëm gjatë jetës të titulluar *Poezi*, i përbërë nga poezi të botuara gjatë gjithë jetës së tij në revistën *Convorbiri literare* të shoqërisë Junimea, pjesë e së cilës ishte dhe Eminescu.

## Luan Topçiu

# POETI I VËSHTIRË LASGUSH PORADECI

Tekstualizëm dhe stil



Onufri



nen i Kanunit të mbledhur pikërisht në Mirditë, shumë vjet pas vërejtjes së hollë të Dom Kocit, e ligjëson ngarkesën. "Gruaja asht shakull me bajtë...". Në një foto të hershme të Marubit, çift mirditas, shohim burrë e grua ulur bri shoqi-shoqit, me veshjen e krahinës, burri pushkën në gjunjë, gruaja koshin në shpinë. Një foto e ngjashme mund të ishte shkrepur edhe në Malsi të Vogël. Por një foto si ajo nuk mund të shkrepur kurrë në Malsi të Madhe, në Gash, në Krasniqe e Bytyç, në Has e në Rrafsh të Dukagjinit. Sepse atje ishte realitet krejt tjetër, për shkak të një terreni tjetër. Atje gruaja nuk ngarkohej.

Koci ftillon: ky nen është specifik për paisazhe egërsisht malore, me terren të shkallmuar, të mrrolët, të rrezikshëm.

Ky nen pra nuk është parim i Kanunit. Nuk është filozofi e tij.

Nëse Gjeçovi do ta kishte mbledhur Kanunin në Malsi të Madhe, në Malsi të Gjakovës (pa përfshirë Nikaj-Mërturin), në Has e në hapësira të gjera të Rrafshit të Dukagjinit, ky nen nuk do të ishte shkruar kurrë në të drejtën dokesore. As nene të përafërta. Nuk do të ishte shkruar, sepse atje nuk ekzistonte.

Një përjasje. Në Kanun ka edhe ndonjë nen tjetër specifik për Mirditën, vetëm për të. Shkruhet, për shembull, se dera Gjomarkut asht *themeli i Kanusë*. Mos do të thotë kjo se Gjonmarkajt pyeteshin në Krasniqe e në Gash, në Malsi të Madhe, në Malsi të Vogël e në Rrafsh të Dukagjinit, hapësira të mirëfillta nën autoritetin e Ligjit të Lekës? Jo. Në këto vise Gjonmarkajt nuk njiheshin si themel as si kullm. Nuk ndiente kush për ta, mbase as emrin s'ua kishin dëgjuar. Gjonmarkajt përmenden vetëm sepse kodi është mbledhur në Mirditë, ku ata ishin derë e parë. Po të ishte mbledhur në një krahinë tjetër, nuk do të ishte zënë në gojë.

E njëjta logjikë vlen edhe për ngarkesën e gruas.

E dëshmojnë edhe kanune të tjera, të cilat nga pikëpamja e parimeve të përgjithshme dhe e filozofisë që i përshkon, janë aty e aty me Ligjin e Lekës.

Kanuni i Skanderbegut nuk e ligjëson ngarkesën e gruas. Kanuni i Lumës jo. As Kanuni i Dibrës. Nuk gjindet ky trajtim i gruas në përmbledhje a shkurtesa të Kanunit të Lekë Dukagjinit, botuar më përpara nga autorë të besueshëm, si Pashko Vasa. As në do përmbledhje amatorësh, botuar pas viteve nëntëdhjetë. Versioni i Kanunit sipas Mark Sadikut, të parit të djelmnisë së Shalës, punuar prej Atë Bernardin Palajt, është version mjaft i shkurtuar. Por as aty nuk ekziston një nen i tillë.

Nenin "Gruaja asht shakull me bajtë..." Enver Hoxha e shkëputi nga konteksti me synime të liga. E keqpërdori në shërbim të politikës përçarëse. E përgjithësoi, duke mëtuar se pasqyrore filozofinë e Kanunit. Ashtu siç shtrembëroi në mënyrë dramatike krejt thelbin e ligjit të maleve. E paraqiti të përmbytur, kryeposhtë. Për ta helmuar. Për ta gropuar thellë në dhë pa një pllakë te kryet.

### 3. Nga sojnikë, fisnike deri te Bukuroshja e Vjetit

Jeta qe mujshare gjithandej, por gruaja nën qiellin e Kanunit edhe nderohej fort. "Gruaja në Shqipëri gëzon një respekt dhe një nderim që s'e gjen lehtë në vendet e tjerë, shkruan Mit'hat Frashëri në veprën *Plagët tona*. Liria e saj është e plotë në viset e vendit tonë, ku s'ka hyrë pseudo-qytetërimi i Azisë (domethënë në malsitë e panështruara nga pushtuesit turq - m.e.).<sup>12</sup> M. Frashëri flet për "liri të plotë" të gruas në ato vise.

Një burrë në male i drejtohej një gruaje me fjalët *sojnikë, fisnike*, të krahasueshme me *zonjë*. Gjuha shqipe është ndër të rrallat në botë, mbase e vetmja, që për gruan përdor fjalën shoq/shok. Thuhet: e shoqja, i shoqi. Atë Zef Pllumi, te libri "Rro vetëm për me tregue":

- Ndigjo, më tha kolegu, nuk ke si kthen në Shosh: nesër mbrama këtu do gjindemi para njaj ngjarje së madhe: asht vdekja e parë mbas shpalljes së "sundit". Të shofim çdo të bāhet. Mrikë Kacelja, që diq, ishte bijë e Prekalit e ndoshta prekalorët nuk do t'i shtrohen "sundit".

Njaty kah ora pesë e mbasdites malet shungulluen në largsi nga një gjamë burrash: "I mjeri u për ty, o vllaa!" Tri herësh u përsërit gjama e gjithkush tha me vëdi: po vjen Prekali e paskan hi në Kir. Mbas nja një gjysmë ore, malet jehuen gjamën tjetër, shumë më të fortë e të rrebtë. Tri herësh përsëri ushtoi "I mjeri u për ty, o vllaa!" Mandej ra një heshtje e thellë, që priste dishka. Mendojshem me vëdi: Kanuni ynë i maleve asht me të vërtetë i çuditshëm. Në pamjen e parë duket një ligjë e egër, barbare njëlloj si kodi i Hamurabit, e para ligjë e shkrueme që njeft njerëzimi. Por, po u thellove në të, gjen aty një botëkuptim aq njerëzor, sa

<sup>12</sup> Mendimtarë shqiptarë, Plagët tona, Dija, Prishtinë, 2000.

*nuk besohet: sot këta e thrrasin "vlla" motrën e vet të dekun. Kjo gjuha e jonë, në lashtësinë e saj, gruen e thirrte "e shoqja e filanit" e jo "grueja e filanit". Pra, koncepti i barazisë në Kanunin primitiv të Maleve tona ishte më i saktë se ky i ligjëve moderne. Fjalët e gjamës në Dukagjin ishin vetem dy: "vlla" ose "mik" e nuk pranonte tjera.*

Në Malsi të Madhe dhe në disa treva në Malsi të Gjakovës (Tropojë) e në Rrafsh të Dukagjinit, miku që vinte në shtëpi i linte zonjës së shtëpisë të *fala*, dhuratë simbolike në të holla, diçka e përafërt me një tufë lule sot. Kjo doke erdhi duke u venitur, bashkë me hollimin e gjendjes ekonomike. Dhuratat vetjake që i bëheshin gruas, nga njerëzit e gjinisë ose të tjerë, mbeteshin pronë e saj, nuk ia prekte askush. Qofshin gjë e gjallë, pare a sende me vlerë.

Të gjitha dëshmitë e udhëtarëve, diplomatë e hulumtues me emër, dashamirë ose jo, përputhen në këtë pikë. Edit Durhami pohon se "burra i trajtojnë (gratë) me një farë fisnikërie të ashpër dhe i respektojnë". Gratë në malsi "kanë më shumë liri se ndër malazeztë, sepse lejohen të shprehin mendimin e tyre për çështje të rëndësishme, shpesh ua kërkojnë mendimin dhe marrin pjesë në kuvendin e përgjithshëm". Ndërsa "në Mal të Zi i zoti i shtëpisë bërtet: "Pusho grua!", madje edhe kur ajo kërkon të bëjë një pyetje pa të keq". Jo vetëm kaq. Siç vëren Nopça, "në Mal të Zi mund t'i presin hundën gruas, kur shkel kurorën, kurse në Shqipëri kjo nuk ndodh" kurrë. Gruaja shqiptare "mund të bëjë shaka e të qeshë me burrat, në Shkodër mund të qëndrojnë në rrugë e t'i thërrasë të shoqit që të dalë nga pijetorja e t'i thotë mjaft ke pirë".

Gratë myslimane njësoj. "Gratë e fiseve myslimane në malet e Shqipërisë nuk mbulohe kurrë dhe shkojnë në treg e bëjnë pazar lirshëm me burrat". Dom Ernesto Koci, në veprën e cituar: "Kur filtet për gjendjen e gruas myslimane të Maleve të Shqipërisë... ajo asht e barabartë me atë të gruas malsore të krishtenë". Edhe në fshatrat e thella myslimane, vëren Margaret Hazllaku (Hasluck), gruaja "gëzonte po atë liri të stërgjyshëve të tyre të krishterë".<sup>13</sup> Përsëri Koci, i cituar nga Zhystë Godar (Justin Godart): "Në fiset myslimane, si në fiset katolike, gruaja shihet si qenie e shenjtë; ajo mund të udhëtojë në të gjithë vendin, ditën dhe natën, pa patur frikë as nga ndonjë fyerje, as nga ndonjë rrezik; në luftërat vdekjeprurëse ndërmyjet fiseve ajo është e sigurt, duke qenë gjithmonë e falur

<sup>13</sup> Margaret Hazllak (Hasluck), Kanuni (ligji i pashkuar shqiptar), Lisitan, Tiranë 2005).

nga pushka armike. Fajtori i rrezikuar nga hakmarrja, kur ndodhet pranë një gruaje nuk mund të vritet kurrë. Për të qenë i ruajtur, një thesar i besohet një gruaje; kushdo qoftë ajo, ky thesar është i sigurt".<sup>14</sup> Në të njëjtën vijë Pukëvili: "Të krishtera e muhamedane, asnjë nuk mban perçen e sajuar nga idhtia (xhelozia) orientale".<sup>15</sup> Te *skipëtarët* e Drinit gratë ngjeshin armë dhe ecin "me vështrim krenar". Dora d'Istria ngulmon se myslimanët shqiptarë "s'kishin asgjë të përbashkët me osmanët, as me fanatikët e Portës, as me islamin e tyre, por, në të kundërt, ishin thellësisht të kushtëzuar... nga karakteri i tyre european". Edhe me gratë mbeteshin të tillë. Ata "përqmonin aziatikët dhe nuk i poshtëronin gratë e tyre, siç bënin në vendet e tjera myslimane".<sup>16</sup> Obrej (Aubrey) Herberti ka të njëjtin mendim për shqiptarët myslimanë. "Janë europianë tepër inteligjentë, megjithëse ndjekës të Profetit të shkretëtirës". Madje "në Shqipëri ka një fakt të veçantë domethënës: populli është lodhur së qeni e së trajtuar si oriental, është i etshëm për të zënë në Ballkan vendin që ky popull e di se i takon".<sup>17</sup>

"Pashë edhe shumë gra me kobure në brez, që po vinin prej pazarit të Lezhës", plotëson Hahni, ndërsa ka kaluar Matin. Për Karl Ottenin (Otten), ajo që bie në sy në kostumin e grave malsore "është brezi i gjerë prej fletësh hekuri, që arrin deri në gjoks dhe ku janë kapur në unaza të vogla kama dhe kutia e duhanit".<sup>18</sup> Gruaja malsore "udhëton natën e ditën e kudo, pa frigë se pson çfardo fyemjeje", dëshmon Dom Ernesto Koci. Hekardi vëren rreptësinë vrastare me të cilën këqyre morali i femrës në Mirditë, por shton: "Gratë dhe vajzat mirditore janë mjaft të lira; ato udhëtojnë gjithkund vetëm dhe respektohen ngado. Aty, si në të gjitha malet e Shqipërisë së Epërme, shoqëruesja më e mirë dhe më e sigurt është një grua".<sup>19</sup> Ai shton se "në asnjë vend tjetër gratë nuk gëzojnë një respekt të

<sup>14</sup> Zhystë Godar (Justin Godart) në librin Shqipëria në 1921, Klubi i Poezisë, Tiranë, 2015.

<sup>15</sup> Pukëvil (Pouqueville), Tiparet fizike të shqiptarëve. Citohet sipas përmbledhjes Pena të arta franceze për shqiptarët, përgatitur dhe botuar nga F. Andrea, Tiranë, 2007.

<sup>16</sup> Në këto shënime Dora d'Istria citohet sipas Natali Klejerit, Në fillimet..., vepër e përmendur. Edhe vetë Klejeri shkruan se qysh në qindvjetëshin e 19-të myslimanët shqiptarë këmbëngulnin për "një identitet evropian, një identitet mysliman evropian, i ndryshëm nga ai i myslimanëve turq...".

<sup>17</sup> Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme. Ditari dhe Letra 1904-1923, me parathënie të Noel Malkolmit, Via Egnatia, Tiranë 2012.

<sup>18</sup> Karl Otten, Udhëtim në Shqipëri 1912, Dituria, 2005.

<sup>19</sup> Hyacinthe Hequard, Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë, Plejad, 2008. Edhe citimet e tjera të këtij autori janë prej kësaj vepre.

tillë dhe nuk kanë një ndikim kaq të fuqishëm", sa në malet shqiptare. Edhe pse "të nënshtruara ndaj burrave të vet", burrat "ua marrin me kënaqësi mendimin për problemet e tyre dhe ato të vendit". Dom Koci po ashtu: malsori "nuk e përbuz kurrë këshillën e gruas së vet në punët familjare... Mashkujt parapëlqejnë ma shumë të shkojnë vetë zbatë e të veshun keq se sa gratë e tyne". Mosvlerësimi ndaj seksit të dobët është "i rrejshëm", thotë. Ky mosvlerësim "përfundon gjithmonë në lojë e shprehun prej korit të Satirëve te Euripidi:

*Oh, kurrë në botë - veçse për mue -  
Mos t'kishin dalë fëmnat!*

Në Kelmend gruaja ulej me burrat, me gotën e rakisë përpara. Rozë Uailder Leini vëren se "në këto male... nderimi i gruas nuk mësohet si mirësjellje oborrtare, por është aq i natyrshëm sa dhe frymëmarrja, aq i natyrshëm sa kurrë nuk zihet në gojë a në mendje...".<sup>20</sup> Ajo tregon se bajraktari i Shoshit e uli nusen e djalit në sofrën kryesore, ku ishin miqtë më të rëndësishëm.

Disa sjellje të hershme ndaj gruas zbulojnë e shprehin ndjenja veçanërisht të holla, pasqyrojnë plot hijeshi thelb qytetërimi të hershëm. Midis maleve të Veriut shqiptar para Luftës së Dytë Botërore ka qenë institucionalizuar konkursi i bukurisë femërore. Një lloj *Miss Malsia*, në u shprehshim me gjuhë e spektakle televizive të sotme. *Gara quhej Bukuroshja e vjetit*, zhvillohej ditën e Shën-Kollit (6 dhjetor) në oborr të kishës.<sup>21</sup> Nusët hijeshoheshin me xhubletën e përdallgur ilire, të endur e të qëndisur mjeshhtërisht me dorë. Shfaqja ndiqe me thekuni (emocion): cila do të jetë zana shituese e bjeshkëve këtë mot? Atë Kolë Berishaj ka regjistruar edhe në celulozë pamje të festës së rrallë.

Konkursi i bukuriosheve, i cili më pas do të quhej *Miss* sipas gjedhes amerikane, në kontinent është bërë vonë pjesë e projekteve artistike kombëtare. Në një vend të kulturës e të artit si Italia, për herë të parë është organizuar më 1939. Ka qenë quajtur *Miss Sorriso* (Miss Buzëqeshja). Afërsisht në të njëjtën kohë organizohej në Shqipëri. Jo në skena vezulluese, por në sheshe rrethuar me kulla të përhimëta guri, me pisha dhjetori ngarkuar me borë, me male të mrrolta shungulluese. Çiltërsisht. Pa bërryla çmimesh të përthyerë në përfitime gjithfarësoj.

Bash në zonat ku mbretëronte Kanuni, fereksesë i qe mshelë dera: jashtë! Qe pikërisht Kanuni, që i erdhi në ndihmë Mbretit Zog, kur ky nxori dekretin që ndalonte mbulimin e femrës.

Edhe një vështrim nga tjetër kënd, jo fort i zakonitë.

Në popujt europianë ka qenë i përhapur besimi se ka gra shtriga. Në mesjetë ato digjeshin të gjalla; edhe në ditët tona njoftohet për rehabilitime të herëpashershme që u bën kisha këtyre viktimave. Në veprën *Aspekte mitologjike, besime e besëtytni* (Prishtinë, 1997), M. Krasniqi sjell të dhënat e etnografëve serbë Vuk Karaxhiq dhe Tihomir Gjorgjeviç edhe për mënyrën si luftoheshin shtrigat në Serbi. E re nuk është mizoria ndaj tyre, që ndeshet edhe te popuj të tjerë. E re është koha kur ka vijuar. Gjuetia e tmerrshme e grave të dyshuara si shtriga ka zgjatur deri në qindvjetëshin e 19-të. Me urdhër të Karagjorgjit, udhëheqës i kryengritjes së parë serbe më 1804, ato i digjnin në zjarr njësoj si në mesjetën e kontinentit.<sup>22</sup>

Në bestytni shqiptarët s'kanë bërë përjashtim. Edhe ata kanë besuar se disa gra janë shtriga, se ato "hanë" fëmijë. Përjashtimin e kanë bërë në qëndrimin ndaj tyre: kurrë s'i kanë ndjekur e masakruar "shtrigat" e hamendësuar. Hahni, Nopça, Hekardi, Atë Zef Valentini, dijetarë e udhëtarë vendas e të huaj, që kanë hulumtuar në brendësi botën shqiptare, doket e mendësitë, s'kanë njoftuar as edhe për një rast të vetëm të përndjekjes e torturimit të "shtrigave". I vetmi hap, gjithnjë si masë mbrojtëse, ka qenë rrekja me e zhba e me e bjerrë fuqinë e tyre të errët, nëpërmjet disa riteve ose tëbameve, magjive, të quajtura të mira (pozitive).

(nga libri "Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit", botim i dytë, i plotësuar)

# Mehmet ELEZI

## Hebrenjtë dhe Republika e Kanunit

sprovë, botim i dytë i plotësuar

**BOTIMET FISHTA**

<sup>20</sup> Traditën shqiptare të nderimit të gruas Konica e ilustron edhe me këtë shembull: "Nja dyzet vjet më parë gjithë shtypi i botës u mbush një ditë me lajmin për një bëmë trimërore: banditët në Trakë ndalën një tren ndër-kombëtar që shkonte nga Parisi në Stamboll. Të gjithë udhëtarët burra i detyruan të zbrisnin nga treni me plaçkat në dorë dhe ua ropën të gjitha gjërat e çmueshme, kurse kryetari i bandës u tha grave të qëndronin nëpër vende dhe disa herë u kërkoi falje për shqetësimin që u shkaktuan. Kombësia e banditëve u bë e njohur nga urdhrat që ai u jepte shokëve të vet në gjuhën shqipe".

<sup>21</sup> Atë Kolë Berishaj, Malsia e Madhe, vepër e cituar; shih dhe M. Elezi, Gjuha shqipe dhe ëndrra e një nate vere, Gj. Fishta, Tiranë 2012.

<sup>22</sup> Sipas këtij burimi: "Vojvoda i Rudnikut, Antonije Plakiq, e ka pjekur për së gjalli një grua plakë në qendër të Kralevës në kohën e Karagjorgjit. Në fshatin Zhabar... e kanë lidhur për hell gruan e Pavle Stanojeviqit të akuzuar për shtrigë, dhe kështu e kanë pjekur midis dy zjarreve".

Ka një gjë që është aq e vërtetë sa që të tmerron, posaçërisht në të qenit në afërsi të mëndafsheve, losionit (parfumit), të ndjenjave të pakontrollueshme, të seksit, epshit, etheve të epshit dhe aq më shumë të frymëmarrjes së një Colette, një Bovary, një Ana Karenina, Shqiptare, aq më shumë si shqiptarë, dhe atë vetëm për arsyen se e ndiejmë të gjallë, të ndodhur, dhe të patjetërsueshme, pikërisht nga letërsia, nga një roman i autorit Roland Gjoza në romanin e tij *Nessun Dorma*. Pikërisht sepse e ndiejmë të lindur, rilindur në afërsinë tonë një specie të harruar, bukurinë e gruas shqiptare në kohë të bujshme e tragjike, atë ndërmjet dy luftërave botërore, përmes romanit të autorit Roland Gjoza – *Nessun Dorma*.

Ne, të bartur nga e përditshmja, nga e sotshmja e të përditshmes, mbetemi brenda po të njëjtës, aq më shumë i bindemi në besim dhe në vetëdije, duke e parë këtë të tashme pikërisht si fillimin dhe fundin e jetëve tona, por edhe fundin e një të kaluarë, që gjithherë qe më e mirë, përkundër mizorisë në të cilën kemi qenë (dhe ende gjendemi) dhe gjithësi përkundër mizorisë që mund të sjellë një e tashme e pa perspektivë në të kaluarën. Jacques Derrida sjell dilemën e kohës në mënyrë të veçantë, por nuk është i vetmi, ai flet për pamundësinë e ndarjes së saj në tri shkallët hierarkike siç e bëjmë ne, se është e pamundshme të ndahet ajo, se është e pamundshme të jetohet po kjo hierarki, dhe aq më shumë që të izolohemi në një të tashme të përjetshme, pa pasur brenda saj edhe tërë të kaluarën e cila, në asnjë mënyrë nuk mund të pritet nga e ardhmja, por është vetë e ardhmja, e kaluar dhe e tashmja në të vërtetë.

Frosina, një personazhe monumentale e letërsisë shqipe nga romani *Nessun Dorma*, nga autori Roland Gjoza, është pikërisht ajo gjurma, e pashlyeshme e kësaj ndërthurje të kohëve, dhe të pamundësisë së kalimit të saj qoftë në të kaluarën, apo të tashmen tonë. Frosina, apo Fros, siç e quan bashkëshorti i saj Adriano, italian, në kohën ndërmjet pas Luftës së Parë botërore dhe deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, qoftë një dëshirë e endur dhe që endet si hije e kohërave të shpërthimit të jetës së festave dhe të hapjes së Shqipërisë ndaj Perëndimit për herë të parë në këtë shkallë, megjithëse në një pozitë tejet të vështrirë; dhe qoftë si një mundësi reale, e jetuar dhe e përjetuar – çan – nëpër të gjitha thurjet e Publikes sonë, shqiptare, qoftë asaj religjioze, të heroizmave të Luftës Çlirimtare dhe të patriotizmit, historisë siç e kemi të bërë Publike, dhe aq më shumë të shtjellës së Patriarkalizmit të kohëve tona, pra në këtë izolim tonin në të tashmen.

Frosina, Fros, është një nënë, grua tejet e bukur e mbetur e ve, në një kohë tejet të rëndë të Shqipërisë së kohës së Zogut. Ajo megjithëse është nënë e tri vajzave, ato janë martuar dhe ka shumë pak përkrahje nga to, në të njëjtën kohë është edhe nënë e një djali, i cili është një çudi e natyrës, në kuptimin e tmerrit të devijimeve të saj (gjë që kah fundi i romanit na jepet të dimë se ai vuan nga një sëmundje tejet e rrallë e quajtur – Progoni). Me gjithë kujdesin e saj të pashoq, të përpjekjeve të saj për ta ngritur në një shoqëri të rënë si kjo, konservative dhe të mjerë, me gjithë martesën e saj me një doktor italian (para kohës së ardhjes së ushtrisë italiane në Shqipëri) gjë që i mundëson të dyve, Frosit dhe djalit të saj Leonardo, të kenë një jetë të mirë, ajo në fatkeqësinë e Luftës, e humb djalin e saj Leonardo, me gjithë vuajtjet që ia sjell shëmtia e sëmundjes së tij, për shkak të fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Fatet e tyre ndahen, Leonardo, në mendjen e nënës së tij është në shërbim tek dhëndri i vajzës së saj, por ai në të vërtetë mbetet viktimë dhe hamall i punëve të pista të këtij dhëndri të tij, në moshën e adoleshencës së vonë. Në këtë Leonardo bie në kurthin e propagandës dhe të letërsisë (duke pas qenë gjithnjë i dhënë pas leximit) komuniste.

Në anën tjetër, Fros, Frosina e mbetur peng e epshit dhe etheve të epshit burror të shoqërisë për shkak të bukurisë së natyrshme që ka, bën një jetë të bujshme, të çmendur, të pasur, të lakmueshme dhe të lumtur me Adrianon e saj, dhe aq më shumë me një "armatë" italiane që i shkojnë pas, prej gjeneralit më të lartë të saj e deri tek më i ulëti i saj. Megjithatë, siç i ndodh Ana Kareninave të letërsisë, dhe të reales, Frosina tragjedi pas tragjedie, humb çdo gjë, edhe lidhjen me Adrianon, burrin e saj, nga xhelozitë dhe plagët e luftës, por edhe vajzën me të cilën humb çdo kontakt, dhe aq më shumë në një nga ditët e fundit të Luftës së Dytë

Mbi romanin "Nessun Dorma" të Roland Gjozës; Botoi BUZUKU

## VERBËRIA E NJË SHOQËRIE NË SYTË E NJË GRUAJE

Nga Ballsor Hoxha

Botërore, ajo sulmohet nga vetë i biri i saj derisa është në pritje tek gjenerali i ushtrisë italiane. Ndërsa Frosina e shpëton të birin nga varja në mes të qytetit, në tentativë vrasjeje të gjeneralit (dhe të nënës së tij), ai, i bindur në luftën dhe kaluar në një vrasës gjakftohtë, me të fituar luftën komuniste dhe partizanët e saj, pra vetë biri i saj Leonardo, e dënon tre herë radhazi me pushkatim nënën e tij, e cila shpëton pikërisht nga një kyç, e kompleks, i ndërthurjes së të kaluarës me të tashmen Komuniste të kohës së pas Luftës së Dytë Botërore, dhe kjo duke qenë se vetë Adriano, bashkëshorti i Frosinës, e ka shëruar një herë më të madhin e komunistëve të Shqipërisë. Gjë që u siguron një dalje, një exit, jashtë kësaj mizorie kolektive, e cila ka filluar të përhapet me shpejtësi në tërë kolektivin.

Endja e një Frosine, Ana Karenine, një Madamme Bovary, nëpër qarqet, festat, ahengjet, e në përgjithësi të jetës publike të kohës së ngjarjes në roman, është një endje e shpirtit të gruas shqiptare nëpër këto kohë liberale të shoqërisë shqiptare. Është një ngadhënjim i gruas shqiptare, jo me seks, e me "armatën" italiane që i shkojnë pas, në tërë ethet e tyre të epshit, por pikërisht në monumentalen e vërtetësisë dhe besueshmërisë së kësaj personazhe në këtë roman, në tërë atë që bart kjo grua.

Aq më shumë kjo grua, Frosina, e emëruar

e autorit Gjoza, është edhe një Colette, siç edhe ceket nga personazhet Mustafa Greblleshi, Gegë Marubi, e personazhi tjetër Ismail, duke qenë se ajo nxitet të shkruajë dhe të botojë letrat e veta (në pjesën më të madhe të tij romani është epistolar i përbërë nga letrat tejet feminine që ajo ia dërgon vajzës së saj Elvira) që ka njëshëm tërë të madhe me shkrintaren e mirënjohur franceze në realitet, Colette, që ka jetuar në Francë gjatë po kësaj periudhe.

Për t'iu kthyer çështjes filozofike të kohës, të bindjes dhe besimit si në një zot ndaj të tashmes sonë, së pari të ndriçojmë atë që Kierkegaard e farkëton si Publikja, e që është tërë shtjella, e të gjitha publikeve të një shoqërie, dhe më tutje po të njëjtën që Heidegger e huazon nga Kierkegaard, në mungesë të shprehjes dhe në përkrahje të saj, e që është pikërisht ndarja, ndërmjet autentikes individuale, të Dasein në të vërtetë, me vetë Ata, që është saktësisht vetëdija kolektive e një shoqërie.

Duke pas thënë këtë përmes asaj që Frosina na shërben këtu si – gjurmë – e thellimit dhe të – çarjes – së Publikes saktësisht, të shqiptares, për këtë kohë e tutje deri më sot, ne arrijmë nëpër fshirjet që ka bërë si ideologjia komuniste, dhe si perspektivat e tjera të shoqërisë sonë, prej asaj religjioze, e deri tek ajo Patriarkale, sot, që është fshirja, që aq bukur është sjellë e – çarë – nga po i njëjti autor, Gjoza në romanin e tij



"Edhe Noe kishte frikë nga vdekja", për të cilin është shkruar nga autori i kësaj eseje, pra fshirja e të shkuarës, të kaluarës, me të gjitha bukuritë dhe shpërthimet e saj.


Është fshirë e kaluara, ashtu siç ka qenë, dhe ne ngajmë të verbër para një imagjinate aq të bujshme dhe aq njerëzore, dhe humane të Gjozës, në këtë roman, jo vetëm gruaja në këtë periudhë tejet tejet libertine, dhe të hapur të shoqërisë shqiptare, por edhe tërë ajo që ka mundur të ishte një udhërrëfim për ne në këtë kohë, po aq liberale dhe po aq dekadente. Apo, në të vërtetë, përmes një romani të këtille mund të gjejmë pikërisht këtë lidhje të humbur të shoqërisë sonë me realitetin në të vërtetë.

Para nesh kemi një fytyrë të ngrirë të gruas – atë të nënës, kemi vetëm një fytyrë të shoqërisë – atë të familjes, dhe kemi vetëm një fytyrë për ndodhitë "underground" të shoqërisë sonë, qoftë në jetën e përditshme tonën, e qoftë në jetën e kësaj periudhe kohore, dhe kur ndodhemi në afërsi të emocioneve dhe të shpirtit të një personazhe aq monumentale dhe aq singertë të skaltur, ne ndiejmë se jemi po aq të verbër dhe po aq të – fshirë – nga jeta e vetë shoqërisë sonë, saqë ndodh se jemi në pamundësi për të qenë autentik në këtë shoqëri.

Në të vërtetë, në roman ka edhe një linjë, që krijon një lloj metafore të "armatës" së italianëve që pushtuan Shqipërinë, Adriano i Frosinës, është një Edipit, me komplekse të Edipit, i cili në tërë tmerrin e rrëfimit ka bërë marrëdhënie seksuale nekrofile me nënën e tij të vdekur, pa mundur të shqisë obsesionin e tij me nënën e tij italiane. Kjo, si metaforë është një lloj shërimi i plagëve të kësaj "armate" që kaloi nëpër këtë shoqëri, por edhe vetë pashkëputshmëria e njerëzores, me tërë incestin, dhe dhembshurinë e një nëne, si Frosina, qoftë me Progoninë, sëmundjen e Leonardos, dhe bukurinë e paharrueshme të gruas shqiptare, me të gjitha llojet e njeriut dhe me të gjitha të metat e tij. Në të vërtetë autori Gjoza është mjeshtër i ndërthurjes dhe pashkëputshmërisë së njerëzores nga vetja, dhe në këtë edhe botës së njerëzores, gjë që e bën të qartë se pikërisht – gjurma – për të cilën po flasim është ndërthurja dhe e pashkëputshmja e të gjitha rëndeve dhe kohëve e perspektivave mbi jetën, por të cilat asnjëherë nuk mund të përjashtojnë njëra-tjetrën.

Në këtë roman kalon një histori e tërë e shoqërisë shqiptare, por edhe asaj italiane pushtuese në Shqipëri, në këtë roman kalon një stuhi "shoku kulturor" (cultural shock) siç njihet në antropologji ndërmjet dy popujve, kalon një histori e madhe e shoqërisë sonë, por e shkurtër me gjithë të bujshmen e saj, apo ndoshta ishte vetë përjetimi, liria dhe liberalja që e tmerruan njeriun e gjendur në mizerje për një kohë të gjatë në këtë shoqëri që e përmbysën të tërën në një izolim të paparë në histori të njerëzimit, siç ishte tirania komuniste në Shqipëri. Mirëpo, gjurmët të cilat janë hapur këtu në këtë roman, e bëjnë të pamundshme që njeriu të mos pyetet, ku ishin njerëzit e kësaj kohe, apo, aq më shumë ku ishin gratë e kësaj kohe?

Për të përfunduar, Jacques Derrida thotë se nuk ka një hierarki të gjërave, ato janë një lloj manipulimi ynë me tokën, për të mundur të krijojmë rendet, Botën, dhe Publikën tonë, gjë në të vërtetë do të thotë se nuk ka një fizike të patjetërsueshme, apo një të tashme të patjetërsueshme, e aq më pak një të kaluar të tillë, në të vërtetë, aq më shumë, nuk ka një shenjë – fizike, që mbetet gjithherë e njëjtë, në të vërtetë ato gjithnjë kalojnë në shënjim të të njëjtave, duke humbur shenjat në tërësi, apo ato duke qenë vetëm marrëveshje njerëzore, në këtë duhet thënë se Frosina e Gjozës kalon në një shënjim të një verbërie tejet tejet të thellë të shoqërisë sonë, të një mungese tejet tejet të thellë të shoqërisë sonë, dhe të një mashtrimi po aq të thellë, sigurisht, për gruan shqiptare, pavarësisht hierarkisë kohore!



"Fros, tashmë një heroinë unike e letrave shqipe, vjen nga një penë e sigurt nga një kohë vllimesh, intrigash, zhvillimesh, ambiciesh si dje, si sot!"

BUZUKU

Shkrimtari, përkthyesi, skenaristi, diplomati dhe pedagogu Ylljet Aliçka nuk është një emër i panjohur brenda e jashtë vendit, për aq kohë sa ai shkëlqen si një prej autorëve më të mirë të letërsisë sonë bashkëkohore. Mjeshtër i një stili të veçantë shkrimtarie dhe këndvështrimi të mprehtë për botën e djeshme, të sotme dhe të nesërme, Aliçka ka gdhendur prej kohësh profilin e një shkrimtari të spikatur. Në dukje të parë modest, duke nisur që nga volumi konçiz i veprave të tij, ky krijues, të zë "pritë" me befasitë e tij artistike, që i shpalos faqe pas faqeje e personazh pas personazhi. Nuk janë vetëm skulptorët ata që mbajnë dorën kur gdhendin veprat e tyre, por edhe shkrimtarët kur mprehin penën për të krijuar personazhet e tyre. Madje, shkrimtarët lodhen ca më shumë, sepse, duhet që përveç krijimit të personazheve, të krijojnë edhe atmosferën plot ngjyra jete, ku duhet të veprojnë heronjtë e tyre artistikë.

Historia e letërsisë, qoftë për veprat e klasikëve të mëdhenj, qoftë për ato të kohëve moderne, ka konsideruar krijime të pavdekshme artistike ato vepra, të cilat me personazhet e tyre kanë frymëzuar ndryshime të mëdha, revolucione politike e sociale, duke tejkaluar kohën dhe autorin e tyre krijues. Psh, shkrimtarëve të mëdhenj si Dante, Shekspiri, Balzaku, Hygo, Tolstoi, Gogol, Xhojsi, Nabukov, Dostojevski, Folkner, Dikens, Drajzer, Markez, Molier, Flober etj, u ngatërrohet pasaporta e identitetit personal me personazhet që kanë krijuar. Ashtu si skulptorët dhe piktorët e mëdhenj, që mbetën përjetësisht të gjallë nëpërmjet veprave që lanë pas, të cilat gjenden në sallonet më të famshme të Europës e botës, edhe shkrimtarët e poetët e mëdhenj kanë lënë si trashëgimi të vazhdimësisë së tyre, personazhet që kanë gdhendur me penën e tyre. Hamleti, Makbethi, Mbreti Lir, etj, e kanë tejkaluar autorin e tyre në famë ose e rivalizojnë atë denjësisht edhe sot! Askush, nuk thotë, psh, "dilemë shekspiriane", por të gjithë thonë, "dilemë hamletiane"! Ylljet Aliçka është një nga ato shkrimtarë, të cilët nuk nxitojnë pas numrit e volumit të veprave e, aq më pak drejt famës së tyre individuale. Komod brenda kostumit qytetar të modestisë, ai gdhend ngadalë dhe me mjeshtëri të rrallë profilet e personazheve të tij të "zakonshëm", që vijnë mes nesh me historitë e tyre të "jashtëzakonshme". Për Ylljetin duket qartë se nuk ka rëndësi personazhi i "jashtëzakonshëm", por letërsia e jashtëzakonshme! Ai e di që nuk e sjell dot një Hamlet shekspirian në mesin tone, por sjell dilemën hamletiane të mijëra njerëzve të zakonshëm, të cilët jetojnë në një kohë të jashtëzakonshme, brenda të cilës rripërtytet në heshtje vargu hamletian; "të rrosh a të mos rrosh - kjo është çështja"! Këto heronjë, vijnë si njerëz të zakonshëm, por jeta dhe mesazhet që na sjellin, janë të jashtëzakonshme. Mbase i zalisur nga periudha e një letërsie soc-realiste shqiptare, kur në qendër duhej të ishte patjetër një "personazh i madh", një "hero kryesor", Aliçka, (edhe në shenjë të refuzimit estetik), ka zgjedhur të na flasë me personazhe të "zakonshme". Sepse, e gjithë pesha e shoqërisë, na thotë ai, bie mbi supet e këtyre të "zakonshmeve", të cilët shpesh bëjnë një jetë të jashtëzakonshme deri në absurd. Janë pikërisht këto personazhe "të zakonshme", të cilët dalin jashtë vetes duke përdorur mjete e forma të jashtëzakonshme për të bërë, në fund të fundit, një jetë të zakonshme! I tillë është, psh, mësuesi "mashtrues" Shasivari, tek romani "Histori të Njerëzve të Zakonshëm", i cili mban një xhep një autorizim fallco për të realizuar falas udhëtimin e tij me makinë, në një vend ku ka pak makina... Shasivari i kohës së shkuar, sot nuk mban në xhep një biletë fallco, por mban autorizime dhe vërtetime pronash që nuk i takojnë, siç mban tituj

## E JASHTËZAKONSHMJA E "PERSONAZHEVE TË ZAKONSHËM", TË AUTORIT YLLJET ALIÇKA

Nga Arben Çejku

akademik të vjedhur apo të blerë..Unë mendoj se nuk është modestia ajo që e shtyn shkrimtarin e njohur Aliçka, të merret me personazhet e zakonshëm (historitë me njerëz të zakonshëm), por mjeshtëria e tij e lartë artistike, vetëdija e tij e thellë social - filozofike, ajo që e ka planvendosur në një këndvështrim të tillë të shikimit të jetës. Ai kërkon të mbetet original dhe si i tillë, ka zgjedhur të mos e shikojë jetën nga lart - poshtë (ku personazhet janë figura qendrore të jetës publike) as nga poshtë - lart (ku personazhet janë figura shumë periferike), por shikon drejtpërdrejt, në përditshmërinë e zakonshme, në të cilën është jeta ajo që i bën personazhet "të jashtëzakonshëm". Ata nuk lindin të tillë, por duket se rrethanat e jetës, u diktojnë atyre stilin e të menduarit dhe formën e sjelljes shoqërore. Aliçka, në tërë veprën e tij, përfshi edhe romanin më të fundit "Histori Njerëzish të Zakonshëm", nuk kërkon të na imponohet si "shkrimtar i jashtëzakonshëm", por, përkundrazi, duke qëndruar vetë sa më në hije, nxjerr gjithnjë e më shumë në dritë të jashtëzakonshmen e njerëzve të zakonshëm! Nuk besoj se është një rastësi kjo strategji stilistike e rrëfimeve të mëdha nëpërmjet personazheve të "vogla" (të zakonshme). Kjo mund të konsiderohet një risi në prozën modern shqipe. Shkrimtari Aliçka, nëpërmjet personazheve të tij të zakonshëm, duket se na fton të gjithëve në vallen e tij letrare, duke na thënë se, "edhe ti mund të jesh, ose mund të ishe njëri prej tyre". Figura e mësuesit - një personazh i zakonshëm në jetën e

përditshme, i cili nuk është as në foltoren e parlamentit, as në karrigen e ministrit, as në studiot rrëzëllitse të televizioneve, vjen në veprat e Ylljetit, krejt natyrshëm, duke hyrë pa droje në teatrin e madh, ku secili prej nesh luajmë një rol të caktuar. Vëzhgues i jashtëzakonshëm i realitetit dhe studiues tepër i hollë i tipave dhe karaktereve, që i kalojnë pranë rrugëve të kryeqytetit apo në vendet ku ka punuar e jetuar, Aliçka përzgjedh mes tyre disa nga personazhet më pikante, ata që kanë "karakteristika" të veçanta. Jo vetëm përshkrimi plot ngjyra dhe me detaje sarkastike, por edhe përzgjedhja e gjuhës së personazheve në dialogjet konçize që zhvillojnë, bën që, secili prej tyre të duket aq i gjallë sa mendon se do e takosh diku përsëri nesër. Kështu ka ndodhur me mësuesit që kemi parë tek filmi "Parullat", ku ne njerëzit e zakonshëm kemi parë personazhet e zakonshëm, në një kohë të jashtëzakonshme! Mësues Shasivari, tek "Histori Njerëzish të Zakonshëm", është një personazh i zakonshëm, që sjell mesazhe aktuale nga një kohë e jashtëzakonshme, të cilën duket sikur e kemi lënë pas. Ai, në përditshmërinë e tij, rrokulliset si një kungull social i lyer me ngjyrën e kohës kur jetoi. Pyetja që rri pezull në këto vepra të Aliçkës është: pavarësisht kohës kur kanë jetuar këto personazhe, a janë karakteret e tyre të gjalla edhe sot mes nesh? Përgjigjen e marrim po nga Aliçka nëpërmjet filozofisë së personazheve të tij dhe, "po", ato karaktere, pavarësisht kohës kur jetuan, janë edhe sot mes nesh si plagë e moralit shoqëror, si



dhimbe e idealistëve që duna një shoqëri të përsosur. Pavarësisht ndryshimit të sistemeve politike, udhëheqësve, ligjeve etj, palca e një shoqërie qëndron pikërisht tek njerëzit e zakonshëm dhe, vetëm kur të ndyrshojnë normat morale dhe sjellja shoqërore e njerëzve të zakonshëm, atëherë ndryshon edhe vetë shoqëria në tërësi. Ky duket se është një nga mesazhet e fshehura të autorit. Për aq kohë sa ne jemi ende në rretjen e një mentaliteti konfrontues dhe arrivist, ku nga mëngjesi deri në darkë mendojmë se, si "t'i bëjmë gropën tjetrit", nuk mund të pretendojmë të bëjmë hapa të mëdhenj përpara. Brenga e autorit, më shumë se artistike, është sociale, politike e morale. Ylljet Aliçka, pavarësisht se abstragon në procesin e shkrimtarisë, ai vetë është një personazh i "zakonshëm", i këtij tranzicioni të jashtëzakonshëm 30 vjeçar, që sillet si teatër kafkian. Romani "Histori Njerëzish të Zakonshëm", mund të ishte fare mirë një sagë librash me historitë e jashtëzakonshme të mijëra njerëzve të "zakonshëm", të cilët i kanë dhënë formë asaj që ne e quajmë dje ose siç e quajmë sot, "shoqëria shqiptare". Por, edhe me një histori të vetme, me historinë e mësues Shasivarit, shkrimtari dhe skenaristi Ylljet Aliçka, na sjell një dramë sa qindra drama me mesazhe të qarta për shoqërinë e sotme. Ylljet Aliçka, ka meritën, veç tjerash se, me personazhet e tij të "zakonshëm", po i tregon botës një Shqipëri (dhe shoqëri) të jashtëzakonshme.



Onufri Roman

Në mbledheshim mbrëmjeve te kafe *Joni*. Atë, Vele tinëzarin, e kishte një piktor i njohur, i çmendur pas portreteve të vazave midis moshës 15 deri 18 vjeç. Thoshin se ai mbeti përjetë një adoleshent. Atë natë kisha mbetur vetëm. Porosita një konjak dhe shikoja përjashta kopshtin, rruginat e tij dhe dritën e derdhur përmes një drithërimi të lagësht. Pashë në mur portretin e Veles, inxhinierit dhe karikaturistit të famshëm.

I gjallë. I kthjellët. I menduar. M'u bë se doli nga korniza e bukur dhe m'u ul pa u ndjerë pranë, duke thithur ajrin në një mënyrë krejt të veçantë. Dukej i menduar. Vështronte dhe ai kopshtin që drithërohej nën rrezet e dritës përjashta në përplasjen pa zhurmë të gjelbërimit në xhamat e mëdha të dritareve të kafenesë. Në krye flokët e bardhë, të shtruar, binin në kontrast me sytë e tij të kaltër me një vijë të trashë kafe në mes duke krijuar një hije të veçantë që të përpinte e që të rrëmbente me ëndje. Se aty mund të ngecej befaz dhe menjëherë, duke u krijuar një marrëdhënie e bukur intime, si në një miniaturë të përsosur, e punuar sigurisht nga ndonjë dorë mjeshtri. Kjo ishte ndjesia e parë.

«Ke pasur rast të shohësh ndonjëherë detin Jon në një ditë ndryshe të zakonshmes?» – më pyeti me një fill zëri dhe me një tronditje që s'e kisha vënë re më parë. «Ç' domethënë në një ditë ndryshe të atillë? Më duket pyetje e vështirë. Po, edhe e kam parë. Ku ta dish!» «Të paska bërë përshtypje dhe duket se e paske kuptuar deri në fund, drejt ta hajë! Dhe, ta dish, këtu ka qenë dhe është e keqja, secili shikon atë që i intereson! Prandaj kemi lindur dhe jemi kështu... miku im. Jemi ne që herë-herë e zbukurojmë botën dhe ndërkohe ndodh që e shëmtojme atë, por kurrë nuk e gjykojmë siç është në të vërtetë. Nuk të duket e çuditshme? Të paktën në pamje të parë...»

M'u bë se po shihje portretin e tij. Mua më ngacmoi fort kjo ide, jo si mendim por si vegim. Në kafene heshtja pllakosi dhe ndërkaq mbeta pa mend para syve të tij, në një ngjyrë deti të kthjellët, që shprehin karakter të fuqishëm, një personalitet jo kompleks por të pastër. Aq e qartë ishte drita e syve të tij, ndonëse një vijë e hutuar e përshkonte si hije duke hedhur një dritë të ngathtë. U ktheva andej, nuk e besoja kurrë që të mbetesh edhe unë i hutuar. Doja ta dëshmoja që të vërtetën që shihja, famën, emrin, kohën, shterjen, ecjen, punët, ku nuk të shkonte mendja! Më dukej vetja sikur unë, s'do t'i shihja më ata sy të çuditshëm, që tani kishin ngjyrën e qiellit plot dritë dhe pastaj errësoheshin papritur, më tej shfaqej një frikë e çuditshme dhe mashtruese. Kurrë, tek ndonjë njeri tjetër nuk mund ta dalloje këtë ndjesi dhe parandjenjë.

Nuk thonë kot, fati të çon deri te sytë, por nuk të fut brenda. Po kjo edhe kur ndodh, punë e Zotit, nuk ta rrit famën, as të shuan kureshtjen...

Të them të drejtën, mbeta pa frymë para syve të tij. Si ishte e mundur që sytë ndryshonin tonin ashtu? E kaltra mbetej e kaltër po me ton tjetër. Kur zemëroheshin shtohesh bluja e thellë, që dukej se derdhej në shpirtin e tij me një dritë dhe intensitet madhështor. Ditën tjetër ishte i qeshur. Çfarë kaltërsie shprehin sytë e tij! Dallohej e qeshura dhe serioziteti, mërzia dhe indiferenca. Çdo ndjenjë shprehej me tonin e saj të së kaltrës. Edhe karakteri i tij ashtu shpalosej, sërish me këto dritëhije. Sytë e tij flisnin, pyesnin, bërtisnin, qëllonin me shuplakë, i binin fort tryezës, ironizonin thellë, mendoheshin gjatë, satirizonin me kujdes por nuk talleshin kurrë. Aq e thellë ishte e kaltra, si sytë, edhe karikaturat e tij të mrekullueshme...

Ndonëse e kuptoja të vërtetën për çudi e ndieja pranë dhe dora e tij ishte mbi gjurin tim dhe ndërkaq ai më shihte thellë. Ia vura re se hije e vijës në sy po shtohesh. E ndjeva se donte të më tregonte diçka të rëndësishme. E mori fjalën i qetë dhe tregimi i tij do të mbetej pronë e zemrës së ngacmuar keq, që dukej qartë në dritën që i merrnin ata sy të hatashëm. Mund të ishte i pa rrahur me jetën, mund të ndiheshë i rraskapitur e nervoze, mund të kundërmoje aromë manxurane (o Zot, aroma e manxuranës!), por mund të kutërboje edhe erë naftë e vaji, mund të ndieje se aroma e rëndë e duhanit vallëzonte pranë teje, por edhe sharmi s'të ndahej, kurse në të vërtetë pislëku i nëntokës së zezë të kishte përfshirë me gjithsej. Eh. Mund të kishte disa ditë pa u larë, por edhe të ishte përfshirë në një botë të kthjellët mendimesh e sysh...



## VAJZA E VALËVE

«Nëse mjerisht fati të shtyn të lypësh, trokit vetëm në dyert e mëdha.»

Tregim nga Xhevair Lleshi

Sytë e zgjuar të Vele tinëzarit! Mund t'i quaj se tingëllonin paksa cinikë, me një dritë zhdërvjelltësie kunadhërore, por jo, ata sy vuanin nga sinqeriteti. «Isha në Llogora dhe po zbrisja drejt detit Jon. Pamje më madhështore vështirë se të rrok syri. As e kuptova se nga shpërtheu stuhia, ngase u ngrit deti ashtu kas, nga plasën vetëtimat, prej malit të tyre, Çika apo Rrëza, nga dolën retë e zeza që vraponin të çakorduara e me aq ngut, dhe nga erdhi mes kryqëzimit me gërshetime dritash nga thellësia e detit një fytyrë vajze, një trup vajze. Gjigante dhe e hijshme, me kostum ajri dhe deti, «prerë» me shije të hollë e që i rrinte për bukuri, që nuk ia mbulonte dot dobësinë, asgjë nuk i fshihej dot. Vajza e Valëve! Ajo ishte. M'u faneps! Më zuri në befasi! Dukej se u rrit deri në lartësinë time, sikur më buzëqeshi, e bukur si pika e lotit! Aq finesë dhe sharm delikat s'kisha parë ndonjëherë! Ishte një gjë që s'mund ta harroja dot kurrë! Ku s'e çova mendjen, ku s'më çoroditën kujtimet, nga ime më te gjyshja e dashur, nga vajzat e Bregut te çapkënet e Tiranës (vajza më të bukura se ato të Tiranës nuk gjen dot në botë!)... Dhe mbeta i ngrirë. Ajo s'mund të ishte mirazh, lojë e dritës dhe e ujit! Ajo nuk ishte as lojë e fantazisë. Ishte diçka që të shfaqej, të rrëfehej. Edhe për të mirë, edhe për të keq...

Ajo, Vala, më shtriu dorën duke buzëqeshur (ç'buzëqeshje, o Zot!) dhe nuk e fshiu pikën e ujit (të detit a të shiut?) që i mbeti në mollëz, ndërsa unë e shihja i patakshur, plot sharm dhe dritë, po edhe i trembur, se Ajo ishte punë Fati, Drite, punë Besimi dhe Jete, e ç'nuk ishte ajo! Ajo, Vala, ose Vajza e Valëve, ishte vërtet e shpenguar, prekte ç't'i tekej, errej dhe dritësohej, fliste pa zë dhe bëhej të thuash... aq e ëmbël... Aty-aty dukej se fliste edhe me retë. Të bëhej ndoshta se e rrëmbente pasionin dhe s'do t'i pushonte goja! Dhe çfarë! Ajo gojë e madhe dhe aq e ndjeshme, gjithë tul, e kuqe, dukej sikur të ftonte që të bëje marrëzira. Po sytë? Sytë e saj dhe kthehu prapa! Ishte ngjyra që pëlqej e që më linte pa mend. Është pak të thuash se të ndizej gjaku. O Zot, Vala, Sirena e detit Jon, e pashë, edhe unë duhet të jem një Qenie e përkëdhelur? Ç'them! Nuk duhet të jenë kaq të rrallë ata që e kanë parë, ose që e shohin. Të jetë Art? E pse nuk qenka Mëkat? Mirë, e kuptoj që Arti me Mëkatin nuk ngjizin dot Vajzën e Valëve(!), edhe po të jetë më urdhër të Zotit. Ai që e sheh vdes menjëherë! Atë çast unë duhej të vdisja. Më avulloi ankthi menjëherë sepse vija të isha gjallë dhe shëndoshë e mirë. Mos më bënin sytë nga... lodhja, për shembull, po edhe lodhja pas asaj që pashë gas e shkoi. Mos nga gjendja e rëndë nervore? E ku e gjeta unë gjendjen e rëndë nervore? Isha gati të shkalloja. Ajo, Vala, u ngjiz në shpirtin tim, u plazmua aty. Ndërkohë frynte erë e marrë. Malet krejt plot e përplot vetëtimat. Deti i egërsuar ishte gati t'i ngjiste dallgët dhe të mbulonte malet. Ne zbrisnim Llogoranë drejt detit dhe reve të tërbuara. Imazhi që shihja përflakej dhe bëhej i dukshëm vetëm nga feksja e vetëtimave, që

buzëqesh dhe vetëm buzëqesh nën dritën e marrë, që dukej se rrinte mbi gjemba dhe e ndiente veten të tepërt. Dukej vërtet e çmendur në një lojë të tillë të mallkuar dritash. Ajo më kishte zgjedhur mua! E habitshme. Kurrë nuk e kisha kënduar këngën e saj! Kurrë nuk e kisha mësuar atë histori deti, floçke, zane apo qenieje tjetër të rëndomtë, qoftë edhe njerëzore.

Befaz më feksi një mendim. Ai që i krijoi këngën, ai që i thuri legjendën, ai është edhe fatlumi! Kurse unë, edhe po të isha i dyti, përsëri kishte pak rëndësi, sepse do të isha i pari i humbësve. Ishte e garantuar humbja. Një mister i pafund, i tmerrshëm. Një paralajmërim i madh! Si të jetë e mundur që kjo fytyrë engjëllorë të shfaqej kështu?... Si?...

Ajo, Vala, Vajza e Valëve, dukej se qe veshur me dritë dhe det, me re dhe vetëtimat, po atë «kostum» elegant, ku binte në sy një bluzë e mëndafshhtë me një të kuqe të ndezur që sa herë vizhëllonin vetëtimat shpalosej në një hapësirë të pamasë. Po ia shihja herë-herë lëkurën e brydhët, të lëmuar, ia shihja hijet e qerpikëve mbi faqet e kuqërreme, ia dalloja qartë sytë (ah ç'sy qenë ata!), sy aq të ëmbël e dinakë s'kisha parë ndonjëherë... Jo, diçka s'po më pëlqente, e them hapur, ndonëse në mendimet e mia kish zënë rrënjë e keqja, dyshimi, fati, një gjë mistike që e bashkëshoqëron jetën e njeriut. Ndërkohë e merrja me mend sesi do ta kisha zhveshur, do t'ia kisha hequr këmbëshin e hapur që do t'ia zbulonte përgjysmë huret, kurse flokët le t'ia rrëmbente era e fuqishme dhe ta mbulonin hapësirën detare që rroknin sytë e mi të ndezur. Flokët e saj le të derdeshin mbi supet e detit, ashtu si mbi supet e vetë asaj... Sytë e mi e ndieja që lëvrinin plot brengë. Ishte e kotë. Megjithatë unë gjithmonë e them troç gjithçka ashtu si më vjen. Por një valë pasioni duket se më tradhton dhe sytë më zmadhohen me një hutim fatkeq...

Papritur m'u bë sikur Vala donte të fliste. Si do të qe zëri i saj? Por, ndërkohë, vura re se ishte gati t'ia shpërthente të qeshurës. Përsëri isha kureshtar të dija si do të ishte e qeshura e saj. Kaq thjesht. Kureshtje. Ajo as foli dhe as qeshi. U përqendrova te portreti i saj i madhërishtë, mrekullitë plot mister të fytyrës së saj, duke lëvizur nga sytë te goja, nga balli te flokët, nga hunda te mollëzat, nga lëkura te shprehja lojcake e syve, nga vështrimi i drejtpërdrejt e pa komplekse te delirësia dhe mëkat! As vetë nuk e dija ç'mendoja dhe endesha nëpër to. A do t'i qe shfaqur Odiseut kjo sirenë? Me siguri. E ç'siguri zeza! Odiseu i ka shpëtuar asaj, me siguri...

Vala, gjithnjë me një delikatesë nervoze, nuk më ndahej nga sytë. Zemra më hovte me gashëri, shoqëruar po nga ai hutim dhe frikë e çuditshme. Prisja të mbaronte stuhia, të largoheshin retë dhe të reshtnin vetëtimat. Duket se do t'më duhej ta këqyrja për një kohë të gjatë vendin nga shpërtheu «fontana» e saj (m'u qesh). Si do të më dukej po të largohej ai imazh aq i bukur, madje i përsosur? Prisja

që kjo të bëhej por nuk po ndodhte. Pastaj i lutesha me mend, po ajo nuk donte që nuk donte të largohej. Vetëm një më dy dhe ajo pikëllonte, kështu më bëhej ndoshta, sikur pikëllonte nga yjet e dritës së vetëtimtë që ishte kaq e ëmbël dhe delikate, ndërsa të bënte përshtypje që ndjehej e përkëdhelur në sedër. Ajo, Vajza e Valëve, ishte e thjeshtë dhe dukej e pavëmendshme, pa i kushtuar kujdes efektit tronditës të hireve të saj. A do t'i lutesha detit që Ajo të më vinte përsëri një herë tjetër? Sigurisht që deti do të pranonte. Dhe Ajo ndoshta do të vinte. Por do t'më duhej t'i lutesha edhe stuhisë, vetëtimave, Llogorasë, Çikës dhe Rrëzës! A do të pranonin ata? Po të pranonin, si zakonisht, unë do ta këqyrja ngadalë dhe për një kohë të gjatë. E megjithatë Ajo nuk më largohej, ndonëse mendimi im e kërkonte për herë tjetër. Po ç'ishte ky mall e kjo dashuri e marrë, që kujtohej për atë që do të vinte kurse unë e kisha ende para syve? Mos po e shihja edhe në mungesë? M'u duk se m'i nguli sytë fort. Nuk kishte as urrjetje, as zhgënjim, po një përqendrim zhbirues dhe asgjë tjetër. Vura re një grimë nervozizmi dhe sikleti në sytë e saj të padjallëzuar në feksjen e radhës nga vetëtimat e panumërta. Dhe më erdhi pranë një psherëtimë. Nuk do të ndahem kurrë nga sytë e tu. Do të jem me ty. Në të mirë e në të keq... U drodha. Një zë qiellor, i butë... Kishte depërtuar Ajo te shpirti im, apo unë te shpirti i saj? Kurrë s'isha mësuar ta shikoja një gjë kaq thellë e me aq zjarr... Ah, Vala, Vajzë e Valëve! Foli Vajza e Valëve dhe nuk u largua. Nuk më zinte më pamjen dhe deti ra fashë, stuhia u largua dhe vetëtimat u ndërpreen. Nga erdhi ajo qetësi sublime? Por ama nuk qe nevoja ta kërkoja Atë. Ishte brenda meje. E shihja në dritën time shpirtërore. Ajo u ngjiz dhe mbeti e fiksuar në shpirtin tim... E çuditshme? Imazhi i saj qëndron aty në vetëdijen time, që është krejt e ndezur nga loja e dritës së stuhisë. E shoh në të gjitha trajtat dhe format, e dëgjoj psherëtimën e saj, edhe kur ndërroj vend, edhe në çastet kur nuk e dua imazhin e mrekullueshëm e përplot magji të Vajzës së Valëve, të Floçkës që mbuloi gjithë Jonin sa më hante syri mua. Dhe, ndërkaq, mezi e pres, një çast, të më shfaqet para syve, atë, Vajzën e Valëve! Një frymëzim brengosës më mbulon. Ndoshta prej një loje krejt të fshehtë, kam rënë brenda. Po ku? Rri dhe shoh përtej në hapësirë dhe figura e saj, në atë lojë që m'u shfaq, më del para syve me një buzëqeshje që atëherë nuk e vura re. Dhe oh, s'ka si pritja! Të presësh! E bukur dhe e tmerrshme. Më duket se Ajo më përsosi artin e pritjes, se ma perfeksionoi durimin e gjatë e aq të munguar. Jo, i dyti nuk qenka vërtet i pari i humbësve! Të mos vijë, apo më mirë të vijë? Si të duket, mik? Sa herë bie shi dhe ka stuhi Ajo nuk del para meje, sepse ka ndodhur e pa ndodhura, ajo është futur brenda meje dhe nuk largohet kurrë më. Mjaft që unë ta kujtoj. Dhe puna ecën mirë, dhe veprat e mia dalin të përsosura, edhe ironia ime sikur është zbutur ca, edhe sarkazma madje më del më ëmbël... Po kjo? Ndoshta ndonjëherë bie shi i kaltër dhe shfryn ndonjë stuhi e bukur! Një ndjenjë e çuditshme ma shtrëngon fort zemrën si me darë, më përqafon një trishtim i ëmbël, më duket sikur Ajo do t'më largohet për fare... Mos?... A do të vijë? Si mendon ti? A do të vijë? E keqja ndodhi, mik. Një ditë me diell (edhe Floçka ime ishte me mua!) vjen gazi 69 te shkallët e punës sonë dhe më vë pranë! Unë nuk u ktheva në shtëpi por mbeta peng i të tjerëve dhe i vetes. Ajo, Vala, Vajza e Valëve, ishte kudo me mua! E ndezur, e zjarrtë, në lojë dritash, e dhënë, sublime, e dashur, e qeshur hera-herës, m'i mprehu shqisat që t'i vija veshin mistikës së artit dhe të fshehtave, të papriturave të jetës. Edhe pse prapëseprapë do të vdisja, ajo nuk më la jetim të fatit. Ndenji me mua, ndaj dhe m'u shfaq atëherë tek zbrisja Llogoranë përmbi det... Hapte derën e shpirtit dhe i hidhte një sy mugëtirës për të gjetur një siluetë jete, të paktën një siluetë tjetër... Ndoshta ia ka arritur qëllimit. Po të mos ishte Ajo... Sidoqoftë nuk më hiqet nga mendja se Ajo m'u shfaq, m'u rrëfye, si dritë e Zotit, përmbi Jon në lojën e stuhisë me vetëtimat... Pastaj ulem para imazhit dhe mbetem pa frymë. Jo rrallë, prej marrëzisë sime, ajo sikur ngjallet, është gati të më flasë... A do të vijë? Eja shpirt. Unë të pres. Jam këtu tek kafene Joni... A ma di emrin? A më mban mend?...»

Vlorë, më 21 mars 2016



Avioni i linjës Paris-Vjenë lëvizi ngadalë në pistën e qullur nga shiu i qetë, i cili nga mesdita, kishte përfshirë jo vetëm qytetin, por edhe rrethinat e tij. Përtej dritares së vogël, vështroja avionët e tjerë, që dukeshin si të përgjumur, në pritje për t'u ngritur dhe për të fluturuar nëpër qiej. Kur avioni u shkëput nga pista, hodha për herë të fundit vështrimin jashtë. Qyteti i madh, nga lart, dukej i zhytur në grinë e tij dhe shiun që binte e binte njësoj si në romanet e Heminguejit.

Në aeroportin e Vjenës nuk binte shi, por ndjeva menjëherë ajrin e ftohtë dhe të thatë, si dhe një aromë pragdëbore... Pashë orën. Ishte katër e pasdites dhe pasi përfunduan veprimet rutinë dhe ne u ngjitëm në një nga katet e larta të aeroportit, ora kishte shkuar pesë. Duheshin edhe pesë orë të tjera pritje, për t'u nisur më pas me avionin tranzit për në Rinas. Edhe pesë orë, mendova, ndërsa u ula në një nga ndenjësiet e gjata pranë hapësirës së xhamtë, nga e cila dalloheshin qartë pistat e gjata të aeroportit dhe avionët që ngriheshin dhe uleshin në të. Tutje, në horizont, dallohej autostrada, e cila lidhte aeroportin me Vjenën dhe më tej, atje ku po binte muzgu që do të zgjaste shumë, hapësirat periferike të kryeqytetit austriak. Ndoshta andej, nëpër ato hapësira, shumë shpejt do të fillojë dëbora, që do të bjerë flokë-flokë mbi kurrizët e avionëve, thashë me vete, ose butë-butë dhe *ëmbël*. Dëborë e *ëmbël*, qesha me vete nga epiteti i papritur që më erdhi në mendje.


Në ndenjësien përballë ishte ulur një çift i ri, që nga veshja e vajzës, me siguri duhet të ishin nga Lindja. Vajza, me shaminë e lehtë hedhur mbi flokët e zinj, herë-herë, se ç'i thoshte djalit... Ndërsa vështrimi i syve të saj të bukur, mbarte një melankoli a trishtim tërheqës... Jashtë kishte rënë nata dhe me siguri do të ishte bërë ftohtë, ndërsa brenda ishte ngrohtë dhe dëgjoheshin valset e famshme të Shtrausit. Hapa çantën e vogël dhe prej andej mora një libër me tregime të Markesit, që çuditërisht e për rastësi, sytë më shkuan te tregimi "Avioni i bukuroshes së fjetur". Qesha me vete, sepse e njëjta gjë më kishte ndodhur edhe tre vite më parë, në aeroportin "Fiumicino", ndërsa prisja avionin për në Nju Jork dhe me vete kisha të njëjtin libër të Markesit.

Përballë meje, bukuroshja me shaminë e hedhur lehtë mbi kokë, vërtet po flinte, e mbështetur në supin e djalit, të cilit dukej se edhe atij po i vinte gjumë. Pak më tutje, në fund të të njëjtës ndenjëse, një çift të moshuarish, ushqenin njëri-tjetrin me çokollata. Burri i moshuar, me borselinë të vjetër, dukej si aktor i filmave neorealiste italianë, ndërsa gruaja, me fytyrë tejet të zverdhur e shkëlqim të dylltë, dukej sikur kishte dalë nga romanet e Balzakut. Ku po shkojnë vallë, thashë me vete. Për ku do të fluturonte ky çift të moshuarish, në këtë natë të ftohtë dimri, ndërsa kënaqeshin si fëmijë, duke ushqyer njëri-tjetrin me çokollata? I lashë ata në lumturinë e tyre, duke iu rikthyer leximit të "Bukuroshes së Fjetur". Minutat kalonin dhe në pistën e aeroportit të Vjenës, vazhdonin uljet dhe ngritjet e avionëve të qiejnetëve. Çifti i të moshuarve nuk ndodhej më në vendin ku ishin ulur më parë. Me siguri, të ulur pranë njëri-tjetrit, të lidhur me rripat e sigurisë dhe duke ushqyer njëri-tjetrin me çokollata, ishin duke fluturuar kush e di se në ç'hapësira qiellore. Vetëm bukuroshja kishte mbyllur sytë e saj të zgjatur si bajame dhe flinte e mbështetur në supin e djalit, i cili kishte zgjatur këmbët dhe si i përhumbar, vështronte natën përtej xhamave. Ndoshta jashtë kishte filluar dëbora, sepse djali ma bëri me shenjë që të ngrihesha dhe të shihja... E lashë librin e Markesit mbi ndenjësë dhe u ngrita... U ngrit edhe djali dhe pas tij, e trembur, edhe vajza e bukur nga Lindja. Ajo se ç'tha në gjuhën e saj që më tingulloi si ajo e poezive të Khajamit: e *ëmbël* dhe e brishtë.

Ky tregim botohet me rastin e 75-vjetorit të prozatorit Enver Kushi, lindur më 14 mars 1949, në Ditën e Verës

## AROMË VJENEZE

### tregim nga Enver Kushi



Jashtë binte borë. Mijëra e miliona flokë të mëdha, nën ndriçimin e prozhektorëve të fuqishëm që rrethonin aeroportin, qetë-qetë e me delikatesë, dukej sikur vallëzonin nën shoqërinë e muzikës së valseve të Shtrausit. Bukuroshja nga Lindja, befas përplasi pëllëmbët e duarve nga gëzimi. Dhe më pas, dhjetëra pasagjerë të tjerë, që kishin dalë në hapësirën e madhe të xhamtë, bënë të njëjtën gjë: duartrokitën dëborën që binte, si në ritmet e valseve të Shtrausit...

Pashë orën. Po a fronte koha që të lija sallën e madhe të aeroportit e të shkëputesha nga vallëzimi magjik i dëborës... Me hapa të shpejtë kalova përmes sallës së madhe dhe kur u gjenda nga mesi i saj, qëndrova dhe ktheva kokën pas. Vajza e bukur nga Lindja vazhonte të qëndronte në këmbë e magjepsur nga dëbora. Ndoshta do të qëndrojtë gjatë atje mendova. Ndoshta deri në orët e para pas mesnate, kur të vinte avioni, që do ta çonte atë në vendin e saj me qiej pa re dhe diej përvëlues. Ngrita dorën për ta përshëndetur. Dora më mbeti e ngrirë në ajër, sepse bukuroshja nga Lindja, e përqendruar duke vështruar jashtë, po këndonte në gjuhën e saj të *ëmbël* si të ëndrrës. Ndoshta po i këndonte dëborës.

Ndërsa po bëhesha gati që të zbrisja pas pasagjerëve të tjerë, në ca shkallë hekuri, dëgjova zërin e një zonje, që vinte mes frymëmarrjes së rëndë.

- Zotëri! Zotëri! Të lutem...

Qëndrova. Zëri i saj ishte i butë dhe i *ëmbël* dhe akcenti i gjermanishtes, nuk ia prishte ngrohtësinë apo brishtësinë e të folurit... I zgjata dorën për ta ndihmuar që të zbriste shkallët.

- T'ju ndihmoj zonjë? Jeni për në Tiranë?

- Jo. Jo... Tirana. Nuk shkoj... Tirana, - tha me zërin e butë e akcentin gjerman, përmes frymëmarrjes së rënduar.

E vështrova me vëmendje portretin e saj, lëkurën e lëmuar, tepër të lëmuar, gati-gati si të pasqyrtë, ndërsa sytë e hirtë ruanin ndriçimin e largët të viteve të rinisë.

- Unë quhem Ana. Ana Knut. Jam vjeneze, - heshti pak dhe shtoi: - Nuk shkoj... Si i thoni? Nuk vij... Tirana. Unë jam shumë sëmure. Vite sëmure...

Pa pritje që ta pyesja se ç'kërkonte nga unë, ajo nxori nga çanta një pako të vogël, të mbështjellë me një letër kartoni të trashë ngjyrë gri dhe të lidhur me një fjonjo të kuqe.

- Këtu... adresa, zotëri, - tha. - Ai quhet... Më fal... Po. Po. Ai quhet...

- Ç'të bëj me këtë pako? - pyeta, duke parë orën dhe pasagjerët e fundit që nxitonin të zbrisnin shkallët e më pas të hipnin në avion.

- Ai quhet Amir... Amir... Këtu adresa... Edhe telefoni im, zotëri...

Mora pakon në duar, duke dëgjuar nga pas fjalët e saj të falënderimit në shqip dhe më pas në gjermanisht: "Aufidersen! Aufidersen! Shumë, shumë falënderim! Mirë u pafshim..."

Avioni u nis në orën e caktuar dhe ndërsa ngrihej, unë përpiquesha të vështroja poshtë natën dhe dëborën që binte...

Avioni i vonë i pasmesnatës, po ulej në aeroportin e Rinasit, ndërsa nga megafonët vinte zëri i përgjumur i një vajze, që shpjegonte se pas pak do të uleshim në pistë dhe duhet të qëndronim ulur... Pashë nga xhami i avionit dritat që ndriçonin pistën e aeroportit dhe shiun që binte... Arritëm, thashë me vete. Arritëm më në fund, shtova me një zë që nuk m'u duk si i imi. Nuk është zëri im, thashë prapë me vete, ndërsa vështroja shiun e pasmesnatës, që binte e binte i qetë. Si shiu i Parisit, thashë gati me zë, ndërsa po ngrihesha. Pasagjerët tashmë ishin bërë të zhurmshëm, veçanërisht gratë, që qeshnin e flisnin me zë të lartë.

Nuk nxitova për të zbritur. Përse të nxitoj? Le të zbris në fund nga ky avion i madh, që na kishte sjellë nga Vjena... Në krye, atje ku pasagjerët zbrisnin, qëndronin dy stjuardesa të gjata e të bukura, duke u buzëqeshur të gjithëve dhe duke na uruar me shqipen e çalë, "Natën e mirë!". U thashë edhe unë "Natën e mirë!" dhe i falënderova për mirësjelljen... Prita gjatë për të marrë çantën e madhe... Pastaj hipa në taksì, ku për fat, taksistit më rastisi të ishte tip i heshtur dhe jo nga ata llafazanët, që rëndom i gjen në të gjithë botën. Të vetmet fjalë që dëgjova prej tij ishin: "Zotëri! Do të dalim në unazë e më pas në bulevardin Zogu i Parë. Në Rugën e Durrësit po bëhen punime. Ku do të qëndroni?"

Hapa çantën e vogël, nxora pakon e zonjës nga Vjena dhe i tregova taksistit adresën... "Do t'ju lë para muzeut, zotëri, ose në krye të Rugës së Kavajës. Të kërkoj falje, por nuk futem dot në atë rrugicë. Është diku pranë Kishës Katolike."

E falënderova kur zbrita dhe duke tërhequr me vështrësi çantën e madhe, dola në Rugën e Kavajës. Ndala dhe vështrova Sheshin Skënderbej, të rrethuar me kangjella hekuri, pastaj i hodha një vështrim rrugës, në të cilën lëviznin vetëm pak makina dhe pastruesit e natës. Vazhdonte të binte shi i lehtë dhe në Tiranë ndihej i ftohti i lagësht i pragdhjetorit. Dola në trotuarin e mesit të rrugës, duke parë majtas e djathtas. Pastaj ndala përballë Kishës Katolike, kapërceva rrugën dhe u futa në rrugicën në krah të

saj. Nxora prapë pakon e vogël dhe lexova edhe një herë adresën... Po! Po, thashë me gëzim, kur në krahun e djathtë, nën ndriçimin e zbehtë të neonit, lexova emrin e rrugicës. Me siguri shtëpia është më tutje. Më tutje. Jo shumë larg. Dhe vërtet, më tutje, ishte godina dykatëshe, fasada e të cilës, me suvanë e rënë, dukej jo vetëm shumë e rrënuar, por edhe si e braktisur... U afrova më pranë fasadës dhe me vështrësi lexova numrin e godinës. Jam në vendin e duhur, thashë prapë me gëzim dhe pasi hapa portën e jashtme, u gjenda në një korridor të vogël, përballë ca shkallëve të drunjta, që të drejtonin për në katin e dytë të asaj godine. Lashë çantën e madhe dhe me pakon e vogël në duar, ngjita ngadalë shkallët e drunjta. Qetësi. Vetëm një dritë fare e zbehtë... O Zot, thashë me vete. Si në filmat fantashkencë! Ç'punë kam unë në orën dy pas mesnate, të ngjitem në katin e dytë të kësaj vile, ku nuk banojnë njerëz, por fantazma...

- Zotëri! Zotëri... Këtej ju lutem...

- Më falni, - thashë. - Më falni që ju shqetësoj në këtë orë kaq të vonë, por ishte avioni i fundit...

- Burrat janë në dhomën përballë... - tha zonja që ishte veshur me të zeza.

- Më falni, zonjë, - thashë. - Ju lutem, më falni... Kjo është shtëpia e zotit Amir?

- Po, zotëri. Ju falënderoj që keni ardhur!

- Kam një porosi për zotin Amir... Vij nga Vjena, zonjë, - thashë dhe zgjata pakon që mbaja në dorë.

- Ah... Ah... Ah... - thirri ajo dhe shpërtheu në lot.

- Beti, motra ime... Mbaje veten... Mbaje veten!

Zonja tjetër, që doli papritur nga dhoma, e përqafoi zonjën me emrin Beti, duke iu lutur që të qetësohej.

Zonja Beti më kërkoi të falur, pastaj më falënderoi dhe më pas, me duart që i dridheshin, hoqi fjongon e kuqe që ia dha zonjës tjetër, hapi me kujdes pakon dhe shpërtheu sërish në lot.

Nën ndriçimin e zbehtë të dritës dhe me duart që i dridheshin, zonja Beti nxori nga pakoja e vogël një palë gërsheta, një fotografi bardhë e zi, një kartolinë me pamje nga Vjena, e shkrepur ndoshta në fund të viteve tridhjetë ose në prag të Luftës së Dytë Botërore, si dhe një karafil ngjyrë rozë të tharë... Ndjeva një aromë të veçantë që vinte nga pakoja e hapur. Një aromë dashurie e vjetër vjeneze. Zonja Beti puthi fotografinë dhe gërshetat dhe mori në dorë karafilin e tharë, të cilit i mori erë.

- Më falni, zotëri. Më falni... Ju lutem, t'ju bëjmë një kafe? Jeni edhe i lodhur... Nuk di si t'ju falënderoj për dhuratën amanet që sollët nga Vjena. Sot paradite folën në telefon. Jo, jo. Jo sot. Dje në mëngjes e mori zonja Ana. Flisnin disa herë në ditë në telefon. Amiri i kërkoi që ajo t'i dërgonte me postë gërshetat e rinisë.

E ngushëllova motrën e Amirit dhe duke u larguar, e pyeta se kur e kishin lënë varrimin. Pastaj i thashë që do t'i telefonoja zonjës Ana rreth orës nëntë të mëngjesit për t'i thënë se e kisha kryer porosinë e saj, duke i shpjeguar se mund t'i telefonoja edhe në ato çaste, por ishte shumë vonë, sepse në Vjenë binte borë dhe zonja Ana...

Zbrita ngadalë shkallët e shtëpisë së vjetër, aq ngadalë saqë ndjeva hapjen e derës së dhomës ku ishte i vdekuri dhe hapat e zonjës Beti duke hyrë në të. Me siguri ajo do të vendoste te koka e të vëllait të vdekur ato që më kishte dhënë zonja Ana në aeroportin e Vjenës. Me siguri, thashë kur dola në rrugicën e ndriçuar tek-tuk nga ndonjë dritë e zbehtë. Jashtë vazhdonte të binte shi i qetë, shumë i qetë. Në Vjenë bie borë, thashë me vete, duke tërhequr çantën e madhe nëpër rrugicën me gropa të vogla, ndërsa të tjerë udhëtarë, ndoshta po duartrokasnin, duke parë përtej xhamave dëborën që binte mbi avionët në pistat e aeroportit të Vjenës...

**KAM ARDHUR NË JETË NJË NATË DIMRI**

Të mërdhira nga moti i acartë  
Të lodhura nga rravigimet nëpër errësirë  
Duke shkuar te kryet e të sapolindurve të asaj nate  
Për t'u caktuar se sa vite do të rronin  
Dhe për t'u blatur atë fat që do të kishin  
Parkat po nxitonin për t'u kthyer në banesën e vet

Në udhë e sipër ato morën vesh lajmin e lindjes sime  
Dhe u detyruan të ktheheshin prapa  
Për të mbërritur te djepi ku më kishin lidhur

Kur u përkulën mbi mua që bëja gjumin e parë  
Parkat vunë re se duart e tyre të mërdhira  
Ishin të zbrazëta  
Të zbrazëta ishin edhe trastat që kishin në shpinë

Ato më hodhën një vështrim të akullt  
Më caktuan se sa vite do të rroja  
Pastaj u bënë firë nëpër natë

Ngaqë kisha ardhur në jetë midis maleve me borë  
Atë natë dimri  
Unë do të isha një nga viktimat e pafajshme  
Të Parkave të pezmatuara nga moti i acartë

Unë fjeta pastaj u zgjova dhe qava  
Pa e ditur se ajo natë dimri  
Do të më ndiqte pas sa të isha gjallë...

**NË EKZIL**

Atë mbrëmje dimri me shi  
Unë i lashë para pragut të derës  
Malet e vendlindjes sime  
Të mbuluara me tallaganë prej bore  
Me kokën të mbështjellë me mjegull  
Me krongjij të gjatë akulli  
Që u vareshin nga vetullat e nga mjekrat

Megjithëse e ndjeva veten keq  
Që e shkela ligjin e shenjtë të mikpritjes  
Dhe mund të damkosesha si mosmirënjohës  
Unë nuk i ftova dot të bujtnin  
Në dhomën time të vogël prej të ekziluari  
Nuk u vura dot përpara sipas ritit stërgjyshëror  
Bukë e kripë e zemër

Atë mbrëmje dimri  
Unë i vura re siluetat e tyre të errëta  
Se si përkuleshin mbi xhamat e dritareve  
Dëgjova kollën e tyre të frikshme  
Si rropama e një peme të thyer nga shtrëngata  
Që shungullon në gryka shpella e gremina

Ato male m'u bënë nakël gjithë natën  
Duke u çapitur me dëshpërim  
Nëpër rrafshinat me borë të ëndrrave të mia  
Derisa zbardhi drita

Atëherë malet e vendlindjes sime  
U zhdukën në fund të horizontit  
Duke mbajtur në supe bohçet e reve të hirta...

**BORË PARIZIANE**

E preka butësisht shtresën e borës së re  
Si të qenë flokët e bardhë të një mikeje të hershme

I fola për gëzimet që ajo më kishte falur në fëmijëri  
Kur kishim lozur bashkë në malet e vendlindjes sime  
Duke besuar se ishim miqtë më të mirë në botë

Ajo nuk më njohu  
Ajo më tha se nuk kishte asnjë idé  
Se ku ndodhej vendlindja ime

Për t'i ardhur në ndihmë kujtesës së saj  
I përmenda fjalët e një poeti



## DASHAKEQËSIA E PARKAVE

Poezi nga Anton Pappleka

I cili kishte thënë se në malet e vendlindjes sime  
Bora kishte një bukuri që vret

Ajo m'u përgjig se nuk kishte dëgjuar kurrë  
Të flitej për male  
Ku bora kishte një bukuri që vret

Ajo i ishte një borë pariziane

Bora që takova atë ditë dimri  
Qeshte si një vashë e veshur me fustan nusërie

Diadema e saj e argjendtë  
Shkëlqente në floknajën e Parisit  
Që shpupurishej në qiell...

**MË VJEN KEQ PËR PANTERËN E BORËS**

Më vjen keq për panterën e borës  
Që ka një gëzof të bardhë në të hirtë  
Të laryshitur me pulla të zeza  
Një mrekuull e kamuflimit  
Që e ndihmon të jetojë në mjedisin jomikpritës  
Të pllajave të Himalajës  
Të mbuluara me shkëmbinj pluhur dhe borë  
Të fshikulluara nga erërat e akullta

Më vjen keq për panterën e borës  
Që ka gjymtyrë me një zhdërvjelltësi të pashoqe  
Sy me një mprehtësi që sfidon edhe natën  
Një bisht tufshak e të fuqishëm  
Dhëmbë që e mbërthejnë si kanxa prenë :  
Armë të domosdoshme mbijetese  
Të përosura përmes seleksionimit natyror  
Falë të cilit mbretëria e krijesave të gjalla  
Është shtirë deri në kufirin e të mundshmes

Më vjen keq për panterën e borës  
Që banon në planetin me emrin Tokë  
Bashkë me vertebrorin e quajtur Njeri  
Në një kohë që ca individë të këtij lloji  
Të pushtuar nga marrëzia e idesë për të vrarë  
Mund të mbështetin bulën e gishtit  
Mbi butonin e bombës atomike

Po të ndodhte kjo gjë me të vërtetë  
Siç na shtyjnë të mendojmë  
Kërcënimet e superfuqive të ndërkyera  
Gjithçka që rron në planetin tonë do të shfarosej

Dhe mbeturinat e planetit vetë  
Do t'i ngjanin lëkurës së rjepur të panterës së borës  
Një masë e bardhë në të hirtë  
E laryshitur me njolla të mëdha e të zeza

Pas një veprimi të tillë vetëvrasës e të pakthyesëm  
Pantera e borës nuk do të ekzistonte askund  
Gjithashtu as lloji i Njeriut...

**REFREN SHEKSPIRIAN**

Kur e shtrëngova në kraharor  
Dhe e putha për herë të parë  
Buzët e saj të drithëruara murmuritën :  
-Sa kohë do të më duash ?  
Unë iu përgjigja me një frazë të huazuar nga Shekspiri :  
-Sa përjetësia dhe një ditë.

Vitet që ikën  
Panë ciklone përmbytje tërmete shpërthime vullkane  
Panë shkrirjen e akullnajave gërryerjen e shkëmbinjve bregdetarë  
zhdukjen e disa llojeve  
Panë shembjen e miteve të doktrinave të shtatoreve të shteteve  
Panë ëndrra dhe iluzione të katandisura në gërmadha  
Panë ngjyrën e flokëve tanë të shndërruar në bardhësi bore  
Përballë kësaj mynxyre të kohës buzët e saj të drithëruara murmuritën :  
-Sa kohë do të më duash ?  
Unë iu përgjigja me frazën e huazuar nga Shekspiri :  
-Sa përjetësia dhe një ditë.

Si të gjithë vdekatarët që marrin udhën për në Bujtinën e Fundit  
Unë sosa atje dhe u shtriva në një dyshek toke  
Mbështeta kokën te nënkresa e gurtë e balladave të vendlindjes  
Fjeta nën batanijen prej bari të blertë dhe prej luleshqerrash  
Pashë në ëndërr siluetën e saj të përkulur mbi gurin e varrit tim  
Dhe buzët e saj të drithëruara murmuritën :  
-Sa kohë do të më duash ?  
Nga ëndrra ime unë iu përgjigja me frazën e huazuar nga Shekspiri :  
-Sa përjetësia dhe një ditë.

Gjatë shtegtit të tyre  
Shpirtrat tanë të etertë u endën në tokë  
Të dëshiruar për njëri-tjetrin në kërkim të njëri-tjetrit  
Ata u rimishëruan në lule në pemë në zogj dhe në krijesa të tjera  
Ata fluturuan drejt qiellit të paanë  
Ata udhëtuan përbri hënave kometave meteorëve  
Përbri yjeve të sapovdekur a të sapolindur  
Ata u takuan dhe u përqaftuan diku në gjithësi  
Ku buzët e drithëruara të shpirtit të saj të etertë murmuritën :  
-Sa kohë do të më duash ?  
Shpirti im i etertë iu përgjig me frazën e huazuar nga Shekspiri :  
-Sa përjetësia dhe një ditë...

**TË NGIHESH ME JETË**

Unë nuk jam nginjur ende me jetë  
Ka shkruar në një poemë të tij Nazim Hikmeti

Po kush është nginjur ndonjëherë me jetë  
Dhe ka qenë gati të ikë nga kjo botë me dëshirë e tij ?

Besoj se edhe ata që kanë vrarë veten  
Nuk kanë vendosur të ikin nga kjo botë  
Ngaqë qenë nginjur plotësisht me jetë

Më shumë jam i prirur të besoj  
Se ata e kanë marrë atë vendim të dëshpëruar  
Për t'i dhënë fund një torture të padurueshme  
Siç ishte katandisur ekzistenca e tyre :  
Të rronin pa mundur të ngjeshin me jetë

Një argument shtesë  
Që tregon se askush nuk është nginjur me jetë  
Është besimi se disa të vdekur  
Kthehen në tokë në trajtë lugetërish  
Ose kthehen në ëndrrat që shohim natën  
Duke u orvatur ta zgjatin sadopak  
Jetën e tyre që u është dukur e shkurtër

Unë jam i bindur se një zgjidhje  
Për t'u nginjur me jetë  
Është mësimi i filozofit Georges Poulet  
Për ta krijuar kohën e jetës sonë  
Me çastet që kemi në dorë...

### PËRSIATJE NË SHTRATIN E SPITALIT

I shtrirë në shtratin e spitalit  
Fusha e orës sate i ngjan fushëbetesës rreth Trojës  
Në cep të së cilës rri gati për sulm  
Akili mizor  
Hipur në kalin azgan

Ai vringëllon në duar armët vrastare

Goditja e heshtës së tij mund të të rrëzojë nga kali  
Shpata e tij mund të të ngulet në kraharor  
Por ti nuk mund të ikësh tutje  
Për të shpëtuar kokën

I pushtuar nga dyshimet  
Për fatin e dyluftimit me vdekjen  
Ti e di se as shqetësimi i Andromakës  
As dashuria birnore e Astianaksit  
As mburoja e farkuar nga hyjnorit Hefest  
Nuk të shpëtojnë dot nga koha që rrjedh  
Drejt çastit fatal

Në këto çaste ankthi dhe pritjeje  
Ti e kupton se fati i dyluftimit që të pret  
Nuk varet vetëm nga armët që përplasen  
Dhe nga duart e kundërshtarëve që ndeshen

Ti mendon për atë forcë të mistershme  
Që vë në lëvizje gjithçka  
Pastaj përpiqesh ta harrosh atë  
Duke vazhduar t'ia ngulësh sytë horizontit  
Ku nuk duket ende  
Silueta e zezë e Akilit mizor  
Me vetëtimën verbuese së shpatës së tij të zhveshur...

### DERA E HEKURT E FATIT

Dera e hekurt e fatit tim  
Është bërë gunga-gunga  
Nga goditjet e grushteve të mia

Prapëseprapë ajo qëndron e mbyllur  
Para duarve të mia të gjakosura  
Para syve të mi të mbushur me zemërim

Sipas orakullit të Delfit  
Dera e hekurt e fatit im  
Nuk do ta hapet ndonjëherë

Duart e mia të dërmishura të gjymtuara  
Të mbuluara me vraja plagësh  
Do të katandisen në cungje

Pavarësisht nga fjalët e orakullit  
Unë do të qëndroj para derës së hekurt të fatit tim  
Do ta godas me grushte derisa të jem gjallë  
Duke pritur të hapet...



Një mëngjes u zgjova dhe pashë se isha krejtësisht i vetmuar. Askush nuk ishte në shtëpi, asnjë zhurmë. Rrëmuja ishte po ajo e një nate më parë. Rroba e sende të hedhura kuturru. Ora e murit kishte ngecur dhe nuk dëgjohej tik-tak-u. Dola në rrugë, e njëjta zbrazëti. Nuk kishte njerëz, as makina. Kafenetë ishin të mbyllura, dyqanet e rrobave dhe ushqimoret kishin ulur qepenat. Mbyllur ishin edhe furrat e bukës, farmacitë, parukeritë. Në një kënd të vogël lojrash për fëmijë, një lisharëse kishte mbetur varur vetëm në njërin anë, ndërsa pak metra më tutje kishte mbetur një top gjysmë i shfryrë. Edhe gjethet e zverdhura që ishin shkëputur prej degëve nuk binin në tokë, por rrinin pezull. Dukej sikur edhe ajri kishte ngrirë. Nuk kishte as qen, nga ata që kërkojnë zakonisht për ushqim nëpër kazanët e mbeturinave. Një ndjesi e frikshme me kaploi trurin dhe trupi nisi të më dridhej. Çfarë drejtin ka ndodhur në këtë qytet? Ku janë njerëzit? Po qentë e rrugës, ku janë?

Keni menduar ndonjëherë si mund të ndjehesh nëse mbetesh i vetëm në një qytet? Një herë isha menduar gjatë të përfytyroja zhdukjen e një qyteti në mënyrë natyrale, dmth zhbërjen e tij. Sa kohë mund të rezistojnë ndërtesat, rrugët, urrat? Si mund të shemben ato nga erozioni natyror? Si mund të mbijë sërish bari dhe pemët mbi rrugët e shtruara me asfalt dhe beton? Si mund të dukej, psh, që në hyrje të Operas të mbinin ferra dhe shkurre të tjera? Pra, si mundet natyra ta rifitojë atë që i ka marrë njeriu?

Ndjesia e frikës dhe ankthit m'u shtua. Fryma m'u zu e zemra nisi të më rrihte më ngadalë.

Keni vdekur ndonjëherë nga asfiksia? Po atë ndjesinë kur doni të merrni frymë, por ajër nuk ka, e keni përjetuar ndonjëherë? Megjithatë, unë shpëtova nga kjo ndjesi. Më një fjalë, nuk vdiqa. Zemra filloi të më rrihte sërish dhe nisa t'u bie rrugëve pash më pash. Ashtu, i vetëm, si drej. Frikës ia zuri vendin një lloj kënaqësie që vinte nga fakti se i tërë qyteti tashmë ishte i imi. Mund të ecja ku të doja, të hyja ku të doja, me pak fjalë mund të bëj ato që më herët as e kisha menduar se mund ti bëja.

- Po ti, çfarë bën ende këtu, o idiot?  
Dikush foli me një zë të fortë e kumbues. Por askënd nuk pashë me sy.

- Kush je ti? Ku je? - bërtita unë tërë ngazëllim, që më në fund dëgjova një zë njeriu.

- Lëre kush jam unë, por nxito në stacion dhe kap trenin e fundit që po ikën.

- Çfarë stacioni thua? Ne s'kemi stacion. Nuk kemi as tren.  
- E di që s'kemi tren, por shko në stacion, të thashë! - u dëgjua sërish zëri me ton urdhërues.

Nxitova për tek ai që dikur ka qenë stacioni. Atje ishte vërtet një tren. Nuk di nëse ecte mbi shina, mbi rrota si makinat apo fluturonte me krahë, por atje kishte shumë njerëz që shtyeshin për të hipur.

Po, po, fiks si në vitet '90, kur hynim nga dera, nga dritarja dhe, kur nuk kishte më vende brenda, ngjiteshim mbi çatinë e vagonëve. Pashë aty Kujtimin, mjekun fëmijëve të lagjes sonë. Pa shih, edhe Vasilika, infermierja, po dhe Moza, pastruesja. Edhe Besi, inxhinieri që punon te kompania ku punoj dhe unë. Ja, edhe Qamili, varrmihësi, edhe ai po shtyhej.

- Qamil, po ti?! Ku po shkon?  
- Po ç'të bëj, kush do të vdesë këtu që të punoj unë?

Nxitoj të gjej një vend, por s'gjej dot. Dhe lumturohem kur shikoj që s'kam ku të hipi.

Pa prit? Vërtet ai është? Mu aty ku lidhen vagonët, shtrirë mbi çengelët e mëdhenj, shikoj Çarlin. Po, po, ai qenka! Çarli, qeni im. As ai nuk ishte në shtëpi, kur u zgjova unë.

- Po ti, more qen bir qeni, ku shkon? Po ti tërë jetën s'ke kapur punë me gojë. Po ku do të gjesh vend më të mirë ti, more? Zbrit shpejt, tani!

Qeni u struk edhe më shumë mes hekurave e më shikonte me një ndjesi faji, por nuk zbriti. Treni u zhvendos nga vendi me një kërcëllimë hekurash, sikur lëvizti planeti prej boshtit të tij.

Zëri kumbues bërtiti sërish:  
- Hej ti, idiot, do të vish apo jo?  
Unë s'e mbaj mend nëse thashë "po", "jo" apo diçka midis

pohimit a mohimit. Thjesht pashë që treni u zhduk dhe unë mbeta te platforma prej betoni. Doja të ecja, por nuk mundja. Trupi s'më bindej. Duart më dridheshin, gjunjët m'u prenë dhe u shemba përtokë.

Se sa ndjenja ashtu, s'e di. Me orë apo me ditë, ndoshta. U ngrita duke u zvarritur dhe duke belbëzuar: "Nuk iki, jo! Jo, jo, nuk ikiii..."

Nisa të ecja sërish rrugëve të zbrazura, as i lumtur e as i frikësuar. Thjesht ecja në hijë. Te sheshi i kryesor pashë një turmë të madhe që nuk ekzistonte. Zbrazëti e kishte mbushur sheshin cep më cep. Një podium ishte ngritur në mes dhe unë, pa u menduar gjatë, mblodha forcat, urdhërova gjunjët dhe u nisa drejt tij. Madje shkallët i ngjita në mënyrë sportive, energjik, si presidentët amerikanë. I keni parasysht ata kur nxitojnë, ngjiten në podiumet elektorale dhe drejtojnë gishtin nga njerëzit?

Kërkova fjalimin në xhep, por nuk e gjeta. Pastaj u kujtova se nuk kisha një të tillë, ngaqë nuk e dija se do të mbaja fjalim.

Por fola pa letër:

- Të dashur bashkëqytetarë! Ju që jeni këtu, ikët nga shtëpitë tuaja dhe nga vendi juaj. Ikët sepse këtu nuk ka shpresë. Sepse shpresën na e kanë marrë ata që, prej 30 e ca vjetësh, kanë në dorë politikën dhe ekonominë. Ata që kanë shitur tokën, nëntokën, detin, ajrin, malet, lumenjtë, pyjet, minierat... Ata na vjedhin dhe me paratë që na vjedhin, na blejnë votat. Po ne, çfarë bëjmë? Ne ikëm dhe mallkuam tokën tonë.

Turma shpërtheu në brohoritje, deri kur dikush u ngrit e foli:

- Po ti, cili je? Kush të paguan ty? Kush fshihet pas teje? Edhe ti një këlysh i atyre je. Të gjithë njësoj jeni!

- I shitur! - bërtiti njëri.  
- Tradhtar! - bërtiti një tjetër.  
- Antishqiptar, - tha dikush.

Pastaj pashë sesi drejt meje po vinte një send që zmadhohej si asteroid, duke iu afruar kokës sime.

U shemba përtokë.

Kur u përmenda, nuk ishin aty as podiumi, as turma boshe, as sheshi.

S'di se pas sa kohësh, por u ktheva sërish në shtëpi duke u zvarritur. Nuk kisha asnjë arsye të ngrihesha në këmbë që të ecja më shpejt.

"Në rregull", thashë me vete, "do të rri tani këtu në verandën time plot pluhur, do të ulem në karrigen lëkundëse dhe do të pres derisa të dalë nga shtëpia Kovi. Ai këtu do të jetë patjetër. Do ta shikoj kur të ecë me qenin e tij të zgjebosur, duke tërhequr këmbët zvarrë të dy, derisa të shembet përtokë. Askush nuk do të jetë aty ta ndihmojë, dhe kështu do të japë shpirt. Do të shikoj edhe Lolën, atë plakën që nuk linte njeri pa i treguar, tërë fodullëk, se çfarë i sillnin tre djemtë që ka në Gjermani. Tani ajo mezi ecën dhe, me duart që i dridhen, as telefonin nuk mban dot për të folur me djemtë që e telefonojnë rregullisht, dy herë në vit. Jam kureshtar të di se kush do ta varrosë!

Edhe unë do të vdes, po ndërkaq e kam vendosur. Veten time do ta varros vetë. Madje do të mbaj edhe një fjalim, të cilin kam nisur ta shkruaj që tani. Nuk ka shumë gjëra për të futur në fjalim, pasi unë nuk kam dhënë ndonjë kontribut të madh për qytetin. Do të jetë diccka protokollare, por do ta theksoj faktin se unë nuk ika nga qyteti sepse doja të shikoja se si mund të ishte një qytet pa njerëz. Madje nëse do të mund të jetoja gjatë, do të prisja të shikoja edhe sesi do të zhbëhet një qytet. Por kjo nuk ishte në dorën time. Pastaj do t'i shkoj vetes sime edhe për vizitë, sipas zakonit. Dhe, kur të ulem atje te dhoma e pritjes, do të bëj atë pyetjen idiote që e bëjnë të gjithë, njëri pas tjetrit: "Na la, ë? Po kur ndodhi?"

Vërtet, kur ndodhi? Kur vdiqëm? Çfarë të shkruaj te pllaka e varrit? Kur linda dhe kur vdiqa? Profesor S., duke analizuar përbërësit e naftës dhe mbetjet njerëzore, këmbëngul se unë, por edhe Kovi, Lola dhe të tjerë, jemi pellazgë. Pra, i bie të kemi lindur rreth 12 mijë vjet më parë. Po për të vdekur, kur? Nuk ka një datë. Sepse unë nuk vdiqa përnjëherë. Vdiqa pak e nga pak, vit pas viti, pa e ndjerë. Unë isha i fundit. Para meje ishin Lola e para saj Kovi me qenin ngordhalaq.

Të tjerët ikën.

Është një ëndërr që s'rrëshet së kthyeri mes intervallesh pothuaj të rregullta; është terr dhe po më vrasin në një si gëmushë a shkurnajë; një rrugë ndoca disa metra më tej gumëzhin; ulërij për ndihmë por askush s'më dëgjon, turma kalon pranë duke u gajatur e fjalosur.

E di që shumë njerëzve, sipas luhatjeve individuale, u fanepset e njejtë ëndërr. Jam grindur me analistë për këtë dhe besoj se ajo do të jetë një arketip në kuptimin Jungian të fjalës; shprehje e vetmisë së skajshme të individit kur përballet me vdekjen dhe dhunën kozmike, pamundësia e për ta komunikuar tmerrin e pashembullt të përjetimit të vet. Për më tepër, unë besoj se ajo është në rrënjë të dështimit të propagandës së krimeve të luftës.

Sepse, tek e fundit, jeni ju ajo turma që kalon pranë duke u gajatur në rrugë; dhe ka ca nga ne, viktimat që shpëtuam a dëshmitarët që pamë me sy gjëra që u kryen pas shkurnajës, e që të përndjekur prej kujtimeve, vijojmë të gërthasim në radio, duke ju ulëritur nëpër gazeta dhe takime publike, teatro dhe kinema. Aty këtu edhe ia dalim t'ju rrokim veshin, si për ndonja një minutë. E di këtë sa herë që ndodh, përmes një lloj shushatjeje marroke mbi fytyra, përmes një shkrepëtitë që mekur e të shtangët në sy; dhe them me vete: Ja tek të dolën në shteg, mbaji aty tani, shtrëngoji fort që të rrinë sy-hapët; mirëpo kjo nuk zgjat përveçse një minutë. Një të shkundur i bëni vetes si ata këlyshët kur iu lagen leshrat e pastaj perdja e tejdukshme bie sërish dhe ju vijoni ecjen, mbrojtur pas zhguall-ëndrrës që mbytet çdo zë.

NE, ulëritësit, i kemi rënë këtij avazi prej gati dhjetë vjetësh. Ia nisëm asaj nate kur epileptiku Van der Lubbe i vuri zjarrin Parlamentit Gjerman<sup>1</sup>; ju thamë se po të mos i shuan ato flakë sakaq, kanë për t'u përhapur në krejt botën; ju pandehët se ne ishim maniakë. Në këtë çast mania jonë është të bëjmë çmos t'ju rrefejmë për vrasjet me avuj përvëlues, elektroskok masiv dhe varrosje për së gjalli të krejt popullatës hebreje të Europës. Deri tani, tre milionë kanë vdekur. Është vrasja më e madhe në masë e dokumentuar në histori; dhe vijon për ditë e çdo orë, po aq rregullisht sa edhe tik-taku i sahatit tuaj.

Mbi tryezën e punës ku po shkruaj, përballë kam fotografi, shkak i emocionit dhe zemërimit që ndiej. Njerëz u vranë duke u përpjekur që t'i nxirrnin jashtë Polonjë; mendonin se ia vlente. Janë fakte këto të botuara në pamflete, buletine zyrtarë, gazeta, revista, e ku di ç'tjetër. Një ditë takova një nga gazetarët më të njohur amerikanë këtej. Më tregoi se në një nga anketimet e fundit të opinionit publik, të pyetur nëse besonin që nazistët kryenin akte mizore, nëntë ndër dhjetë qytetarë amerikanë çfarëdo ishin përgjigjur se të gjitha ishin rrena propagande, dhe se nuk besonin as edhe një fjalë të tillë.

Sa i përket këtij vendi, u bënë tre vjet tashmë që u ligjëroj ushtarëve, dhe po i njejtë qëndrim është. S'besojnë se ka kampe përqendrimi, s'besojnë se ka fëmijë të vdekur urie në Greqi, se ka pengje të pushkatuara në Francë, se ka varre masive në Poloni; s'kanë dëgjuar asnjëherë për Lidice-n, Treblinkën ose Belzek-un; ja ua mbush mendjen për një orë, por pastaj ata i japin vetes një të shkundur. Vetë-mbrojtja mendore ia nis punës dhe brenda një jave rrudhja e supeve prej mosbesimit ia beh sërish, si të ishte refleksi përkohësisht i dobësuar prej ndonjë goditjeje.

1 Marinus van der Lubbe ishte një komunist holandez i ekzekutuar prej qeverisë naziste gjermane ngaqë besohej, se në kuadrin e një konspiracioni politik, i kish vënë flakën ndërtesës së parlamentit gjerman më 27 shkurt 1933. Sipas disa historianëve ai e kreu aktin në mënyrë të pavarur. 75 vite më vonë qeveria gjermane i ofroi faljen pas vdekjes. [Shënim i Përkthyeses]

# Arthur Koestler

## MAKTHI QË ËSHTË REALITET

*The New York Times* (9 janar 1944)  
Përktheu nga origjinali: Atena Bishka

QARTAZI që, për mua dhe këdo si unë, e gjitha kjo po u shndërrohej në mani. Qartazi, pas gjase në vuakemi prej ndonjë obsesioni morbid, ndërsa të tjerët na qenkeshin të shëndetshëm dhe normalë. Mirëpo simptoma karakteristike e maniakëve është se këta e humbasin kontaktin me realitetin dhe jetojnë në botë fantazie. Prandaj, ndoshta, është krejt e kundërta: ndoshta jemi ne, ulëritësit, ata që reagojmë në mënyrë të shëndetshme ndaj realitetit që na rrethon, kurse neurotikët që vërtiten në një botë të kamufluar fantazie, jeni ju, ngase ju mungon aftësia për t'u përballur me faktet. Po të mos ishte ashtu, kjo luftë do të ishte shmangur, dhe ata, që u therën faqe jush tekta ju shihnit ëndra syhapur, do të ishin ende gjallë. Unë thashë "ndoshta," sepse çka u tha më sipër natyrisht që s'është veçse gjysma e së vërtetës.

Ka patur në të gjitha kohërat ulëritës – profetë, predikues, mësonjës dhe sharlatanë – që mallkonin mefshtësinë e bashkëkohësve të tyre, edhe trajta e kësaj situatë më së shumti mbetet po ajo.

Gjithnjë ka ulëritës që ulërijnë prej kaçubes dhe njerëz që shkojnë rrugës shpërfillës. Ata kanë veshë por nuk dëgjojnë, kanë sy por nuk shohin. Prandaj rrënjët e kësaj pune duhet të shtrihen më thellë, shkojnë përtej veç mefshtësisë.

A mos ndoshta faji është i ulëritësve? Ndonjëherë, pa dyshim që po, mirëpo unë s'e besoj se është ky thelbi i çështjes. Amos, Hosea, Jeremia ishin propagandistë fort të zotët, e prapëseprapë s'ia dolën dot që t'i shkundnin popujt e tyre e t'i paralajmëronin. Thuhet se zëri i Kasandres çau muret, e megjithatë lufta e Trojës ndodhi. Tek e mbramja – përpjestimisht – unë besoj se në tërësi M.O.I [Ministria e Informacionit – shënim i A.B.] dhe B.B.C janë krejt të afta në punën që bëjnë. E mbajtën këtë vend, por pothuaj tre vjet, me kurrëgjë tjetër përveçse disfatave, edhe ia dolën paq.

Mirëpo në të njejtën kohë, mjerisht nuk arritën të përcillnin tek njerëzit diçka që t'i përafrohej një ndërgjegjësimi të plotë se çfarë që e gjitha kjo, për hatanë dhe lemerinë e kohës ku kishin lindur.

Ata vazhduan udhën, si të mos kishte ndodhur asgjë, me të vetmin ndryshim që rutina e punës përfshinte: vriti e vritu. Pragmatika e çveshur prej imagjinatës është kthyer në një lloj miti anglo-sakson; zakonisht kundërshtuar deri në histori dhe lëvdur si vlerë sipërore në emergjencë. Mirëpo, miti s'thotë as se çfarë ndodh midis emergjencave dhe as se dështimi i shmangies së rishfaqjes së të tyre bie po mbi këtë vlerë. Tani, jo se kjo pamjaftueshmëri ndërgjegjësimi është doemos privilegj anglo-sakson, paçka se këta janë mbase e vetmja racë që e merr si vlerë atë që të tjerët e vështrojnë si të metë. Nuk është as çështje temperamenti; stoikët kanë horizonte më të gjera sesa fanatikët.

Është fakt psikologjik, i pandashëm prej kornizës tonë mendore, i cili besoj se nuk ka marrë vemendje të mjaftueshme prej psikologjisë sociale dhe teorisë politike.

NE themi, "Unë e besoj këtë," ose, "Unë nuk e besoj atë," "E di këtë," ose "Nuk e di atë," duke i konsideruar këto si të ishin alternativa bardh-e-zi. Tani, në realitet, "të diturit" dhe "të besuarit," kanë shkallë të ndryshme thellësie. Unë e di se dikur na ishte një burrë që quhej Spartak, i cili udhëhoqi skllëverit në revoltë; mirëpo besimi im në ekzistencën e tij të dikurshme është shumë më i zbehtë sesa, të themi, ai për Leninin. Unë besoj se ka galaktika spirale, mund t'i shoh me teleskop dhe t'ua shpreh largësinë në shifra; mirëpo, për mua, ato gjenden në një shkallë më të ulët realiteti sesa shishja e bojës mbi tryezë.

Distanca në hapësirë dhe kohë e fashit intensitetin e ndërgjegjësimit. Po kështu edhe shkalla e madhësisë. Shtatëmbëdhjetë është një numër të cilin e njoh intimisht, si të ishte një mik; pesëdhjetë miliardë s'janë veçse një tingull. Një qen që shtypet prej një makine na trondit ekuilibrin emocional dhe atë të aparatit tretës; tre milionë hebrenj të vrarë në Poloni na shkaktajnë veçse një paretat dosido. Statistikat nuk pikojnë gjak; janë detajet ato që kanë peshë. Nuk mundemi ta rrokim krejt procesin me ndërgjegjësim; mundemi të fokusohemi veçse në llokma të vogla të realitetit. Deri këtu e gjitha kjo është çështje shkallësh; ose përshkallëzimi të intensitetit të të diturit dhe të të besuarit. Por kur e kapërcejmë qerthullin e të fundmes dhe përballeme me fjalë, sikurse përjetësia në kohë, pafundësia në hapësirë, domethënë, kur i qasemi sferës së Absolutes, reagimi ynë rresht së qeni çështje shkallësh dhe shndërrohet në një tjetër karakteristikë. Faqe Absolutes, të kuptuarit shkërmoqet, dhe "të diturit" dhe "të besuarit" katandisen krejtësisht në fjalë të zbrazëta.

VDEKJA, për shembull, i përket kategorisë së Absolutes dhe besimi te ajo s'është veçse besim i zbrazët. "Unë e di" se, statistikisht me një moshë mesatare rreth të 65-ve, në mënyrë të arsyeshme pres të jetoj jo më shumë se edhe 27 vjet. Por, nëse do ta dija se do të vdisja patjetër më 30 nëntor 1970, në orën 5 të mëngjesit, do të më helmonte një gjë e tillë, numëro e rinumëro ditët dhe orët e mbetura, duke u ngrënë me veten për çdo minutë të shpërdoruar. Me fjalë të tjera, do të më zhvillohej ndonjë neurozë. Kjo s'ka të bëjë aspak me shpresat për të jetuar më gjatë sesa mesatarja; edhe sikur ta fiksonim datën dhjetë vjet më vonë, procesi i formimit të neurozës do të mbetej i njejtë.

Kështu, të gjithë jetojmë në një gjendje ndërgjegjeje të dyzuar. Ka një rrafsh tragjik dhe një rrafsh trivial, që përmbajnë dy lloje dijesh të përjetuara e reciprokisht të papajtueshme. Suaza dhe gjuha e tyre janë po aq të ndryshme sa latinishtja e kishës



prej zhargonit të biznesit.

KËTO kufizime të ndërgjegjësimit tregojnë për mangësitë e fthillimit të mendjes me anë të propagandës. Njerëzit shkojnë në kinema, shohin filma me tortura Naziste, vrasje në masë, komplete të nëndheshme dhe vetë-flijim. Psherëtim, tundin kryet, ca shkrehen edhe në vaj. Mirëpo s'e bëjnë dot lidhjen me realitetet që shtrihen në rrafshin e tyre normal të ekzistencës. Këtu kemi të bëjmë me Romancë, Art, Ato Gjërat e Epërme, Latinishten e Kishës. Nuk puqin këto gjëra me realitetin. Ne jetojmë në një shoqëri të trajtës *Jekyll dhe Hyde*<sup>2</sup>, veçse ama të zmadhuar në përpjestime gjigante.

Gjithësesi, nuk ka qenë gjithnjë kështu e në të njejtën shtrirje. Ka patur periudha dhe lëvizje në histori – në Athinë, në Rilindjen e hershme, gjatë viteve të para të Revolucionit Rus – kur, së paku, aksh shtresash përfaqësuese të shoqërisë patën arritur një nivel relativisht të lartë të integritetit mendor; kohë, kur njerëzit mbase fërkonin sytë dhe kësosoj bëheshin esëll, kur ndërgjegjësimit i tyre kozmik sikur vinte duke u zgjeruar, kur ata ishin “bashkëkohës” në një kuptim shumë më të gjerë dhe të plotë; kur rrafshet triviale dhe kozmike sikur mbërrinin në një pikë ku puqeshin e bëheshin njësh.

POR kishte edhe periudha shpërbërjeje dhe shkëputjeje. Mirëpo kurrë më parë, as edhe gjatë kalbëzimit spektakular të Romës dhe Bizantit, nuk ishte dyzimi i të menduarit kaq kthjelltësisht i dallueshëm sa sëmundja e uniformitetit masiv; asnjëherë nuk arriti psikologjia humane të arrijë një lartësi të tillë shtinjakërie. Ndërgjegjësimit ynë duket se rrudhet në përpjestim të drejtë me mjetet e komunikimit që vijnë duke u fuqizuar; bota na shpalohe si kurrë më parë, dhe ne endemi si të burgosur, secili në kafazin e vet privat portativ. E ndërkaq sahati vijon të trokasë tik-tak. Vallë ç'mund të bëjnë tjetër ulëritësit përveçse të vijojnë të ulërasin, derisa të bëhen mavi në fytyrë?

Njoh dikë që i binte qark këtij vendi duke marrë fjalën në takime, mesatarisht dhjetë në javë. Ai është një botues i njohur në Londër. Përpara çdo takimi kyçej në një dhomë, mbyllte sytë, dhe përfytyronte në detaje, për njëzet minuta, sikur ishte në Poloni njëri prej atyre njerëzve që i vrisnin. Një ditë rrekej të përjetonte se si do të ndihej po të mbytej me gaz kloridi në trenin e vdekjes; një ditë tjetër duhej të gërmonte varrin e vet tok me dyqind të tjerë tek përballej më pas me mitralozin, i cili, tek shenjon është, natyrisht, i pasaktë dhe tekanjoz. Dhe pastaj i afrohej podiumit dhe zinte të fliste. Vazhdoi ashtu për një vit të tërë derisa u shemb përdhe prej një krize nervore. E zotëronte shumë mirë audiencën dhe ndoshta arriti të bënte diçka të mirë; ndoshta i solli të dy rrafshet të ndarë prej kilometrash një centimetër më pranë njeri-tjetrit.

Unë mendoj se ky shembull duhet imituar. Dy minuta në ditë me një ushtrim të tillë, me sytë mbyllur pas leximit të gazetës së mëngjesit, na janë më të nevojshme sot sesa spërdredhjet fizike dhe frymëmarrja në stlin Yogi. Mbase mund ta shkëmbesh një gjë të tillë me të vajturin në kishë. Sepse për sa kohë që ka njerëz në rrugë dhe viktime pas shkurrraje, të ndarë nga zhguaj ëndre, i yni do të mbetet një civilizim kallp.

2 2 Shënim: Dr. Jekyll dhe Z. Hyde janë karaktere në novelën “Rasti i Çuditshëm i Dr. Jekyll dhe Z. Hyde” (1886) të shkrimtarit Robert Louis Stevenson. Dr. Jekyll krijon një serum që ta ndihmonte të mbante nën kontroll anën e errët të karakterit të tij. Mirëpo, përkundrazi, përfundon i transformuar në Z. Hyde, që s'është veçse mishërimi i pjesës më të errët të personalitetit të Dr. Jekyll. [Shënim i Përkthyesit]

## SHOQPËRUESI

(Kushtuar Prof. Pashko Gjeçit)  
tregim nga Uran Butka



Shqipëruesi kishte zbritur në rrethin e Snëntë të Ferrit të Dantes dhe e ndiente veten të magjepsur e të lodhur. Rruga nëpër Ferr kishte qenë e mundimshme. Ferri shqiptar është më i tmerrshëm se ai i Dantes, tha me vete. Ai kishte qenë i burgosur në Vloçisht dhe e kishte provuar vetë se ç'ishte ferri i vërtetë. Kur e mendonte, çuditej sesi kishte mbetur gjallë. Iu fanit Tasi Marko, komandanti i kampit të përqendrimit të Maliqit. Në Ferrin e Dantes, nuk ka ndonjë shëmbëlltëri si Tasi, tha me vete. E largoi mendjen me përbuzje nga Tasi, që brente kokat e të burgosurve dhe u përqëndrua te kont Ugolini, i cili brente kokën e arkipesk Ruzherit...

“E ngriti gojën nga ushqim’ i vështirë”, shqipëroi vargun e parë të tercines. “E ngriti”... jo, s'është fjala e duhur, tha me vete. “E largoi”... jo, as kjo. Duhet një verb më i figurshëm.

- Profesor, e ke parasysh Dritën? - ia ndërpreu papritur arsytimin Drini, shoku i dhomës.

Tjetri ngriti paksa supet.

- Atë mësuesen bionde, nga Kruja...

- Po, - iu përgjigj pavëmendshëm përkthyesi.

Drini u ndje mirë që u fut në bisedë. Ishte e vështirë të hyje në botën e profesorit të vjetër, aq më tepër kur ai punonte. Shkëputej nga çdo gjë tjetër dhe përthithej i tëri në përkthim. Kur e kishte pyetur një herë se ç'ishte gjithë ai përqendrim i pandërprerë, ajo vetmi dhe e folur me vete: mani apo marrëzi, profesori i ishte përgjigjur: *Dashuri!* Drini ishte habitur, po s'e kishte shtyrë më tej, sepse profesori ishte mbyllur sërish në guaskën e vet.

Atë mbrëmje Drini e kishte të nevojshme të bisedonte pikërisht për këtë ndjenjë dhe të çlirohej nga një ankth.

Banonin në një dhomë të vogël në godinën e shkollës shtatëvjeçare të Fushë-Krujës. Drini ishte një mësues i ri, që jepte lëndën e matematikës dhe që mblidhej në dhomë veç në mbrëmje, ngaqë s'kishte ku të shkonte tjetër. Aty e gjente profesorin, i cili, mbasi shpjegonte me pasion mësimin e shqipes paradite, gjithë kohën tjetër e kalonte i mbyllur në dhomë. Mirëpo muhabeti nuk u ecte. Profesori ishte i sjellshëm, por i përkorë. Mezi i nxirrte fjalët. I largohej çdo bisede, si djalli temjanit. Ishte i kredhur në përkthimet, apo druhej? Drini nuk ishte i sigurt. E dinte që kishte qenë në burg, që ishte beqar dhe i panjeri, sepse nuk i vinte kush ta takonte, ndërkohë që ai nuk afrohej me kërkënd. Tip i çuditshëm, një gërçho, thoshte me vete Drini.

- Ç'mendim ke për Dritën? - e pyeti pas pak.

Priti që profesori të thoshte diçka, qoftë

edhe një fjalë, por ai heshti dhe u zhyt edhe më tepër në punën e tij. Ishte rreth të pesëdhjetave, por dukej tejet i moshuar, për shkak të rrudhave të thella, flokëve të bardhë dhe syzeve me qelqe rrathë-rrathë.

- Profesor!

- Urdhëro, - iu gjeç tjetri pa e ngritur kokën.

- Dritën e kam për zemër dhe më pëlqen ta marr.

- Merre.

- Mirëpo ka një kleçkë biografie e s'di si t'ia bëj.

- Lëre.

- Por është vajzë e mrekullueshme. I ka gjithë të mirat. Apo s'është e pashme!

Drita ishte vërtet e bukur: trupderdhur, fytyrëshënore, me sy në formën e gjetheve të pjeshkës dhe flokët ngjyrëokër.

- Merre.

Përkthyesi ishte i fokusuar në kërkim të fjalës së duhur dhe po vuante sa ta qëmtonte. Tërë qenia e tij ishte ngulur atje. Ndërsa i përgjigjej shkurt, pa e pasur mendjen. E gjeta! klithi së brendshmi i kënaqur: *e zhvati gojën...* Tamam kafshërore...

- Kam frikë se mos e pësoj nga kjo lidhje, tha Drini me zë të zvargur.

- Lëre.

Drini po i vinte të pëlçiste. Kërkonte një këshillë, donte t'i hapej dikujt, për një çështje kaq delikate, por...me kë të fliste!? Ishte ulur mbi krevatin e drunjë dhe vështronte njeriun e rrëgjuar e të thinjur, që mërmëriste dhe shkruante pa e ngritur kokën. Në një tjetër botë.

- Në fakt, nuk ka ndonjë gjë të madhe, thjesht është stërmbesë e Merlikajve, si thua?

- Merre.

- Po unë...

- Lëre.

Drini zjeu nga brenda, por u përmbajt. I hodhi një vështrim gjithë mllaf njeriut, që kishte futur kokën mes librave e fjalorëve dhe s'pyeste për gjë tjetër në botë. Njeri i fshtymur, i mbaruar, foli me vete. A ka dashururuar ndonjëherë?

Përkthyesi u ngul te tokfjalëshi: *ushqim i vështirë*. Frazë e rëndomtë, pa ngjyrim, pa emocion,- mendoi. Duhet diçka tjetër. Ah, po e gjeta! u gëzua ai si një fëmijë: *gjell'e pështirë...*

Djaloshi ia këputi sërish mendimin.

- Unë jam nga një familje e luftës.

- Lëre atë cucë, mos e trazo në fatin e saj. Më lërë edhe mua të qetë! - e ngriti zërin përkthyesi fytyrëngrysur.

Drini u hutua nga dalldia e tjetrit. S'e kishte parë kurrë të zëmërohej. Nuk e di ç'pati, mendoi hidhur.

Shqipëruesi u kthye në botën e tij dhe nisi të fliste me vete: *gjell'e pështirë*, tamam e pështirë, që të ngjall krupën. Të bresh, të gërryesh me dhëmbë kafkën e një tjetri për hakmarrje...

Mandë e shestoi me mend gjithë vargun: *E zhvati gojën nga gjell'e pështirë* dhe e ndjeu veten të lehtësuar, madje të lumtur, ndonëse përcillte një akt të neveritshëm.

Vetëm atëbotë e ngriti kokën dhe e vështroi në sy Drinin.

- Më fal! - i tha.

Drini i erdhi çudi, por edhe mirë që i kërkoi falje një flokëthinjur, një i ditur, i cili, siç thoshin, kishte bërë të fliste në shqip Homerin dhe Danten, por që vetë ishte vulëhumbur.

- Unë ju kërkova thjesht një këshillë, asgjë tjetër.

- Një këshillë? Nuk jap kurrë këshilla.

Po të isha aq i mençur për këshilla, nuk do të isha katandisur kështu, shfreu hidhur profesori.

Drini mbeti pa fjalë.

Përkthyesi nuk u ndje mirë. Edhe një herë që kishte folur pak më tepër, e kishte djallësuar. Kishte aluduar për vete. Ndaj donte të thoshte diçka tjetër, thjesht njerëzore e lehtësuese, që ta mbyllte atë bisedë cingëruese dhe të mos e lëndonte atë djalë.

-Ai që dashuron me të vërtetë, guxon, - i tha përhumbshëm dhe iu kthye punës, duke i dhënë të kuptonte tjetrit, që të mos e trazonte më.

Drini qendroi i ulur më bythë për disa kohë. Ç'të bënte? Natën Fushë-Kruja ishte një qytezë e vdekur. Ku të shkonte? I hodhi një vështrim përçmues plakut dhe librave përgj, që e rrethonin si një mur i heshtut. Botë e vjetër, mendoi.

U shtri mbi krevat, siç ishte i veshur dhe pas pak nisi të gërrhiste.



ARTI NUK PËRFUNDOHET KURRË, siç Avërejt Paul Valéry, vetëm braktiset. Në epokën digjitale, muzikantët dhe regjisorët e filmave e kanë vërtetuar vazhdimisht pohimin e poetit francez përmes riinterpretimeve, reregjistrimeve dhe rishfaqjeve (shpesh të dobëta) para publikut. Por është shumë më pak e zakonshme që autorët (rishikues a la Walt Whitman) të rishqyrtojnë ose përmirësojnë ndjeshëm veprën që i është besuar botuesit, edhe pse disa rivlerësime të dyshimta kanë ndodhur kohët e fundit për shkak të presionit publik dhe pamaturisë editoriale. Shkrimtarët megjithatë i rikthehen rregullisht veprës së tyre në shkrimet e mëpasme, duke e zhvendosur një histori ose personazh në një kohë ose vend tjetër. Në vitin 2019, Margaret Atwood, e detyruar nga ngjarjet e botës reale (dhe ndoshta kontratat televizive), i rikthye Gileadit në romanin “Testamentet”, vazhdim i romanit klasik të vitit 1985 “Rrëfenja e shërbëtores”. Dhe së fundmi, në mars 2023, “Raporti i pakicës” i Mary Gaitskill-it ringjalli protagonisten e tregimit të vitit 1988 “Sekretarja”, duke rikontestualizuar ngjarjet e veprës së mëparshme në dritën e normave tona kulturore në zhvillim. (Gaitskill e arsyetoi rikthimin te ky tregim në “The New Yorker”, ashtu edhe në faqen e saj onlajn).

Eminenca gri e Shqipërisë Ismail Kadare iu rikthye fillimisht veprës së mëhershme me “Pasardhësin” e vitit 2003, një vazhdim i “Vajza e Agamemnonit”, i shkruar në vitin 1985, megjithëse nuk do të botohej deri në 2003. Romani i mëparshëm, që përshkruante çnjerëzimin rrëqethës të jetës pas dehumanizimit për gati katër dekada të regjimit stalinist të Enver Hoxhës, ishte një nga disa dorëshkrime të pabotuara që Kadare i maskoi si përkthime romanesh gjermane dhe i nxori kontrabandë jashtë Shqipërisë në mesin e viteve 1980 me ndihmën e botuesit francez Claude Durand, i cili i fshehu në një bankë pariziane.

Në vitin 1990, pesë vjet pas vdekjes së Hoxhës dhe pak para përmbyesjes së qeverisë komuniste të Shqipërisë, Kadare kërkoi dhe iu dha azil në Francë. Që andej, në vitin 2002, ai iu rikthye alegorive dhe metaforave mitologjike të vajzës së Agamemnonit në variantin e thashethemeve skandaloze dhe satirës së egër të “Pasardhësi”. Përkthimet në anglisht të të dyja romaneve janë bërë nga David Bellos, i cili ka punuar mbështetur në versionet në frëngjisht, një model i përsëritur përkthimi me disa romane të Kadaresë. Romani brilant pasues rimerr në shqyrtim ngjarjen nxitëse të romanit të parë nga një perspektivë e lidhur ngushtë me qeverinë e Hoxhës, ndërkohë që ka si objekt drejtpërdrejt vetë udhëheqësin si një paranojak, që mërmërin pas “paqartësisë së padepërtueshme të syve të verbër” ndërsa mposht armiqtë e përfytyruar në rrethin e tij të brendshëm.

Tani në fund të të tetëdhjetave, Kadare ka shkruar “Një diktator telefonon”, një tjetër roman ku i rikthehet veprës së mëparshme dhe të kaluarës së tij. Megjithëse nuk është një vazhdim i përpiktë i një veprë specifike, kjo veper e fundit është në dialog të drejtpërdrejtë me romanin e hershëm “Muzgu i perëndive të stepës” (1978), i mbështetur në ngjarjet që ndodhën gjatë kohës së tij në Moskë nga viti 1958 deri në 1960. Libri i ri, në përkthimin e jashtëzakonshëm në anglisht të John Hodgson-it, rimerr në shqyrtim edhe trashëgiminë e Kadaresë dhe trashëgiminë e kujtdo që rragon të shkruajë nën hijen e një sistemi politik që kërkon t’u diktojë zërin krijues dhe të përcaktojë fatin e tyre.

Ka momente madhështie të vërtetë të

# ARTI NUK KËRKON MËSHIRË, POR VETËM E JEP: PËR “KUR SUNDUESIT GRINDEN” TË ISMAIL KADARESË

*Cory Oldweiler, Los Angeles Review*

Përktheu Granit Zela

Recensa e Cory Oldweiler-it, shkrimtar dhe kritik letrar për botimin anglisht të “Kur sunduesit grinden” të Kadaresë, tanimë i nominuar për Çmimin Ndërkombëtar Booker. Shkrimet e Oldweiler-it botohen në “Los Angeles Review”, “The Washington Post”, “Boston Globe”, “Star Tribune”, “Words Without Borders”, “Southwest Review” dhe media të tjera ndërkombëtare.

“Një diktator telefonon”, por nganjëherë kurba e lartësisë ulet ashtu si edhe ritmi dramatik i veprave më të mira të mëvonshme të Kadaresë, si “Pasardhësi” dhe “Një vajzë në ekzil: Requiem për Linda B” [Në shqip “E penguar”] (2009). Kjo shpjegohet prej faktit ngaqë romani nuk përqendrohet plotësisht në një formë të vetme që mëton të ketë, duke u zhvendosur midis introspeksionit të fuqishëm, teorisë letrare, autobiografisë së letrarizuar dhe hulumtimit historik. Shumica e shembujve letrarë të romanit janë nxjerrë nga panteoni i shkrimtarëve të mëdhenj rusë që po rishqyrtohen që nga pushtimi rus i Ukrainës në shkurt 2022. Dhe ndërsa “Një diktator...” është në përputhje me momentin e tanishëm të vlerësimit dhe të nxjerrjes në pah të këtyre shkrimtarëve në lidhje me rëndësinë e kontrollit të narrativës përballë tiranisë, padyshim që nuk përbën kritikë bashkëkohore, duke mos i kushtuar vëmendje të veçantë qëndrimeve aktuale. Megjithatë, është një kod i përshtatshëm (i mundshëm) për një karrierë të jashtëzakonshme dhe duke marrë parasysh temën, thjesht mund t’i sjellë Kadaresë Çmimin Nobel për Letërsinë, i vetmi çmim i madh që ai nuk e ka marrë.


“Një diktator...” mbështetet në një sërë pjesësh lëvizëse për të diskutuar ide shumë më të mëdha, duke e bërë pak të vështirë diskutimin për shkak të rendit të përmbytur të disa çështjeve. Në pamje të parë, diktatori që i jep titullin romanit është udhëheqësi sovjetik Jozef Stalin dhe personi që ai telefonon është Boris Pasternak, autor i “Doktor Zhivago”, veprës më të rëndësishme të tij, roman i cili u botua në Itali në vitin 1957. Më shumë se gjysma e “Një diktator telefonon” analizon 13 rrëfime të ndryshme të një telefonate tri minutëshe që ka ndodhur në 23 qershor 1934. Këto versione janë nxjerrë nga burime (të hamendësuar) parësore si kasetat e KGB-së, si dhe kujtimet e atyre që mund ta kenë dëgjuar bisedën ose të cilëve u është folur për të më pas. Disa nga këta dëshmitarë dëgjuan për telefonatën nga vetë Pasternaku; të tjerët thjesht përsërisnin thashethemet nëpër qytet. Kadare është plotësisht i vetëdijshëm se kjo sipërmarrje është ndoshta marrëzi, duke theksuar se “dy [versione] do të

mjaftonin për të krijuar pëstjellim”. Pasi paraqitet i katërti, ai madje i kanalizon lexuesit duke shkruar: “Po na çmendni me gjithë këto versione! Ka një kufi për çdo gjë! Mjaft! Megjithatë...”

Në një moment, Kadare shkruan se



ai “ka menduar shpesh se tri minutat e Pasternakut ishin një nga idengulitjet e mia stërmunduese”, por ai nuk e beson vërtetë. Menjëherë pas kësaj, në një fragment që tregon aftësitë e mëdha të përkthimit të Hodgsonit, kemi provën: [Ne] që dimë diçka për këtë çështje, jemi të detyruar të dëshmojmë për të, edhe për ato aspekte që është e pamundur të vërtetohen. Çast pas çasti, sekondë pas sekonde... Ashtu siç e dëshmuam ai dhe të gjithë vëllezërit tanë në art, pa e ditur askush dhe pa marrë anën e askujt. Sepse arti, ndryshe nga një tiran, nuk kërkon mëshirë, por vetëm e jep”. Këto fjalë të fuqishme përmbledhin jo vetëm lëndën e romanit dhe harkun e karrierës së Kadaresë, por edhe qëllimin, siç e sheh ai, të artit në përgjithësi.



Në shqip, romani i ri titullohet “Kur sunduesit grinden”. Në faqet e para, përpara se të paraqitet telefonata Stalin/Pasternak, Kadare detajon një tjetër telefonatë, e cila është pothuajse apokrifë, mes tij dhe Hoxhës, gjatë së cilës udhëheqësi shqiptar e lavdëron Kadarenë për një poezi që ai kishte botuar në gazetë. Përdorimi i trajtës së pashquar nga Hodgson-i në titullin anglisht sigurisht që lë të hapur mundësinë për më shumë se një diktator, por unë parapëlqej pyetjen e hapur të propozuar nga titulli në shqip, e cila i përgatit lexuesit të marrin në konsideratë se çfarë ndodh kur një kryetar shteti grindet me nënshtetasit e tij, miraton opinionet e tyre - përgjithësisht të papëlqyeshme - ose debaton me ata që priren të mos pajtohen me ta. Kadareja arriti të botonte disa libra në Shqipëri gjatë sundimit të Hoxhës, por vepra e tij gjithmonë eci në zgrip të asaj që ishte politikisht e pranueshme. Meqenëse poema në fjalë nuk është e specifikuar, është e pamundur të përcaktohet nëse kjo telefonatë ka ndodhur në të vërtetë, por duket shumë e pagjasë. Përkundrazi, është thjesht një nga mënyrat e shumta me të cilat Kadare e lidh veten me Pasternakun, i cili gjithashtu nuk ishte në gjendje t'i përgjigjej siç duhej dhe siç priste Stalini.

Ndërsa nuk është e qartë se përse Stalini i telefonoi Pasternakut, afërmendsh nuk i telefonoi për ta lavdëruar. Para disa javësh, poeti rus Osip Mandelshtam ishte arrestuar dhe dërguar në Lubyanka, ku u torturua dhe u mor në pyetje për një poezi satirike që kishte krijuar një vit më parë. Megjithatë nuk u shkrua kurrë, Mandelshtami thuhet se ua kishte recituar disa miqve. Poema, në përkthimin e W. S. Merwin-it dhe Clarence Brown-it, i referohet Stalinit si “maloku i Kremlinit” me “dhjetë krimba të trashë në gishta, [...] buburrecat e mëdha të qeshura në buzën e sipërme”, përpara se të tallte lakejtë dhe qeverisjen e tij të neveritshme. Stalini mendonte se poema, e njohur sot si “Epigrama i Stalinit”, duhej të fshihej nga historia; “Këto ishin fjalë që nuk duhej menduar apo thënë kurrë”, siç shkruan Kadare. Kur Stalini i telefonon Pasternakut, ai e pyet për Mandelshtamin dhe sipas arkivave të KGB-së, Pasternaku mohon të ketë njohur mikun e tij, përpara se të shtojë: “Kështu që nuk mund të them asgjë për Mandelstamin”. Stalini përgjigjet: “Ndërsa mund të them se ti nuk je një shok i vërtetë, shoku Pasternak”, pastaj e mbyll telefonin. Shumica e versioneve të telefonatës bien dakord për këto pika kryesore – domethënë, që atë e telefonoi Stalini; që Pasternaku, ashtu si Juda, e mohoi shokun e tij; dhe se Stalini e ka qortuar.

Pse Stalini kërkoi në radhë të parë mendimin e Pasternakut? Çfarë shpresonte të fitonte duke i telefonuar? A po përpiquej thjesht të fuste në kurth Pasternakun? Dhe, si rrjedhojë, cila është marrëdhënia mes diktatorëve dhe artistëve, ku të dytëve zakonisht u frikësohen të parët? Këto janë disa nga çështjet me të cilat merret Kadare në pjesën më të madhe të “Diktatorit”, por interesi i tij për Pasternakun e ka origjinën në ngjarjet e trajtuara në “Muzgu i perëndive të stepës”, botuar në shqip në vitin 1978, në frëngjisht në vitin 1981 dhe në përkthimin anglisht të Bellos, nga frëngjishtja, në vitin 2014. Kadareja ishte 22 vjeç në vitin 1958 kur u dërgua në Institutin Gorki në Moskë për të mësuar, krahas korifenjve të letërsisë sovjetike, se si të shkruante sipas diktateve të realizmit socialist. Kjo kohë dhe magjepsja nga vajzat e reja të Moskës, u ndërpre në vitin 1960 pasi Hoxha, një stalinist dogmatik deri në ditën e vdekjes, filloi të shkëpuste

lidhjet me Bashkimin Sovjetik, sepse Nikita Hrushovi po shkëpentej, sipas Hoxhës, nga porositi e Stalinit. (Hoxha do ta përfundonte procesin e izolimit të Shqipërisë nga pjesa tjetër e botës kur u tërhoq nga Traktati i Varshavës në vitin 1968, pasi sovjetikët pushtuan Çekosllovakinë dhe ndërpreu lidhjet me Kinën në fillim të viteve 1970, pasi udhëheqja pas Maos u largua nga rruga e vërtetë e komunizmit.)

Gjatë vitit të parë të Kadaresë në Moskë, Pasternakut iu dha Çmimi Nobel për Letërsinë. Nderimi u pa si “një dhuratë e helmuar e borgjezisë ndërkombëtare”, siç shprehet një personazh te “Muzgu”, duke bërë që e gjithë pesha e sistemit sovjetik të përplasej mbi të me forcë të frikshme. Reagimi ishte aq madh sa Pasternaku më në fund e refuzoi çmimin. Në “Një diktator...”, Kadare shpjegon se për sa i përket Shqipërisë, problemi nuk ishte se sovjetikët kishin sulmuar Pasternakun, por se ata nuk e kishin bërë atë aq ashpër sa duhej. Zgjidhja “e dukshme”, imagjinon ai që propozon qeveria e Hoxhës, ishte “një plumb ballit”. Është një ndjenjë që do të kishte qenë e paimagjinueshme të pohohej, qoftë edhe me shaka (nëse do të kishte një koncept të tillë nën Hoxhën), në vitet 1970.

Kadare shfaq empati të thellë për Pasternakun tek “Një diktator...” diçka gati e pamundur te “Muzgu...”, duke shkruar se zhurmaja dëshmitar i të cilës kishte qenë në Moskë përfshinte “një element të çuditshëm dhe krejtësisht të ndryshëm. Sikur të mos ishte vetëm për të [Pasternakun] por për dikë tjetër, ndoshta edhe për mua.” Ai ngjall atmosferën: “Imagjinoni të qëndroni vetëm përballë vendit tuaj, i cili ju fyen dhe ju bërtet

me urrejtje dhe dashuri në të njëjtën kohë”. Është një rresht që i bën jehonë ndjenjave të tij neutrale nga 45 vjet më parë te “Muzgu...”: “Si duhet të jetë të jesh objektivi, të jesh syri i asaj cikloni? E imagjinova kokën legjendare sllave duke fryrë faqet në mes të stepës. Propaganda sovjetike ishte e tillë.” Ishte në rregull të kritikojë sovjetikët në atë kohë, por jo të ndiejë simpati për objektivat e sulmeve të tyre. Te “Një diktator...”, Kadare është i lirë të shkruajë çfarë të dojë, dhe në rast se paralelet mes të shkruarës së tij dhe sulmit ndaj Pasternakut nuk janë ende mjaft të qarta, ai shton: “Është e njëjta zhurmajë e pandërprerë në Moskë siç dëgjohet në Tiranë”.

Kapitulli i parë i “Një diktator...”, parashtron kthimin e Kadaresë në Shqipëri nga Moska dhe nisjen e përpjekjes për botimin e “Muzgut”. Teksa e lexoj, mund të imagjinoja që dy romanet të ndërthureshin në një vëllim të vetëm, si diçka e shkruar nga Milan Kundera, ku Kadareja do të ndërpriste rrëfimin e “Muzgut...” me komentin në vetën e parë të “Një diktator...”. Do të kisha dashur ta shihja këtë qasje veçanërisht në pjesën e dytë të shkurtër të “Një diktator...”, i cili fillon me mbërritjen në Paris në vitin 2015 të Irina Emelyanovas, vajzës së të dashurës së Pasternakut dhe një personazh i rëndësishëm nga “Muzgu...” (ku emri i saj përkthehet si Ira Emelianova). Kadare shkruan se Irina është me gruan e tij në pritje për të ngrënë dreckë, por më pas fillon të heq paralele mes jetës së Mandelshtamit dhe Pasternakut dhe nuk i kthehet më asaj. Shumë më mirë përdoret Stulpansi, një letonez që është miku më i ngushtë i Kadaresë te “Muzgu...” (ku emri i tij përkthehet si Stulpanc). Historia e tij

në “Një diktator...” është një nga pikat e pakta të subjektit që nuk duhet zbuluar këtu, por mjafton të thuhet se ai rrënon plotësisht veprimet e Vladimir Leninit, duke theksuar në të njëjtën kohë prirjen e tiranëve për të rënë pre e frikërave dhe mërive të vogla.

Një arsye se pse do të doja që Irina të ketë më shumë zë në “Një diktator...” është sepse Kadare tregon se si gratë, “shpjegueset më të ëmbla dhe më të pamëshirshme të së pashpjegueshmes”, kanë qëndruar “pothuajse krejtësisht të heshtura” që nga koha e Helenës së Trojës. Shumica e rrëfimeve për telefonatën e Stalinit dhe Pasternakut vijnë nga gra, por ato nuk janë, pëson Kadare, të besueshme si dëshmitare për shkak të klisheve që lidhen me personazhin e dashnores/gruas. Do të rrëfeje se, pas disa leximeve, ende nuk e kam plotësisht të qartë se çfarë po përpiquej të shtjellojë Kadare për gratë si vëzhguese të historisë. Shënimi tjetër që duket i rremë më del gjatë një shqyrtimi të standardit të dyfishtë që rregullon sjelljen e artistëve dhe politikanëve: Ana e përparme e lavdisë, e famës, rrëzon idhujt politikë, por nuk ka fuqi kundër artistëve. Në të vërtetë, në vend që t'i dëmtojë ato, shpesh i bën më tërheqës. [...] Artistit jepet pas qejfeve, grave dhe i pëlqejnë pijet. Punë për të. Por a shkruan mirë? Kjo është kryesorja. Por, ndërsa kjo ishte padiskutim e vërtetë në të kaluarën, nuk mendoj se shumë shkrimtarë, të paktën në Shtetet e Bashkuara, do të pohonin se kështu është edhe sot.

Ndërsa “Një diktator...” shpesh aludon për detaje te “Muzgu...”, vetëm një fjalë shfaqet në të dy romanet, një passkrim kritik nga një letër që e dashura e Kadaresë nga Moska i dërgon pasi ndahen. Në “Muzgu...”, lexojmë: “Gjithë ditën dje në radio flitej pa pushim për një shkrimtar që ka bërë tradhti dhe unë mendoja për ty”. Te “Një diktator...”, Hodgsoni e përkthen: “Dje po flisnin në radio gjatë gjithë ditës për një shkrimtar që ishte kthyer në tradhtar dhe mu kujtove ti”. Kur Kadare, duke reflektuar tek “Një diktator...”, kujton rreshtin, ai i ndalon rrahjet e zemrës. Është vetëm një fjalë - tradhtar - por ky është lloji i aludimit që i bën shkrimtarët të vriten. Është lloji i frikës që ai kurrë nuk mund ta kishte diskutuar në veprën e mëparshme. “Një diktator” vazhdon të theksojë disa përpjekje për censurë, duke përfshirë raste që përqendroheshin te një fjalë të vetme – në Shqipëri, fjala “zonjë”, e përdorur nga nxënësit e shkollës sepse zëvendësohet nga fjala “shoqe”; dhe në Rusinë e shekullit të 19-të, emri i Car Aleksandrit që shfaqet një herë në një poezi të Pushkinit. Kjo e fundit ishte shkak i bastisjes së banesës së Pushkinit, një shembull tjetër i frikës së vogël që ndjehet aq shpesh nga të fuqishmit.

Kadare pyet veten se si do të ishte përgjigjur nëse Hoxha, në telefonatën e tyre të hamendësuar, do ta kishte pyetur për një shkrimtar tjetër shqiptar. Ose për veten e tij. A dëshiron ai që të kishte pasur mundësinë për të sprovuar veten? Apo ndihet sikur ka bërë mjaft me veprën e tij? Ndoshta përgjigja, përgjigja e tij, për pyetjen e fundit dhe për historinë vjen në versionin e 13-të të telefonatës midis Stalinit dhe Pasternakut. Ndryshe nga çdo version tjetër në roman, ky nuk i atribuohet një burimi specifik dhe nuk rrëfen telefonatën. Në vend të kësaj, Kadare thotë se ato “burime të tjera arkivore nuk kanë ndihmuar në krijimin e një versioni të besueshëm të bisedës”. Në këtë version të 13-të, fjala e fundit thuhet nga vetë Kadareja dhe është përfundimtare: Mandelshtami dhe të tjerë si ai që janë të detyruar të dëshmojnë për historinë nuk janë të vetëm, kujtimi dhe zëri i tyre do të jetojë.

# KADARE

## KUR SUNDUESIT GRINDEN

### RRETH MISTERIT TË TELEFONIMIT STALIN-PASTERNAK



Onufri

Romani i panjohur i G. G. Markezit u botua në të gjithë botën  
(në shqip nga Onufri), në të njëjtën ditë: 6 mars 2024

